

HUMAN

RIGHTS

HUMAN

RAPORTI I SHOQËRISË  
CIVILE PËR TË DREJTAT  
E NJERIUT

NË KOSOVË NË VITIN 2023

HUMAN

RIGHTS

MAJ 2024

# PËRMBAJTJA

---

## **1. HYRJE**

---

## **2. KORNIZA METODOLOGJIKE E RISHIKUAR**

---

## **3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË**

---

## **4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

---

## **5. PJESA A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE**

---

5.1 E drejta për jetën

5.2 Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar

5.3 E drejta për liri dhe siguri personale

5.4 E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive

5.5 Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim dhe e drejta për privatësi

5.6 Liria e tubimit paqësor

5.7 Liria e asociimit

5.8 Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

## **6. PJESA B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE**

---

6.1 Të drejtat e punës

6.2 E drejta për arsim

6.3 E drejta për kujdes shëndetësor

6.4 Të drejtat pronësore

6.5 Të drejtat kulturore

## **7. PJESA C: TË DREJTAT E PERSONAVE DHE TË GRUPEVE TË CAKTUARA**

---

7.1. Të drejtat e grave dhe barazia gjinore

7.2. Të drejtat e fëmijëve

7.3. Të drejtat e të rinjve

7.4. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

7.5. Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë

7.6. Të drejtat e personave LGBTIQ+

7.7. Personat në lëvizje

## **8. PJESA D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ÇËSHTJE SPECIFIKE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT**

---

8.1. Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut

8.2. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut

8.3. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut

8.4 E drejta për barazi dhe mosdiskriminim

# LISTA E TERMEVE DHE SHKURTESAVE

<b>AGK</b>	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
<b>AIP</b>	Agjencia për Informim dhe Privatësi
<b>AKA</b>	Agjencia e Kosovës për Akreditim
<b>AKKVP</b>	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
<b>ANJF</b>	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
<b>Ashkali-K</b>	Ashkali/ke i/e Kosovës
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BSPK</b>	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
<b>CEDAW</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>DhSK</b>	Dhunë Seksuale gjatë Konfliktit
<b>DUDNj</b>	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
<b>ECPMF</b>	Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias
<b>Egjiptian-K</b>	Egjiptian/e i/e Kosovës
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
<b>IP</b>	Inspektorati i Punës
<b>IPK</b>	Inspektorati Policor i Kosovës
<b>KDF</b>	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
<b>KDPAK</b>	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEDR</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
<b>KK</b>	Kuvendi i Kosovës
<b>KKMPK</b>	Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
<b>KKP</b>	Komisioni i Pavarur i Mediave
<b>KKpK</b>	Komisioni Komunal për Kthim
<b>KKT</b>	Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese
<b>KKPAK</b>	Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara
<b>KNDCP</b>	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
<b>KNDESK</b>	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KOS</b>	Kisha Ortodokse Serbe

<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
<b>MPK</b>	Mekanizmi Kombëtar për Parandalim
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>OJQ</b>	Organizata Jo-Qeveritare
<b>OHCHR</b>	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>OSHC</b>	Organizatë(a) e(të) shoqërisë civile
<b>PISA</b>	Programi për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>PKBGj</b>	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
<b>POKKT</b>	Protokolli Opsional i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerezore ose Poshtëruese
<b>PZHBV</b>	Persona të zhvendosur brenda vendit
<b>PSRK</b>	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
<b>PTH</b>	Prokuroria Themelore
<b>QK</b>	Qeveria e Kosovës
<b>RrDNj</b>	Rrjeti i të Drejtave të Njeriut në Kosovë
<b>SBASHK</b>	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës në Kosovë
<b>Serb-K</b>	Serb/e i/e Kosovës
<b>SHKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
<b>UNHCR</b>	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>ZQM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit

# 1. HYRJE

**1.** Raporti i Shoqërisë Civile<sup>1</sup> për të Drejtat e Njeriut në Kosovë ofron një pasqyrë të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë vitit 2023, duke përfshirë problemet kryesore, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe sfidat në përmbushjen e të drejtave të njeriut. Raporti është hartuar bashkërisht nga organizatat e shoqërisë civile (OShC-të) të cilat punojnë në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Qëllimi i këtij raporti është të shërbejë si një mjet i pavarur për vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke e plotësuar kështu hendekun ekzistues në raportimin e përbashkët për të drejtat e njeriut në Kosovë në nivel vendor dhe ndërkombëtar, si dhe për ta përmirësuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet OShC-ve.

**2.** Raporti është i strukturuar në katër pjesë kryesore. **Pjesa A** i trajton të drejtat civile dhe politike, ku përfshihen e drejta për ndalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës; e drejta për liri dhe siguri personale, e drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe qasje në drejtësi; liria e shprehjes, mendimit, informimit dhe e drejta për privatësi; liria e tubimit paqësor; liria e organizimit dhe liria e mendimit, e fesë dhe e ndërgjegjes. Në **Pjesën B** analizohen të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, siç është e drejta për arsim; e drejta për kujdes shëndetësor; të drejtat e punës, dhe të drejtat pronësore, dhe përfundon me një pasqyrë të të drejtave kulturore. **Pjesa C** trajton të drejtat e personave në situata të cënueshme, si të drejtat e fëmijëve, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve jo-shumicë, komuniteteve LGBTIQ+ dhe personave në lëvizje. Raporti përmbyllet me **Pjesën D**, ku shtjellohen një numër çështjesh të ndërlidhura dhe specifike për të drejtat e njeriut, siç janë drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut, korrupsioni dhe të drejtat e njeriut, ndikimi i çështjeve mjedisore në të drejtat e njeriut, si dhe e drejta për barazi dhe mosdiskriminim.

## 2. KORNIZA METODOLOGJIKE E RISHIKUAR

**3.** Raporti i përbashkët i OShC-ve për të drejtat e njeriut për vitin 2023 shërben si pasqyrë gjithëpërfshirëse e situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë në vitin 2023. Dokumenti trajton fushat kritike për kuptimin e zhvillimit të të drejtave të njeriut në Kosovë në kontekstin e tranzicionit të saj të vazhdueshëm si një shtet demokratik që ka në qendër vlerat universale të të drejtave dhe lirive të njeriut. Metodologjia bazohet në nevojën për një perspektivë me spektër të gjerë e cila e kombinon aspektin e politikave me praktikën dhe përvojat. Si i tillë, raporti i përbashkët i OShC-ve dallon nga shumë raporte të tjera për të drejtat e njeriut në Kosovë. Edhe pse raporti është gjithëpërfshirës, duhet pranuar se ka kufizime në atë që është mbuluar.

**4.** Procesi i hartimit të raportit është bazuar në parimin e pjesëmarrjes dhe pronësisë së plotë të OShC-ve kyçe që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në nivel lokal dhe në mbarë Kosovën.

<sup>1</sup> Shih raportet përkatëse të shoqërisë civile për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë për vitet 2019, 2020, 2021 and 2022. Ky raport u realizua me mbështetjen financiare të Komponentës së të Drejtave të Njeriut të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR).

Për mbledhjen e të dhënave për përpilimin e raportit të përbashkët të OShC-ve janë përdorur disa metoda. Së pari, raporti është rezultat i kontributeve përkatëse të 37 OShC-ve të përkushtuara ndaj çështjeve të caktuara të të drejtave të njeriut. Secilës OShC i është kërkuar të ofrojë të dhëna thelbësore në fushat e tyre përkatëse të punës. Kjo mundësoi që raporti të klasifikohet në katër pjesë: **Pjesa A** ka të bëjë me gjendjen e të drejtave civile dhe politike në Kosovë. Pas saj vazhdon **Pjesa B**, e cila i trajton çështjet socio-ekonomike dhe kulturore. Në **Pjesën C** trajtohen të drejtat e personave në situata të cenueshme, pasuar nga tema të ndërlidhura përfshirë drejtësinë tranzicionale, korrupsionin, ambientin dhe mosdiskriminimin në **Pjesën D**.

**5.** Që nga raporti i vitit 2022, Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (RrDNj) ka zhvilluar një metodologji alternative për mbledhjen e të dhënave. Përgjatë viteve, raporti vjetor i OShC-ve ka vënë në pah nevojën kritike për mekanizma vlerësimi që mund ta masin dhe monitorojnë zbatimin e ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Kosovë në terma më sasiorë. Në thelb, qëllimi i çdo raporti vjetor është mundësia e matjes dhe krahasimit të zhvillimit të të drejtave të njeriut me kalimin e kohës. Duke u mbështetur në metodologjinë e zhvilluar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), e cila ka të bëjë me zhvillimin e treguesve të të drejtave të njeriut, ne kemi punuar me një metodologji të rishikuar që na mundëson të bëjmë krahasime kundrejt periudhave kohore. Në bazë të listave të treguesve të zhvilluar për çdo pjesë të të drejtave të njeriut, të dhënat e mbledhura pasqyrojnë jo vetëm një përpjekje cilësore për ta kuptuar kontekstin, por ato janë gjithashtu rezultat i një pune apo metodologjie sasimore për matjen e situatës së të drejtave të njeriut. Për fund, ky raport u mbështet edhe në një hulumtim të gjerë. Për secilën nga pjesët, të dhënat u grumbulluan nga një numër i madh i burimeve të besueshme. Pos kësaj, raporti është shqyrtuar në tri faza të njëpasnjëshme të procesit të hartimit. Në tre takime konsultative të organizuara nga Rrjeti i të Drejtave të Njeriut<sup>2</sup> (RrDNj, nëntor 2023, shkurt 2024 dhe mars 2024), si dhe në takimin konsultativ me institucionet publike në janar 2024, OShC-të kontribuuese kanë pasur mundësi që t'i diskutojnë gjetjet dhe të ofrojnë sugjerime të cilat më pas janë përfshirë në raportin e përbashkët të OShC-ve. Gjithashtu, procedurat konsultative shtesë u mundësuan përmes korrespondencës me email në mes të OJQ-së YIHR KS dhe konsulentëve hulumtues të kontraktuar.

**6.** 37 OShC-të vijuese kontribuan në këtë raport: Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (AMC), Activism Roots, Advancing Together (AT), Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC), OJQ Aktiv, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës (HANDIKOS), Rrjeti i Gazetarisë Hulumtuese në Ballkan (BIRN Kosova), Qendra për Veprime Afirmative Sociale (CASA), Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova), Qendra për Informim dhe Përmirësim Social (QIPS), Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K), Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF), Forum Civil Peace Service (ZFD), Instituti GAP, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK), Grupi Avokues i Kosovës (KAG), Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Kosovo Young Lawyers (KYL), Kosovo Women for Women (KW4W), Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Lëvizja FOL, Medica Gjakova, Qendra Burimore për Persona të Zhdukur (QBPZh), Iniciativa e Re Sociale (IRS), OJQ Pishtarët, Qendra për

<sup>2</sup> Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (RrDNj) (2023). RrDNj është rrjet i përbërë prej shtatë organizatash që punojnë së bashku në avancimin e mëtejshëm të të drejtave të njeriut për të gjithë në Kosovë. Anëtarë të RrDNj janë: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS), Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës - HANDIKOS, Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), Iniciativa e Re Sociale (IRS), Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve (VoRAE). YIHR KS është themeluese dhe organ sekretarial i RrDNj-së.

Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA), Save the Children Kosova, Terre des Hommes Kosovo (TDH), Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), TOKA, Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve (VoRAE), Vullnetarët e Qytetit (VEQ), Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS).

### 3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

7. Përkushtimi i Kosovës për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është i ngulitur fort në Kushtetutën dhe legjislacionin e vendit, duke përdorur një qasje tri-pjesëshe. Para së gjithash, Kushtetuta përfshin dispozita të shumta kushtuar mbrojtjes së lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Neni 3 i Kushtetutës shprehimisht i obligon autoritetet publike në Kosovë që të sigurojnë trajtim të barabartë para ligjit dhe respektim të palëkundur të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Për më tepër, neni 7 i Kushtetutës vendos parimet themelore të rendit kushtetues të Kosovës, duke theksuar vlerat si barazia, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mosdiskriminimit, duke e njohur specifikisht barazinë gjinore si parim themelor. Kapitulli II i Kushtetutës përcakton dispozita të përpikta që mbrojnë të drejtat civile dhe politike, duke përfshirë të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, të drejtën për privatësi, dhe lirinë e mendimit dhe të shprehjes, tubimit paqësor, asociimit, si dhe të lëvizjes. Ai gjithashtu parashikon mbrojtje për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përfshirë të drejtën për arsim dhe lirinë e profesionit. Në veçanti, neni 53 i Kushtetutës përcakton që çdo interpretim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Kosovës duhet të jetë në harmoni me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

8. Së dyti, Kosova i ka përfshirë disa instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në kornizën e saj ligjore vendore. Një përfshirje e tillë bazohet në nenin 22 të Kushtetutës, i cili përcakton se nëntë instrumente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të organizatave tjera rajonale për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, duke ofruar kështu një bazë ligjore shtesë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë. Në shtator të vitit 2020, Kuvendi i Kosovës e ndryshoi nenin 22 duke e përfshirë edhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në mesin e instrumenteve drejtpërdrejt të zbatueshme për të drejtat e njeriut, duke shënuar kështu një avancim të rëndësishëm për të drejtat e grave. Në tetor 2023, në Kuvendin e Kosovës u kërkua plotësim/ndryshimi i nenit 22 të Kushtetutës për të inkorporuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Megjithatë, plotësim/ndryshimi u pengua për arsye politike, pasi që deputetët që përfaqësonin komunitetin serb munguan gjatë votimit për këto ndryshime të propozuara. Të gjitha këto instrumente për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe kanë prioritet ndaj legjislacionit të Kosovës apo akteve të tjera të institucioneve publike në rast konflikti. Edhe pse Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK) nuk është ndër instrumentet ndërkombëtare

bëtare të të drejtave të njeriut që zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë, Kuvendi i Kosovës e miratoi Agjendën 2030 dhe 17 Objektivat e saj për Zhvillim të Qëndrueshëm me një rezolutë unanime më 24 janar 2018, duke ofruar kështu një rrugë të rëndësishme për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë. Ngjashëm, edhe Plani i Veprimit 2021-2023 për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 2021-2025, ofron referencë të drejtpërdrejtë për harmonizimin e kornizës ligjore të Kosovës me të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (DESK) të formuluar në nivel ndërkombëtar. Në veçanti, viti 2023 shënoi përvjetorin e 75-të të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUD-Nj). DUDNJ shërben si një dokument historik që përcakton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura dhe të mbrojtura botërisht. Rëndësia e saj qëndron në rolin që e ka si një gurthemel i së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

**9.** Megjithatë, meqenëse Kosova nuk është anëtare e asnjë prej organeve të këtyre institucioneve që i zbatojnë dhe mbikëqyrin të njëjtat instrumente ndërkombëtare, aplikimi dhe mbikëqyrja e instrumenteve të tilla është pjesërisht e zbatueshme, përkatësisht janë tre mekanizma ndërkombëtarë që e mbikëqyrin pajtueshmërinë me konventat përkatëse përmes raporteve nga organeve mbikëqyrëse. Këto përfshijnë Konventën për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese; Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).<sup>3</sup> Për të tri konventat përmes mekanizmave të tyre monitorues janë publikuar raporte me rekomandime gjatë vitit 2023. Për më tepër, Kosova është anëtare e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës (KE), komision ky që ka dhënë kontribute të çmuara për të siguruar që legjislacioni i propozuar të jetë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut.

**10.** Së treti, Kushtetuta ia kushton një kapitull të tërë mbrojtjes dhe promovimit të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, duke përfshirë disa dispozita shtesë që sigurojnë masa afirmative në mbrojtjen politiko-ekonomike dhe sociale të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.

**11.** Në vitin 2015, Kosova ka bërë progres të mëtutjeshëm në harmonizimin e kornizës së saj ligjore me standardet ndërkombëtare duke miratuar një pako të ligjeve themelore për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Ligjin Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi. Zbatimi i plotë i tyre është thelbësor për zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut.

**12.** Kosova ka krijuar organe dhe mekanizma të dedikuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kyç në këtë aspekt është Institucioni i Avokatit në Kosovë (IAP), i cili është organ i pavarur kompetent për monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga aktet e paligjshme të autoriteteve publike. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit (ZQM) është organ në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM). ZQM harton politika në fushat e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe luftimit të diskriminimit, si dhe mbikëqyr dhe ofron këshilla për ministritë në këto fusha. Këshilli Presidencial për Demokraci është një tjetër organ i rëndësishëm i fokusuar në përmirësimin e realizimit të plotë të të drejtave të njeriut në Kosovë. Organe të tjera të rëndësishme institucionale janë Grupi Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut, Zyra e Komis-



ionerit të Gjuhëve, Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi, si dhe Komisioni i Kuvendit të Kosovës për të Drejtat e Njeriut, si dhe disa institucione të tjera kyçe.

## 4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**13.** Në vitin 2023, Kosova vazhdoi të përballet me sfida në mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike, duke përfshirë të drejtën për jetë, trajtim njerëzor, ndalim të torturës, si dhe të drejtën për liri dhe siguri personale. Përkundër një kornize të fortë ligjore, shqetësimet vazhdojnë kur bëhet fjalë për cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe shërbimet e shëndetit mendor për grupet dhe komunitetet e cenueshme në veçanti. Rastet e keqtrajtimit, tensionet politike dhe çështjet e sigurisë theksojnë nevojën për masa të përmirësuar nga institucionet publike për t'iu përmbytur standardeve të të drejtave të njeriut. Nga Qeveria e Kosovës (QK) janë bërë disa përpjekje pozitive për të adresuar çështjet socio-politike dhe shqetësimet qytetare, siç tregohet në raportin vijues, por nevojitet punë e vazhdueshme për të mbrojtur të drejtat politike dhe civile për të gjithë banorët e Kosovës.

**14.** Në sferën e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, Kosova ishte dëshmitare e progresit dhe sfidave të vazhdueshme në vitin 2023. Disa zhvillime u vunë re në të drejtat për punë, arsim, kujdes shëndetësor, të drejtat pronësore dhe trashëgiminë kulturore, por problemet në zbatimin e ligjit të punës, diskriminimi në arsim dhe kujdes shëndetësor, infrastruktura jo-adekuate e shëndetësisë dhe çështjet e të drejtave pronësore mbeten të vazhdueshme, me rastet specifike të kontesteve për trashëgiminë kulturore të pronave të Kishës Ortodokse Serbe dhe incidente që tregojnë objektet fetare, e që nënvizojnë tensionet e vazhdueshme.

**15.** Përpjekjet për të adresuar të drejtat dhe sfidat me të cilat përballen grupe specifike, duke përfshirë gratë, personat LGBTIQ+, komunitetet jo-shumicë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat në lëvizje, ishin gjithashtu të dukshme në vitin 2023. Përkundër progresit në kornizat legislative dhe mekanizmat institucionalë, siç do të theksohet në raport ka ende probleme të mëdha në raport me diskriminimin, femicidin, dhunën dhe mbështetjen e kufizuar institucionale, duke vazhduar të ndikojnë në grupet e cenueshme. Kërkohet veprimi bashkëpunues ndërmjet institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë për të përmirësuar të drejtat e këtyre komuniteteve.

**16.** Në adresimin e çështjeve të ndërlidhura si drejtësia tranzicionale, të drejtat e njeriut dhe korrupsioni, raporti do të nënvizojë progresin dhe sfidat në Kosovë gjatë vitit 2023. Institucionet publike përballen me pengesa kur bëhet fjalë për konsultimin me palë të ndryshme të interesit, si dhe për sa i përket transparencës dhe vullnetit politik. Korrupsioni mbeti sfida e rëndësishme, duke paraqitur rreziqe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Përkundër reformave legislative dhe masave kundër korrupsionit, ende vazhdojnë mangësitë në zbatim dhe mosbesimi i publikut të zyrtarët qeveritarë, duke theksuar nevojën për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe besimit të publikut tek institucionet.

# 5. PJESA A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

## 5.1 E drejta për jetën

**17.** E drejta për jetën, e cila përkufizohet si e drejtë absolute, garantohet gjerësisht me ligje ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. E drejta për jetën përcaktohet në nenin 3 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj), në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) dhe në nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), duke përfshirë konventat e tjera ndërkombëtare. Në përputhje me përkufizimin e nenit 6 të KNDCP-së, e drejta për jetën është “e drejta e lindur e çdo personi për jetë” dhe e drejta për të mos u “privuar nga jeta në mënyrë arbitrare”.<sup>4</sup> Është e rëndësishme të theksohet se nuk lejohet kufizimi i kësaj të drejte duke përfshirë kohën e krizave humanitare apo të luftës. Në nivel të Kushtetutës së Kosovës, e drejta për jetën e gjen bazën e saj ligjore në nenin 25 dhe nenin 22. Neni 25 në veçanti e ndalon dënimin me vdekje në Kosovë, çka është në përputhje me kërkesat e KEDNj-së për ndalimin e vdekjes në të gjitha rrethanat. Detyrimi i shtetit në lidhje me të drejtën për jetën ka edhe dimensionin pozitiv, i cili kërkon nga shteti të ndërmarrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e atyre që janë në juridiksionin e tij. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka krijuar praktikën gjyqësore për obligimet pozitive të së drejtës për jetën në rastin e Diana Kastratit, për të cilin GjKK vendosi se “është detyrë e autoriteteve shtetërore jo vetëm që të përmbahen nga marrja e jetës me qëllim dhe në mënyrë të paligjshme, por edhe të ndërmarrin hapat e duhur për të mbrojtur jetën e atyre që janë nën juridiksionin e tij”.<sup>5</sup> Në shkurt të vitit 2023, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosën që Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës duhet t’u japin 30 mijë euro kompensim prindërve të Diana Kastratit, duke nënvizuar kështu rolin e autoriteteve publike në ofrimin e kompensimit për palët e prekura në raste të tilla. Në vendimin e gjykatës thuhet se kompensimi jepet në emër të kompensimit të dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara shpirtërore të familjes së Diana Kastratit.<sup>6</sup>

**18.** Sa i përket shëndetësisë, shqetësimet për cilësinë e kujdesit shëndetësor mbeten të vazhdueshme, me projektligjet për shëndetësi dhe për sigurimet shëndetësore në pritje të plotësim/ndryshimit. Strategjia e re Sektoriale e Shëndetësisë 2023-2030 është në pritje të miratimit. Shpenzimet për shëndetësinë, që përbëjnë afërsisht 3 përqind të BPV-së, janë të dytat më të ulëta në rajon, dukshëm nën mesataren e BE-së prej 11 përqind. Përkundër një buxheti rekord për sektorin e shëndetësisë në vitin 2023, llogaridhënia institucionale mbetet e ulët dhe nuk ka tregues të bazuar në performancë.<sup>7</sup>

**19.** Jetëgjatësia në Kosovë është më e ulëta në rajon, ku sëmundjet jo të transmetueshme, veçanërisht sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri, janë shkaqet kryesore të vdekjeve. Programet e promovimit të shëndetit dhe parandalimit për këto sëmundje janë të dobëta. Edhe pse ekziston një program depistimi për kancerin, depistimi nuk është sistematik. Për më tepër, shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve është tri herë më e lartë se mesatarja e BE-së.<sup>8</sup>

4 Shih OHCHR

5 Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komonale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, [Nr. të lëndës KI 41/12](#).

6 Koha (2023), [Apeli vendos që prindërit e Diana Kastratit të dëmshpërblehen me 30 mijë euro](#).

7 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 94-95.

8 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 94-95

**20.** Autoritetet e Kosovës vazhdojnë të jenë të përkushtuara për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit, sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian.<sup>9</sup> Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), i cili vepron në kuadër të IAP-së, nuk ka konstatuar raste të torturës ose keqtrajtimit të të burgosurve gjatë periudhës së fundit të raportimit.<sup>10</sup> Duhet theksuar se disa vende, siç janë institucionet psikiatrike, nuk janë të qasshme për MKPT-në. Inspektorati Policor ka regjistruar 14 raste të dyshuara të keqtrajtimit nga zyrtarët policorë, gjë që ka çuar në arrestimin dhe suspendimin e një zyrtari. IAP ka pranuar 6 ankesa kundër zyrtarëve policorë të Policisë së Kosovës për përdorim të tepruar të forcës, me ç'rast janë iniciuar 3 hetime. Sipas OJQ QKRMT, është e rëndësishme të theksohet se rastet e keqtrajtimit shpesh ndodhin gjatë procesit të transportimit për në qendrën e mbajtjes.<sup>11</sup>

**21.** Është vërejtur pajtueshmëria e Qeverisë së Kosovës me Rregullat Standarde Minimale të OKB-së dhe Rregullat Evropiane të Burgjeve.<sup>12</sup> Megjithatë, sfidat vazhdojnë, duke kërkuar përpjekje shtesë për të mbrojtur të drejtat e të burgosurve, veçanërisht në mesin e grave, vajzave dhe grupeve jo-shumicë. Miratimi i Ligjit për Shërbimin Korrektues dhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në korrik 2022 nënkupton progres, me Njësinë për të Drejtat e Njeriut të Ministrisë së Drejtësisë. Megjithatë, duhet të theksohet nevoja për rregullore që ende nuk janë miratuar për të siguruar zbatimin efektiv të ligjeve. Krijimi i Institutit për Trajtimin e Personave (të burgosur) me Nevoja të Veçanta në Qendrën Korrektuese në Dubravë, adreson shqetësime specifike, por sfidë paraqesin pozitat e lira në menaxhmentin e Shërbimit Korrektues.

**22.** Ashtu si në raportet e mëparshme të OShC-ve, përgjegjësit dhe autoritetet nuk kanë arritur t'i përgjigjen në mënyrë adekuate rasteve të shtuara të femicidit në Kosovë, përkundër thirrjeve për veprime të shtuara për njohjen e problemit të dhunës dhe vdekjes në baza gjinore.<sup>13</sup> Gjatë periudhës së fushatës "16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës në Baza Gjinore", vrasja e Liridona Ademajt nxiti reagime dhe protesta publike.<sup>14</sup> Në një raport të kohëve të fundit (2023), Amnesty International nënvizon se Qeveria e Kosovës nuk i ka mbrojtur të mbijetuarat e dhunës në familje, duke kritikuar barrierat e shumta me të cilat përballen të mbijetuarat për të kërkuar mbrojtje dhe drejtësi.<sup>15</sup> Me gjithë incidentet e shtuara të femicidit dhe një protestë të mëvonshme publike, autoritetet kritikohen për fokusin e tyre të ngushtë në ndjekjen penale. Kjo ka çuar pjesërisht në mbështetje të pamjaftueshme për të mbijetuarat, si dhe në pengesa për kompensimin dhe të drejtat ligjore.<sup>16</sup> Raporti kritikon gjithashtu fushatat e informimit publik që kryesisht i inkurajojnë të mbijetuarat që t'i raportojnë rastet në polici, ndërkohë që nuk e sfidojnë mjaftueshëm trajtimin pa respekt nga zyrtarët e zbatimit të ligjit pas raportimit. Sipas ekspertëve, media luan një rol kryesor në shmangien e raportimeve të bujshme duke dekurajuar arsyetimet për veprimet e autorëve.<sup>17</sup>

9 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 30-31

10 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023 dhe Raporti Vjetor i MKPT-së për vitin 2022.

11 QKRMT (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

12 Po aty.

13 Përkufizimi i *femicidit* mbështetet tek [Un Women](#) dhe mund të formulohet si më poshtë: "vrasje e qëllimshme e lidhur me gjininë që mund të motivohet nga rolet e stereotipizuara gjinore, diskriminimi ndaj grave dhe vajzave, marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, ose norma të dëmshme shoqërore".

14 Kosovo Online 2023, [Analizë: Dhuna kundër grave në rajon: femicid - një fjalë që lëndon dhe paralajmëron](#)

15 Amnesty International (2023), [Kosovë: Autoritetet nuk i mbështesin viktimat e dhunës](#)

16 Amnesty International (2023), [Kosovë: Autoritetet nuk i mbështesin viktimat e dhunës](#)

17 Kosovo Online 2023, [Analizë: Dhuna kundër grave në rajon: femicid - një fjalë që lëndon dhe paralajmëron](#)

## 23. Rekomandime

- Ministria e Shëndetësisë duhet ta miratojë Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2023-2030;
- Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë duhet të synojnë përmbushjen e normave mesatare të BE-së prej 11 përqind për shpenzimet shëndetësore;
- Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë duhet të forcojnë programet e promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve me fokus të veçantë në sëmundjet kardiovaskulare dhe kancerin;
- Ministria e Shëndetësisë duhet të krijojë programe sistematike të depistimit të kancerit;
- Sistemi informativ i shëndetësisë publike duhet të funksionalizohet përmes Ministrisë së Shëndetësisë duke u përafuar me treguesit bazë evropianë dhe rregulloret e BE-së;
- Programet rutinore të imunizimit duhet të forcohen nga Ministria e Shëndetësisë për të siguruar që shkallët e mbulimit të kthehen në nivelet e para Covid-19;
- Pretendimet për keqtrajtim nga zyrtarët policorë duhet të merren seriozisht nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe duhet të sigurohet llogaridhënie për çdo sjellje jo-profesionale nga zyrtarët policorë;
- Ministrinë si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimet Sociale duhet të zhvillojnë strategji afatgjata gjithëpërfshirëse dhe të përqendruara të mbijetuarit për të adresuar dhe parandaluar rastet e dhunës në familje.

## 5.2 Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues

**24.** Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues njihet ndërkombëtarisht me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj, neni 5), Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (neni 1) dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 7). Në nivel lokal, Kushtetuta e Kosovës (neni 27) ndalon çdo lloj trajtimi çnjerëzor, torturë ose mizori në përputhje të plotë me standardet ligjore të njohura ndërkombëtarisht (neni 22).

**25.** Në përputhje me nenin 5 të DUDNj-së dhe nenin 27 të Kushtetutës së Kosovës, e drejta për trajtim njerëzor dhe ndalimi i torturës ka të bëjë, ndër të tjera, me integritetin fizik dhe mendor të personave të paraburgosur dhe të burgosur, kushtet e paraburgimit, përdorimi i forcës nga zyrtarët e zbatimit të ligjit ndaj civilëve dhe individëve jashtë paraburgimit dhe dhunës në komunitet dhe në familje.

**26.** Teksa sistemi legjislativ në thelb mbronë kundër keqtrajtimit dhe torturës, nevojiten hapa të mëtejshëm për të siguruar që ato të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë. Sipas OJQ QKRMT, dhe përkundër raporteve publike të MKPT-së të përmendura më herët, rastet e përdorimit të tepruar të forcës dhe keqtrajtimit bien ndesh me këndvështrimet e të burgosurve siç janë raportuar prej tyre. Vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet raportimit të rasteve të keqtrajtimit të mundshëm dhe izolimit të të burgosurve të mitur.<sup>18</sup>

18 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**27.** Për më tepër, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka regjistruar 14 raste të keqtrajtimit nga policia (krahasuar me 11 në vitin paraprak). Raporti i Komisionit Evropian thekson se të gjitha rastet janë referuar në prokurori. Një zyrtar policor u arrestua dhe u suspendua. Akuzat për keqtrajtim dolën edhe gjatë arrestimit të 4 serbëve të Kosovës lidhur me ngjarjet e 29 majit në Zveçan. IAP-ja ka pranuar 6 ankesa kundër zyrtarëve policorë të Kosovës për përdorim të forcës së tepruar që ka çuar në inicimin e 3 hetimeve.<sup>19</sup>

**28.** Funksionimi i Panelit për Lirim me Kusht mbetet një çështje shqetësuese për të dënuarit, edhe pse OJQ QKRMT ka pranuar disa ndryshime pozitive nga disa institucione korrektuese, dhe ankesat kryesore të të dënuarve ende kanë të bëjnë me përmbajtjen e arsytimit të vendimeve të paneleve dhe vonesat në shqyrtim dhe përgjigje. Arsyetimi është kryesisht se modelet/shabllonet shpesh nuk janë në përputhje me raportet pozitive të institucioneve korrektuese apo përfitimet që i gëzojnë të dënuarit si rezultat i sjelljes së tyre gjatë vuajtjes së dënimit.<sup>20</sup>

**29.** Zbatimi i trajtimit të barabartë të të paraburgosurve në sistemin korrektues nuk mund të kuptohet plotësisht pasi nuk janë miratuar ende vlerësimet individuale të standardizuara.<sup>21</sup> Sipas OJQ QKRMT, Shërbimi Korrektues i Kosovës ende nuk ka arritur t'i zbatojë programet e duhura rehabilituese dhe riintegruese për të dënuarit në bazë të kërkesave dhe nevojave individuale, kështu që kjo çështje mbetet sfidë sa i përket riintegrit të të burgosurve pas përfundimit të dënimit. Janë organizuar grupe punuese për rishikimin e planeve dhe programeve të rehabilitimit të të burgosurve, por ende nuk ka rezultate konkrete në praktikë.<sup>22</sup>

**30.** Përgjatë vitit 2023 kanë vazhduar sfidat në luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Aktualisht, 19 të burgosur në burgjet e Kosovës janë të dënuar për krime të lidhura me terrorizmin.<sup>23</sup> Nga janari deri në qershor 2023, 5 të burgosur të dënuar u liruan. Sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian, dënimet për luftëtarët e huaj terroristë kanë qenë relativisht të buta, mesatarisht 3.6 vjet.<sup>24</sup>

**31.** Sipas OJQ QKRMT, situata në Kosovë sa i përket të drejtës për trajtim njerëzor dhe ndalimit të torturës gjatë vitit 2023 nuk ka ndryshuar shumë nga viti paraprak. Zhvillimi më i dukshëm është inaugurimi i pavijonit D kushtuar vendosjes së personave me nevoja të veçanta, në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i cili u bë në fillim të vitit 2023, ndonëse funksionalizimi i tij u ndesh me vonesa për disa muaj. Kategorizimi i të burgosurve të vendosur në pavijonin D përcaktohet nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve. Megjithatë, është jetike të pranohet se kapaciteti i pavijonit është i kufizuar, duke akomoduar të burgosur nga kategori të ndryshme. Janë vënë re disa përmirësime në kornizën ligjore, duke përditësuar një akt nënligjor në përputhje me kornizën e re ligjore të hyrë në fuqi në vitin 2022.<sup>25</sup>

19 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 30-31.

20 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

21 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

22 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

23 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 50.

24 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 50.

25 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**32.** Në vitin 2023, ndryshime të rëndësishme në politikat buxhetore brenda Ministrisë së Drejtësisë mund të paralajmërojnë një trajktore transformuese për Shërbimin Korrektues të Kosovës.<sup>26</sup> Viti i ardhshëm, 2024, premtion një rritje të konsiderueshme të buxhetit të ndarë, duke treguar një përpjekje të qëllimshme për të forcuar infrastrukturën dhe për të ngritur cilësinë e shërbimeve. Një përpjekje e rëndësishme në këtë drejtim pozitiv është fillimi i ndërtimit të Shtëpisë për Nënën, me synimin që të shërbejë për nënat e burgosura dhe nevojat e tyre.<sup>27</sup>

**33.** Për më tepër, dispozitat buxhetore largpamëse përfshijnë fondet e destinuar për ngritjen e një institucioni krejtësisht të ri burgu dedikuar grave të burgosura, me zbatim të planifikuar për vitin 2024. Përmirësimet e parashikuara pasqyrojnë një qasje progresive drejt rehabilitimit dhe mirëqenies së individëve të burgosur, duke shënuar një hap përpara në fushën e shërbimeve korrektuese.<sup>28</sup>

**34.** Përgjatë vitit 2023 kanë vazhduar përpjekjet për rekrutimin e stafit, duke shënuar veçanërisht rritje të konsiderueshme në rekrutimin e grave si zyrtare korrektuese, që përbën një arritje të rëndësishme për sistemin e burgjeve në Kosovë.<sup>29</sup>

**35.** OJQ QKRMT ka realizuar gjithsej 18 vizita monitoruese në institucionet korrektuese gjatë vitit 2023. Teksa rastet e keqtrajtimit dhe përdorimit të forcës ndaj të burgosurve ishin përgjithësisht të rralla, kishte pretendime të izoluara për forcë dhe ngacmim verbal nga stafi i burgut. Shqetësim i veçantë është numri i lartë i pretendimeve që u shfaqën nga të burgosurit e mitur, të cilët raportuan keqtrajtim fizik dhe verbal nga disa zyrtarë korrektues. Për më tepër, përdorimi i paautorizuar i izolimit për të burgosurit e mitur, përkundër ndalimit të tij shprehimisht me ligj, ngriti një shqetësim të madh. Dhuna ndërmjet të burgosurve ka ndodhur në mënyrë sporadike, veçanërisht në Qendrën Korrektuese në Dubravë.<sup>30</sup>

**36.** OJQ QKRMT ka identifikuar një rast të sulmit seksual të kryer nga një i burgosur ndaj tjetrit. Ky incident është raportuar tek autoritetet kompetente, me OJQ QKRMT që avokon për trajtimin profesional të rastit dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme.<sup>31</sup>

**37.** Edhe pse është arritur marrëveshja për transferimin e të burgosurve nga Danimarka në Kosovë, viti 2023 nuk ka sjellë qartësi në lidhje me aspektet kohore se kur do të zbatohet marrëveshja. Veçanërisht, të ndaluarit e huaj do të dërgohen në burgjet e Kosovës.<sup>32</sup> Vendimi i Ministrisë së Drejtësisë është parë me shqetësim nga OJQ QKRMT, pasi zhvendosja e 200 të burgosurve nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan mund të përkeqësojë mbipopullimin dhe të degradojë kushtet në objektet e tjera korrektuese. Mbiipopullimi veçse ka qenë një problem i tejkualuar nga institucionet korrektuese të Kosovës dhe është vlerësuar se i plotëson standardet e kërkuara ndërkombëtare. OJQ QKRMT vlerëson se ky standard i mirë i vendosur tashmë në institucionet korrektuese të Kosovës mund të priset shumë lehtë përmes akomodimit të të burgosurve nga Danimarka.<sup>33</sup>

26 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

27 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

28 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

29 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

30 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

31 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

32 Euronews (2022), [Danimarka arrin marrëveshje prej 15 milionë eurosh për dërgimin e 300 të burgosurve në Kosovë](#).

33 QKRMT (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

**38.** Pas miratimit të Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Kosovë në dhjetor të vitit 2022, në vitin 2023 janë mbajtur sesione trajnimi gjithëpërfshirëse për të trajnuar zyrtarët publikë për zbatimin efektiv të dispozitave të protokollit. Nisma e organizuar nga OJQ RrGK pasqyron përkushtimin për të siguruar që institucionet dhe personeli të jenë të përgatitur mirë për t'iu përgjigjur incidenteve të dhunës seksuale, në përputhje me qëllimin e protokollit për ofrimin e intervenimeve të menjëhershme dhe të përgjegjshme për identifikimin, mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimave të dhunës seksuale.<sup>34</sup>

**39.** Në një zhvillim të rëndësishëm, Gjykata Themelore në Prishtinë, gjatë vitit 2023, aprovoi kërkesën për kompensim të një të burgosuri i cili ishte sulmuar seksualisht në vitin 2014. OJQ QKRMT e ka mbështetur dhe përfaqësuar me vendosmëri këtë rast prej vitit 2014. Gjykata Themelore në Prishtinë e ka aprovuar pjesërisht kërkesën për dëmshpërblim, duke mandatuar Ministrinë e Drejtësisë, veçanërisht Shërbimin Korrektues të Kosovës, përgjegjës në momentin e incidentit, që ta kompensojnë viktimën e përdhunimit brenda burgut. Ky vendim historik shënon rastin e parë të këtij lloji.

**40.** Vendosja dhe trajtimi i kryerësve me çrregullime mendore mbetet një nga çështjet më sfiduese në Shërbimin Korrektues të Kosovës edhe gjatë vitit 2023. Edhe pse me ligj parashikohen dispozitat relevante për këtë kategori të burgosurish, situata mbetet pothuajse e njëjtë në praktikë. Teksa korniza ligjore ka paraparë që paraburgimi i kryerësve me çrregullime mendore të bëhet në institucionet shëndetësore, sistemi ynë korrektues dhe shëndetësor nuk ka institucione të posaçme për zbatimin e paraburgimit për raste të tilla. Funksionalizimi i pavijonit D (i dedikuar për vendosjen e personave me nevoja të veçanta) e ka përmirësuar pak situatën, por duke qenë se ky pavijon akomodon kategori të tjera të burgosurish, situata vazhdon të mbetet e vështirë, pasi që në disa qendra numri i të burgosurve me probleme çrregullime mendore vazhdon të jetë i lartë.<sup>35</sup>

**41.** Zhdukja e papritur e mostrave të Astrit Deharit nuk u zgjidh në vitin 2023 dhe vazhdon të ngrejë shqetësime për procesin hetimor për vdekjen e Deharit. Veçanërisht, MD-ja ndërhyri në punën e prokurorisë duke komentuar se zhdukja e mostrave ishte kryer me paramendim për të penguar hetimin për vdekjen e Deharit, dhe për pasojë pezulloi nga puna 4 zyrtarë të mjekësisë ligjore, megjithëse autori ende nuk është identifikuar.<sup>36</sup>

## 42. Rekomandime

- Shërbimi Korrektues i Kosovës duhet të forcojë mekanizmat e veta monitorues dhe masat e llogaridhënies për rastet e keqtrajtimit ndaj individëve të burgosur dhe personave të paraburgosur;
- Inspektorati Policor i Kosovës duhet të zbatojë masa korigjuese për adresimin e rasteve të keqtrajtimit nga zyrtarët policorë dhe të rrisë transparencën në hetimet e veta;

34 RrGK (2023), [RrGK përfundon ciklin e trajnimit për Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#).

35 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

36 Koha (2023), [Nesër protestë për Astrit Deharin](#)

- Sistemi Gjyqësor i Kosovës, duke përfshirë por pa u kufizuar në Ministrinë e Drejtësisë, dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të rivlerësojnë praktikën ndëshkimore për krimet e lidhura me terrorizmin për të siguruar një qasje më parandaluese duke përfshirë mekanizmat përcjellës dhe rehabilitues;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të trajtojë çështjen e proceseve të zgjata gjyqësore, veçanërisht për të paraburgosurit, brenda një afati të arsyeshëm;
- Funksionimi i Panelit të Lirimit me Kusht duhet të përmirësohet me transparencë të shtuar dhe drejtësi në proceset e vendimmarrjes së Panelit.

### 5.3 E drejta për liri dhe siguri personale

**43.** E drejta për liri dhe siguri personale njihet hapur në nivel ndërkombëtar me nenet 3, 4 dhe 9 të DUDNj-së dhe në nenin 5 të KEDNj. Në përkufizimin e saj, e drejta për liri dhe siguri janë të drejta të ndërthurura me njëra tjetrën, që do të thotë se siguria dhe liria nuk mund të trajtohen veçmas nga njëra-tjetra. Neni 29 i Kushtetutës së Kosovës parasheh se: "Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim: pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale; për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale; për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm; për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë; për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim." Kufizimet ligjore të lirisë së një personi janë të përcaktuara më tej në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur (KDM).

**44.** Ligji Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, lëvizja e të cilëve është kufizuar me vendim gjykatë nuk është zbatuar ende tetë vjet pas hyrjes në fuqi në vitin 2015. Nxitur nga vrasja e Hamide Magashit dhe incidente të tjera ku autorëve të krimit u ishte lëshuar urdhër i ndalimit nga gjykata, Kuvendi i Kosovës e riktheu në agjendë çështjen e mbikëqyrjes elektronike në dhjetor të vitit 2022.<sup>37</sup> Në vitin 2023, Qeveria e Kosovës ka ndarë fonde (600,000 euro) për zbatimin e sistemit elektronik të monitorimit, i cili synon të rrisë mbrojtjen dhe sigurinë e të mbijetuarve të dhunës, duke zbutur mundësinë e përsëritjes së veprave penale.<sup>38</sup>

**45.** Në vitin 2023, dialogu Kosovë-Serbi rifilloi me marrëveshjen për Rrugën drejt Normalizimit, e cila u arrit në Ohër (Maqedonia e Veriut).<sup>39</sup> Marrëveshja e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përfshin nisjen e negociatave për vetë-menaxhimin e komunitetit serb në Kosovë dhe miratimin e Deklaratës për Personat e Zhdukur. Megjithatë, për shkak të dallimeve të vazhdueshme lidhur me zbatimin e përgjithshëm të marrëveshjes dhe një sërë zhvillimesh në përshkallëzim në veri që ndikojnë në situatën e sigurisë në Kosovë, zbatimi i marrëveshjes ka hasur në pengesa.<sup>40</sup> Si rezultat, BE-ja vendosi sanksione ndaj Kosovës që dërguan në përjashtimin e financimeve dhe investimeve rajonale, si dhe marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe (ekonomike).<sup>41</sup>

37 Kallxo (2022), [Vrasja e shtatzënës, Kurti kërkon mobilizimin e institucioneve për mospërsëritje të rasteve.](#)

38 Telegrafi (2023), [Ndahen 600 mijë euro për vendosjen e sistemit për mbikëqyrjen e hallkave elektronike që do t'i vendosen dhunuesve.](#)

39 Balkan Insight (2023), [Serbia dhe hedhin hapat e parë për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit me lehtësimin e BE-së](#)

40 The Guardian (2023), [Kryeministri i Kosovës Albin Kurti thotë se bisedimet me Serbinë janë sërish në ngërc.](#)

41 Financial Times (2023), [BE-ja godet Kosovën me sanksione pasi pas rindezjes së tensioneve me serbët.](#)



**46.** Në përputhje me paragrafin paraprak, bojkotimi i zgjedhjeve të parakohshme lokale në prill 2023 nga serbët e Kosovës e pengoi përparimin e Dialogut. Pjesëmarrja më e ulët ndonjëherë ishte në vetvete pasojë e largimit të serbëve nga të gjitha institucionet në nëntor 2022, me bojkotin e mëvonshëm si protestë për kërkesat e paplotësuara për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.<sup>42</sup> Në raportin e Komisionit Evropian thuhet se tërheqja e serbëve të Kosovës nga institucionet në nëntor 2022 dhe bojkotimi i zgjedhjeve lokale të prillit 2023 në veri të Kosovës, janë shkelje e detyrimeve të Serbisë në kuadër të Dialogut, me Serbinë që ka hedhur hapa të konsiderueshëm mbrapa në respektimin e Marrëveshjes. Komisioni Evropian kërkon kthimin e menjëhershëm të serbëve në institucione dhe Kosova inkurajohet që ta mundësojë këtë kthim. Përpjekjet e Policisë së Kosovës për të rekrutuar kadetë të rinj nga serbët e Kosovës nuk kanë ndjekur procedurat e përcaktuara në marrëveshjet e Dialogut.<sup>43</sup>

**47.** Duke nënvizuar vazhdimësinë e tensioneve etno-politike, dhuna që shpërtheu në veri të Kosovës më 29 maj ndërmjet protestuesve serbë të Kosovës dhe ushtarëve paqeruajtës të NATO-s, la të lënduar më shumë se 50 protestues serbë të Kosovës dhe të paktën 25 ushtarë italianë dhe hungarezë të KFOR-it. Përplasjet filluan kur serbët lokalë protestuan kundër kryetarit të sapozgjedhur shqiptar të Zveçanit; praktikisht, kryetarë shqiptarë morën detyrën në zonat me shumicë serbe pas zgjedhjeve të bojkotuar nga serbët në prill 2023.<sup>44</sup> Para dislokimit të KFOR-it, OJQ IRS thekson se një konflikt fillestar kishte filluar mes banorëve dhe zyrtarëve policorë.<sup>45</sup>

**48.** Sulmi terrorist i një grupi paraushtarak serb kundër Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë në veri të Kosovës më 24 shtator 2023, ka ngritur shqetësime të konsiderueshme të sigurisë dhe alarm ndërkombëtar për stabilitetin e rajonit.<sup>46</sup> Ngjarja ka rezultuar me vdekjen e rreshterit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili pas vdekjes u nderua me urdhrin Hero i Kosovës.<sup>47</sup> Sulmuesit kërkuan strehim në Manastirin e Banjskës, që përfundimisht u rimor nga Policia e Kosovës, duke çuar në vdekjen e tre militantëve serbë dhe konfiskimin e një sasive të konsiderueshme armësh. Nënkryetari i partisë politike Lista Serbe, Milan Radoiçiq, pranoi përgjegjësinë për sulmin, duke rezultuar në një urdhër arrest për të.<sup>48</sup> Kosova, Shqipëria, Bashkimi Evropian dhe vende të tjera e dënuan sulmin si terrorizëm.<sup>49</sup>

**49.** Lidhur me paragrafin paraprak, çështja e sigurisë në mesin e komunitetit serb në Kosovë mbetet veçanërisht relevante.<sup>50</sup> OJQ IRS thekson se incidenti i ndodhur më 29 maj para ndërtesës së komunës në Zveçanit u ndoq me një sërë arrestimesh të qytetarëve të cilët dyshoheshin se kishin marrë pjesë në veprime të dhunshme me atë rast.<sup>51</sup> Megjithatë, disa arrestime janë bërë

42 The Guardian (2023), [Kryeministri i Kosovës Albin Kurti thotë se bisedimet me Serbinë janë sërish në ngërç.](#)

43 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 80.

44 Reuters (2023), [Ushtarë të NATO-s lëndohen në përplasjet me protestues serbë](#)

45 Radio Free Europe (2023), [Policia e Kosovës përplasjet me protestuesit në qytetet veriore me shumicë serbe, duke marrë qortime nga SHBA dhe BE.](#)

46 The Guardian (2023), [Kosova akuzon Serbinë se qëndron pas 'sulmit terrorist' kundër saj dhe bën thirrje për 'veprim të qartë' nga BE-ja dhe perëndimi.](#)

47 Koha (2023), [heroi i Kosovës, Afrim Bunjaku, varroset me nderime të larta.](#)

48 Balkan Insight (2023), [Interpoli lëshon urdhër arresti për Radoiçiqin për sulmin në Banjskë në Kosovë.](#)

49 Parlamenti Evropian (2023), [Serbia dhe Kosova duhet të punojnë për de-përshkallëzim të situatës në veri të Kosovës](#)

50 IRS (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

51 IRS (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

pa urdhër të lëshuar më parë nga prokuroria. Ky problem u trajtua edhe nga Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Josep Borell, duke deklaruar se “arrestimet arbitrare ose të padrejta dhe keqtrajtimi i të burgosurve janë absolutisht të papranueshme”.<sup>52</sup>

**50.** Më tej, OJQ IRS vëren se pas arrestimit të N.V. nga Leposaviqi, në kuadër të publikimit të provave për pjesëmarrje në veprën për të cilën akuzohet, Ministri i Punëve të Brendshme Xhelal Sveçla ka publikuar një foto/screenshot nga video që tregon një person tjetër, jo personin N.V.<sup>53</sup> Sipas OJQ IRS, dy serbë të Kosovës janë arrestuar gjatë protestës paqësore më 29 maj para fillimit të incidentit mes demonstruesve dhe anëtarëve të KFOR-it. Teksa njëri prej tyre (R.P.) u lirua pasi kishte paguar dorëzani, tjetri (D.O.) qëndroi në paraburgim deri para pak kohësh, megjithëse ka të dhëna se ai nuk mori pjesë në dhunën e asaj dite.<sup>54</sup>

**51.** OJQ IRS ka ngritur më tej një numër çështjesh të sigurisë kur është fjala për komunitetin serb. Më 6 janar, në prag të Krishtlindjeve ortodokse, një pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës qëllon me armë zjarri, duke plagosur dy të mitur serbë nga Gotovusha, komuna e Shtërpcës.<sup>55</sup> Po ashtu, në pikën e kontrollit afër urës së Bisticës, të vendosur nga njësitet speciale të Policisë së Kosovës, serbët janë plagosur në dy raste - më 23 janar dhe 11 prill.<sup>56</sup>

## 52. Rekomandime

- Shërbimi Korrektues i Kosovës duhet t’i japë përparësi parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në sistemin korrektues, duke ofruar mbështetje për mekanizmat për deradikalizimin e të burgosurve, si dhe ofrimin e mbështetjes për shëndet mendor dhe mbështetjes psikologjike për të burgosurit;
- Ministria e Drejtësisë (MD) duhet të ndërmarrë hapa aktivë për zbatimin e Ligjit Nr.05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, lëvizja e të cilëve është e kufizuar me vendim të gjykatës;
- Prokuroria e Shtetit duhet t’i adresojë dhe t’i japë prioritet problemeve të sigurisë në mesin e komuniteteve jo-shumicë duke ndërmarrë hapa konkretë për t’i hetuar incidentet e përdorimit të forcës së tepruar dhe duke siguruar që të gjithë qytetarët të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur;
- Inspektorati Policor i Kosovës duhet ta rrisin llogaridhënien dhe t’i përmirësojnë mekanizmat e hetimit në lidhje me sjelljet e pahijshme nga ana e policisë;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata Supreme duhet t’u bëjnë thirrje të gjitha gjykatave penale që t’i zbatojnë si duhet dispozitat që kanë të bëjnë me përdorimin e paraburgimit dhe t’i shqyrtojnë alternativat në vend të paraburgimit.

52 EEAS (2023), [Kosovë-Serbi: Fjala për shtypin e Përfaqësuesit të Lartë/Zëvendës Presidentit Josep Borrell pas takimeve për menaxhimin e krizës me kryeministrin Kurti dhe presidentin Vuçiq](#)

53 KoSsev (2023), <https://kossev.info/advokat-potvrديو-da-uhapseni-mladic-u-leposavicu-nije-napadac-na-novinara-sveclja-objavo-pogresnu-fotografiju/>

54 N1 (2023), [Objavljeni snimci: Petrović i Obrenović privedeni pre početka nereda u Zvečanu](#)

55 Koha.net (2023), [Një muaj paraburgim për Azem Kurtajn për lëndimin e dy personave në Shtërpcë - KOHA.net](#)

56 Gorazdevac (2023), [Petković: Specijalci pucali na vozilo kod Bistričkog mosta, ranjen Srbin.](#)

## 5.4 E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive

**53.** E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive njihet ndërkombëtarisht si një e drejtë themelore e njeriut me nenin 10 të DUDNj-së, i cili thotë se: “secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik [...]”<sup>57</sup> Neni 6 i KEDNj-së përfshin gjithashtu të drejtën për një gjykim të drejtë dhe më tej përcakton se “secili ka të drejtë për një seancë të drejtë gjyqësore dhe publike brenda një afati të arsyeshëm [...]”<sup>58</sup> Në kornizën legjislative të Kosovës, këto standarde ligjore ndërkombëtare janë të detyrueshme; ato parashikohen edhe në Kushtetutë me anë të nenit 22. Për më tepër, neni 30 parashikon të drejtat e të akuzuarve dhe në nenin 31 theksohen dispozitat për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Neni 32 i Kushtetutës parasheh të drejtën e secilit për të përdorur mjete juridike “kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që cenojnë të drejtat ose interesat e tij/saj”<sup>59</sup> Përveç Kushtetutës, ligjet dhe rregulloret e tjera të miratuara nga Qeveria e Kosovës rregullojnë të drejtën për gjykim të drejtë në procedurat gjyqësore në çështjet penale, civile dhe administrative. Këto përfshijnë Kodin Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (KPPK), Kodin Nr. 06/L-074 Penal (KPK), Ligjin Nr. 03/006 për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative.

**54.** Në vitin 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi Kodin Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, i cili hyri në fuqi në shkurt 2023.<sup>60</sup> Sipas Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2022, KPPK i ri korrespondon me standardet e BE-së në atë që nga pikëpamja procedurale, të drejtat e të dyshuarve dhe të akuzuarve mbrohen duke përfshirë të drejtën për një avokat, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për interpretim dhe përkthim, për të përmendur vetëm disa nga standardet ligjore.<sup>61</sup> Për më tepër, Kodi i përditësuar i Procedurës Penale korrigjon mangësitë në procedimet penale, duke lehtësuar seancat gjyqësore online në rrethana të jashtëzakonshme, si epidemitë dhe fatkeqësitë natyrore, dhe duke formalizuar praktikën e palëve që pranojnë reciprokisht dëshmitë e mëparshme si pjesë të procesverbaleve.<sup>62</sup>

**55.** Ligji Nr. 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas u ndryshua pjesërisht në mënyrë që të përfshijë ndihmën juridike falas për përfitues të ndryshëm, p.sh. gazetarët, fotoreporterët dhe akterët e tjerë kur paditen për një sërë shkeljesh të supozuara, duke përfshirë shpifje dhe padi strategjike kundër pjesëmarrjes.<sup>63</sup> Një dimension tjetër i rëndësishëm i ligjit ka të bëjë me inkorporimin e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas (ANJF) në MD. Inkorporimi i ANJF në MD pasqyron kalimin e një agjencie të pavarur nën ombrellën e MD. Sipas OJQ IKD, kjo është jokushtetuese. Përkatësisht i jep MD-së autoritetin për të përcaktuar kriteret për ndihmën juridike falas.<sup>64</sup>

**56.** Në Kosovë është krijuar një fond për të ofruar ndihmë juridike për individët e akuzuar në Dhomat e Specializuara të Kosovës, së bashku me ndihmën financiare për familjet e tyre, pavarë-

57 DUDNj, [neni 10](#).

58 KEDNj, [neni 6](#).

59 Kushtetuta e Kosovës (2008), nenet 30-31.

60 Kodi i Procedurës Penale [Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale](#)

61 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

62 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

63 Ligji Nr. 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas.

64 IKD (2022), [Politizimi kundërkushtetues i ANJF](#).

sisht nga nevoja e demonstruar financiare.<sup>65</sup> Veçanërisht, viktimat e njohura nga Dhomat e Specializuara të Kosovës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nuk kanë marrë mbështetjen përkatëse financiare. Edhe pse Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë lëshuar vendime fillestare për dëmshpërblim për viktimat, burimi i kompensimit mbetet i paqartë për shkak të mungesës së fondeve nga të akuzuarit apo nga një fond i dedikuar kosovar. Korrigjimi i kësaj pabarazie në trajtim është thelbësor, sipas Komisionit Evropian dhe një numri të OShC-ve.<sup>66</sup>

**57.** Mospërputhjet ndërmjet politikave dhe praktikës vazhdojnë në sistemin gjyqësor. Sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2023, edhe pse mund të vërehet një rritje e dukshme në numrin e procedimeve gjyqësore efektive, caktimin e përshpejtuar të seancave dhe përmirësime në rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, jo-efikasiteti vazhdon.

**58.** Përdorimi i tepruar i paraburgimit ngre shqetësime në një raport të fundit të OSBE-së për Kosovën. Në raport, janë shqyrtuar gjithsej 70 seanca "paraburgimi" dhe nëntë vendime të apelit përgjatë viteve 2022 dhe 2023, duke theksuar mungesën e opsioneve alternative të ndalimit dhe arsyetimin jo-adekuat në vendime.<sup>67</sup>

**59.** Në dhjetor të vitit 2023 Gjykata Kushtetuese e Kosovës miratoi me shumicë votash një kërkesë për rishikim kushtetues të një amendamenti të propozuar kushtetues që lejon kontrole të përkohshme të integritetit të figurave kyçe të sistemit të drejtësisë, si anëtarët e Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, kryetarët e gjykatave, kryeprokurorët, dhe kandidatët për këto role, nga Autoriteti i Kontrollit të Integritetit. Njëkohësisht, dy amendamente të tjera të propozuara që trajtojnë kriteret për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të mospërmbushjes së rëndë të detyrave, u vlerësuan se nuk cenojnë të drejtat themelore. Prosesi i vetingut nisi me miratimin e "Koncept Dokumentit për Zhvillimin e Procesit të Vetingut në Sistemin e Drejtësisë" në tetor 2021. Më pas, Komisioni i Venecias miratoi koncept dokumentin dhe propozoi ndryshime kushtetuese në qershor 2022. Gjykata Kushtetuese theksoi rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe prokurorial si parime themelore në rendin kushtetues. Funksionimi i duhur i drejtësisë, duke përfshirë besimin e publikut, mbetet një vlerë thelbësore në çdo shoqëri demokratike.<sup>68</sup>

**60.** Më 23 nëntor 2023, Qeveria e Kosovës nxori një vendim të konsideruar jo-kushtetues për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo mënyrë veprimi minon hapur pavarësinë e gjyqësorit, një element thelbësor i gjykimit të drejtë. Vendimi i Qeverisë u anulua nga Gjykata përmes procedurave të konfliktit administrativ, pasi tendencat për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk u miratuan as nga Gjykata Kushtetuese, e cila shfuqizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik që synonin uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve.<sup>69</sup>

**61.** Në mars 2023, Ministria e Drejtësisë dhe udhëheqësit e institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë miratuan kolektivisht një Deklaratë të Zotimit për reformë në drejtësi, duke nënvizuar çështjet thelbësore të reformës që kërkojnë vëmendje. Nevojitet veprim i menjëhershëm dhe efektiv për realizimin e rezultateve të prekshme.<sup>70</sup>

65 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 23.

66 YIHR (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në vitin 2023.

67 OCHA (2023), [Raporti i monitorimit të gjykimit për paraburgimin](#).

68 Betimi për Drejtësi (2023), [Gjykata Kushtetuese i hap rrugë Vetingut në sistemin e drejtësisë](#)

69 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

70 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 80.

**62.** Në prill të vitit 2023, KGJK-ja miratoi një sërë rregulloresh që përshkruan standardet e performancës që priten nga gjyqtarët, me qëllim të rritjes së efikasitetit operacional. Siç u theksua në raportet e mëparshme (2021 dhe 2022), gjyqësori dhe prokuroria hasin sfida në trajtimin e lëndëve në mënyrë të shpejtë. Krahasuar me vitet e mëparshme, vërehet një trend pozitiv në aspektin e procedimeve gjyqësore produktive.<sup>71</sup>

**63.** Masat mbrojtëse ligjore, si e drejta për gjykim të drejtë dhe përfaqësim ligjor, janë gjithashu komponentë thelbësorë e të drejtave të burgosurve. OJQ QKRMT ka pranuar ankesa të vazhdueshme nga të burgosurit lidhur me procesin ligjor në gjykata, me zvarritjen e procesit gjyqësor si një nga çështjet kryesore, veçanërisht për të paraburgosurit, ku ka raste të paraburgimit për disa vite. Kjo përbën shkelje të një prej parimeve themelore të të drejtave të njeriut, parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga dokumentet ndërkombëtare si dhe legjislacionit vendor, por ka ende shumë punë për të bërë për ta përmirësuar këtë çështje në praktikë.<sup>72</sup>

**64.** Viktimat e krimit nuk janë të informuar mjaftueshëm për procedurat ligjore dhe rrallëherë asistohen nga përfaqësuesit profesionistë. Sipas të dhënave të ofruara nga OJQ IKD, buxheti i ndarë për ndihmë juridike mbetet i pamjaftueshëm, edhe pse pati një rritje të parashikuar në krahasim me vitet paraprake (shih tabelën 1 më poshtë).<sup>73</sup>

**Tabela 1. Buxheti i Qeverisë i ndarë për ndihmë juridike**

	2024	2023	2022	2021	2020
Buxheti total i ndarë nga Qeveria e Kosovës për ndihmë juridike në EUR	537,831	444,170	443,995	439,298	422,699

**65.** Çështja e procedurave të gjata ligjore, përkatësisht gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në Kosovë, paraqet një nga sfidat kryesore që ka të bëjë me realizimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm dhe në të njëjtën kohë cenon qasjen adekuate të qytetarëve para drejtësisë. Përkundër përcaktimit ligjor të afateve procedurale, të cilat garantojnë gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, kohëzgjatja mesatare e përgjithshme e lëndëve gjyqësore civile, prej 3.8 vjet në shkallën e parë dhe 1.7 vjet në shkallën e dytë, tregon mungesë respekti dhe trajtim të lëndëve gjyqësore brenda një periudhe kohore të paarsyeshme. Në këtë problem kanë ndikuar disa faktorë, si keqadministrimi i institucioneve, performanca e gjyqtarëve, si dhe administrimi jo-adekuat i drejtësisë.<sup>74</sup>

71 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 80.

72 QKRMT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

73 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

74 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**66.** Zvarritja procedurale dhe administrimi jo-adekuat i drejtësisë ndodhin edhe në rastin e rigjykimave të shumta. Mosrespektimi i komponentëve që lidhen me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm reflekton edhe mungesën e mbrojtjes adekuate të të drejtave të tjera, siç është e drejta pronësore. Gjatë monitorimit të sistemit të drejtësisë, u vu re se nuk ishin përmbushur standardet e duhura për arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Gjatë analizës së politikës ndëshkimore të aplikuar nga gjykatat, OJQ IKD ka theksuar mungesën e arsyetimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, mungesën e arsyetimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të aplikuara, si dhe shabllonin e arsyetimit për përmbushjen e qëllimit të ndëshkimit të shqiptuar.<sup>75</sup>

**67.** Në anën tjetër, arsyetimet e vendimeve gjyqësore duhet t'u përmbahen dhe t'u referohen instrumenteve ndërkombëtare, drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, një detyrim i tillë rrallëherë respektohet në praktikë. Sipas analizës së OJQ IKD për zbatimin e Konventës së Stambollit në aktgjykimet e gjykatave në Kosovë, gjykatat nuk u përmbahen dispozitave të kësaj Konvente të Stambollit dhe rrjedhimisht nuk i referohen asaj as në arsyetimin gjyqësor për rastet e dhunës në familje.<sup>76</sup>

**68.** Mungesa e përfaqësimit ligjor cilësor vazhdon të jetë problematike si një element thelbësor i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Mungesa e përfaqësimit ligjor është më e dukshme tek viktimat e dhunës në familje, edhe pse sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, këto të fundit janë subjekt i përfaqësimit profesional nga mbrojtësit e viktimave. Përkundër këtij përcaktimi, sipas të gjeturave të OJQ IKD, rreth 62 përqind e viktimave të dhunës në familje nuk kanë pasur përfaqësim profesional. Fatkeqësisht, edhe në rastet kur ka përfaqësim profesional, ka dilema të theksuara për cilësinë e këtij përfaqësimi. Kjo pasi që në 12 raste nga 15 gjithsej, ku ka qenë prezent përfaqësimi, mbrojtësi i viktimave nuk kishte paraqitur kërkesë pasurore juridike në procedurë penale. Mungesa e përfaqësimit të duhur shkakton humbje për palën e dëmtuar, që nga procedurat e caktimit të masave mbrojtëse e deri te parashtrimi i propozimit për realizimin e kërkesës pasurore juridike, lidhur me dëmet e shaktuara nga vepra penale. Rrjedhimisht, referimi në kontestin civil për realizimin e kërkesës pasurore shkakton një barrë për sistemin e drejtësisë, kështu që lënda që mund të kryhej në procedurë penale do të zhvillohet në procedurë civile, gjë që ndikon pashmangshmërisht në gjykimin brenda një kohe të arsyeshme. Pra, një administrim i tillë i drejtësisë ndikon tërthorazi në mospërkrahjen e viktimave të mundshme nga sistemi i drejtësisë penale.<sup>77</sup>

**69.** Sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2023, rastet në rritje të femicidit kanë ngritur shqetësime në lidhje me efikasitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Akuzat për mbrojtje jo-adekuate të viktimave dhe mungesë llogaridhënieje mes akterëve të drejtësisë kanë çuar në ndryshimet e propozuara në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale nga Ministria e Drejtësisë. Megjithatë, këto ndryshime duhet të përfshijnë masa mbrojtëse për persona të akuzuar ose të dënuar për vepra të tilla. Trajtimi, ndjekja penale dhe gjykimi i lëndëve ende përballet me probleme, pavarësisht emërimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve të specializuar, të penguar nga mungesa e burimeve të tjera njerëzore dhe kohëzgjatja e lëndëve.

75 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

76 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023

77 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023

**70.** OJQ IKD nuk ka identifikuar raste kur gjyqtarët apo prokurorët kanë shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë, por ka pasur situata ku akterët politikë e kanë shkelur këtë parim përmes deklaratave të tyre publike. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parimi i prezumimit të pafajësisë nuk lejon deklaratat nga autoritetet publike që mund të nxisin publikun të besojë se i akuzuari është fajtor, ose të paragjykojë vlerësimin e fakteve nga autoriteti gjyqësor. Kështu, parandalohet trajtimi jo-korrekt i personave që janë liruar nga akuzat penale ose kur procedimi penal ndaj tyre është pushuar, duke reflektuar pozitivisht në mënyrën e perceptimit të publikut për të mos cenuar reputacionin. Prandaj, marrë parasysh standardet e vendosura nga GjEDNj, viti 2023 ka qenë mjaft shqetësues për sa i përket numrit të lartë të deklarimeve të aktorëve politikë për çështje që kanë të bëjnë me raste individuale.<sup>78</sup>

**71.** Pavarësia e gjyqësorit është një tjetër element i rëndësishëm i një gjykimi të drejtë. Në këtë mënyrë, gjyqësori duhet të jetë i lirë nga presioni i jashtëm, dhe të mos i nënshtrohet ndikimit dhe manipulimit politik, veçanërisht nga ekzekutivi. Marrë parasysh se sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdon të ndikohet nga politika, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të siguruar që këto parime të respektohen në praktikë dhe për ta mbrojtur në mënyrë efektive sistemin gjyqësor nga presioni dhe ndërhyrjet e panevojshme. Në këtë drejtim, mirëfunksionimi dhe administrimi i drejtësisë, përfshirë besimin e publikut në këtë sistem, mund të arrihet nëpërmjet reformës në drejtësi dhe procesit të vetingut, proces i cili është miratuar nga Gjykata Kushtetuese.<sup>79</sup>

**72.** Në vitin 2023, shumë OShC dhe organe ndërkombëtare kanë theksuar mungesën e vazhdueshme të vullnetit politik për t'u përmbajtur nga ndërhyrja në gjyqësor. Në raportin "Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike", OJQ IKD ilustron me shembuj konkretë se si deklaratat e ekzekutivit dhe legjislativit paraqesin ndërhyrje në sistemin e drejtësisë.<sup>80</sup> Ndërhyrjet janë theksuar veçanërisht me shkarkimin e shefit të Njësisë Speciale të Kosovës. Për më tepër, sipas raportit të Indeksit të Transparencës (2023), ndërhyrjet e deputetëve të shumicës në hetimin parlamentar të një rasti të rëndësishëm korrupsioni, nënvizojnë temën gjithëpërfshirëse të mungesës së dukshme të vullnetit politik për të hequr dorë nga kontrolli dhe për të forcuar mbikëqyrjen e pavarur, duke kërcënuar kështu integritetin e sistemi gjyqësor.<sup>81</sup>

**73.** Lëndët penale për të mitur, për shkak të specifikave të tyre, kanë një rregullim të veçantë përmes Kodit Nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur. Nuk ka informacion të mjaftueshëm si trajtohen këto lëndë nga sistemi i drejtësisë, si pasojë e mungesës së lejes së mediave dhe shoqërisë civile për monitorimin e këtyre lëndëve, por edhe mbikëqyrjes jo-adekuate të këtyre lëndëve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës.<sup>82</sup>

**74.** Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka bërë përparim të madh sa i përket publikimit të aktgjykimeve në të gjitha gjykatat e Kosovës, në përputhje me ligjin. Deri më tani në faqen zyrtare janë publikuar rreth

78 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

79 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023

80 IKD (2024), [Raport: Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike](#).

81 Koha (2024), [TI: Nuk ka gatishmëri politike në Kosovë për të hequr dorë nga ndërhyrjet në gjyqësor](#)

82 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023

122 mijë aktgjykime, por synohet të vazhdohet deri në arritjen e publikimit në kohë reale. Publikimi i aktgjykimeve është i një rëndësie të veçantë për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në gjyqësor. Pamundësia e zbatimit të këtij detyrimi, në publikimin e aktgjykimeve në kohë reale nga gjykatat, lidhet me mungesën e burimeve njerëzore.<sup>83</sup>

**75.** E drejta e palëve ndërgjyqëse për përkthim është gjithashtu një komponent thelbësor i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo e drejtë është materializuar mjaftueshëm nga ligjet procedurale. Gjatë monitorimit, OJQ IKD nuk ka gjetur raste kur palëve iu është mohuar kjo e drejtë gjatë procedurës gjyqësore. Mirëpo, në kontekstin se gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë, në praktikë nuk ekziston një qasje e përgjithshme ndaj barazisë pasi që publikimi i aktgjykimeve nuk bëhet proporcionalisht në gjuhën serbe. Më tej, komentaret e ligjeve përkatëse janë dokumente shumë të rëndësishme për përdoruesit e gjykatave dhe zbatuesit e ligjeve. Fatkeqësisht, shumica e komentareve të publikuara tashmë nuk janë të përkthyer në serbisht. Pra, thjesht përmbushja e standardit të ofrimit të përkthimit për palët në proces nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme për kërkesat e aspektit kushtetues të dygjuhësisë.<sup>84</sup>

**76.** Në përgjithësi, ligji pozitiv në Kosovë ofron mjete juridike në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Një përjashtim është qasja në vendimet e Prokurorit të Shtetit për hudhjen poshtë të kallëzimeve penale apo ndërprerjen e hetimeve. Kjo çështje nuk konsiderohet se është trajtuar as me mundësinë e të drejtës për ankesë në Prokurorinë e Apelit pasi që nuk ofron mundësinë e një mjeti juridik në gjykatë. Kështu, edhe më tej, në procedurën penale, deri në momentin kur lënda shkon në gjykatë, ka shkelje të rëndë të së drejtës për mjete juridike. Në fakt, në tërësinë e sistemit juridik kosovar, këto akte prokuroriale janë të vetmet akte të cilave iu mohohet qasja në gjykatë.<sup>85</sup>

**77.** Në nëntor të vitit 2023, në Gjykatën Themelore në Prishtinë u mbajt gjykimi i parë në mungesë për krime lufte. Veçanërisht, seanca fillestare në gjyqin e Çedomir Akshiqit, një luftëtar serb i kohës së luftës i akuzuar për krime të ndryshme gjatë luftës në Kosovës, u zhvillua pa praninë e të pandehurit në Kosovë. Akshiq përballet me akuza duke përfshirë vrasjen, shkaktimin e vuajtjeve, dëmtimin e pronës dhe dëbimin e civilëve në komunën e Shtimes në vitin 1999. Edhe pse Akshiq besohet të jetë në Serbi, vendndodhja e tij e saktë mbetet e panjohur. Gjykata, përmes Zyrës së BE-së në Prishtinë, kërkoi ta pyeste atë në Serbi, por nuk mori asnjë përgjigje. Sipas ligjit të Kosovës, avokati i të pandehurit ka 30 ditë kohë për të kundërshtuar provat dhe për të kërkuar hudhjen e aktakuzës. Prokuroria pretendon përfshirjen e Akshiq në dëbime, ekzekutime dhe shkatërrim të pronës, me raste të veçanta të përmendura në aktakuzë.<sup>86</sup>

**78.** Lidhur me paragrafin paraprak, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur gjashtë aktakuza në mungesë në vitin 2023, duke përfshirë rastet që kanë të bëjnë me keqtrajtimin seksual gjatë luftës. Në vitin 2019, Kuvendi i Kosovës miratoi plotësim/ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale për të lejuar gjykimet në mungesë për veprat kundër kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe penale të kryera midis janarit 1998 dhe qershorit 1999, duke synuar rritjen e ndjekjes penale të krimeve të luftës nga konflikti i viteve 1998-99. Gjykata mund të vazhdojë me gjykime në mungesë nëse janë shteruar të gjitha përpjekjet për gjetjen e të pandehurit.<sup>87</sup>

83 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023

84 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023

85 IKD (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023

86 Balkan Insight (2023), [Fillon gjykimi i parë për krimet e luftës në Kosovë në mungesë të të pandehurit](#).

87 Balkan Insight (2023), [Fillon gjykimi i parë për krimet e luftës në Kosovë në mungesë të të pandehurit](#).



**79.** Sipas vëzhgimeve të bëra nga OJQ IRS, lindin shqetësime të dukshme në lidhje me të drejtat e individëve dhe të drejtën e tyre për trajtim njerëzor nga zyrtarët e zbatimit të ligjit. Një incident që duhet theksuar ka ndodhur më 29 maj në Zveçan, ku personat e arrestuar dhe të ndaluar në lidhje me ngjarjen kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës fizike apo psikologjike. Të arrestuarit, të privuar nga përfaqësimi ndërkombëtar gjatë vuajtjeve të tyre, u përballën me keqtrajttime jo vetëm gjatë arrestimit, por edhe brenda policisë dhe njësive të paraburgimit. Ngjarja shkaktoi ankesa dhe pezullimin e një zyrtari policor përgjegjës pasi u shfaq një video virale.<sup>88</sup> Për më tepër, sipas OJQ IRS, arrestimi i Ilija Elezoviqit në shtator, i cili akuzohet për krime lufte, nxori në pah kushtet e papërshtatshme të paraburgimit, duke mos marrë parasysh rekomandimin e mjekut. Në mesin e shtatorit, gjatë arrestimit të dy personave në Graçanicë, u përdor forca e tepruar, gjë që çoi në shtrimin në spital. Incidentet në qershor, maj dhe mars që përfshijnë dhunën e policisë ndaj të miturve, gazetarëve dhe të rinjve, nënvizojnë një model shqetësues të sjelljes joprofesionale të policisë dhe lëndimit fizik.<sup>89</sup>

## 80. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës dhe MD-ja duhet të rivlerësojnë inkorporimin e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas në MD, duke adresuar shqetësimet e organizatave të shoqërisë civile;
- Ministria e Financave duhet të ketë një fond të dedikuar për viktimat e njohura nga Dhomat e Specializuara të Kosovës për të siguruar mbështetje financiare;
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj masa për të zbutur çdo pasojë negative në ndikimin e mundshëm në paanshmërinë e gjyqësorit nga ulja e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas Ligjit Nr. 08/L-196;
- Ministria e Financave duhet të rrisë buxhetin për ndihmë juridike falas për të mos rrezikuar qasjen në drejtësi për qytetarët;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta trajtojë çështjen e procedurave të gjata ligjore për t'i kuptuar dhe zbutur faktorët që kontribuojnë në vonesa, duke përfshirë keqadministrimin, performancën gjyqësore dhe menaxhimin jo-adekuat të lëndëve;
- MD-ja duhet të forcojë përpjekjet e veta për adresimin e rasteve në rritje të femicidit, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe institucionet e gjyqësorit duhet të sigurojnë ndjekje penale dhe gjykim efektiv, dhe të përfshijnë masa mbrojtëse për individët e akuzuar në ndryshimet e propozuara në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale;
- Autoritetet publike dhe politikanët duhet t'u përmbahen standardeve të GjEDNj-së për prezumimin e pafajësisë në deklaratat e tyre politike për të ruajtur besimin e publikut në sistemin e drejtësisë;
- Qeveria e Kosovës duhet të përshpejtojë përpjekjet e saj për të arritur pavarësinë e gjyqësorit përmes procesit të vetingut;

88 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

89 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

- Qeveria e Kosovës duhet të adresojë dhe të përmbahet nga ndërhyrjet e vazhdueshme në gjyqësor me qëllim të sigurimit të standardeve ndërkombëtare dhe të mbrojtje integritetin e sistemit gjyqësor;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të ndajë burime të mjaftueshme njerëzore për të mundur publikimin në kohë reale të aktgjykimeve, përmbushjen e obligimeve ligjore dhe rritjen e transparencës;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të lehtësoj publikimin e barabartë dhe në kohë të aktgjykimeve në gjuhën shqipe dhe serbe, duke pranuar rëndësinë e dygjuhësisë në sistemin juridik të Kosovës.

## 5.5 Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim dhe e drejta për privatësi

**81.** Liria e shprehjes dhe e mendimit njihet si një e drejtë themelore e njeriut me nenin 19 të DUDNj-së, i cili thotë se “secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes [...] dhe me çfarëdo mjetesh”.<sup>90</sup> Kjo e drejtë universale përfshin të drejtën për të dhënë, marrë dhe përcjellë informacione. Këto dispozita bazë përcaktohen edhe me nenin 10 të KEDNj-së, i cili për më tepër thekson se liria e shprehjes dhe e mendimit mund t’i nënshtrohet disa formaliteteve të përcaktuara me ligj për mbrojtjen e sigurisë, konfidencialitetit, paanshmërisë ose mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve.<sup>91</sup> Korniza legjislative e Kosovës mbron lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit në nenin 40 të Kushtetutës dhe një numër ligjesh të tjera. Këto përfshijnë: Ligji Nr. 04/L-046 për Radion dhe Televizionin e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligji Nr. 04 /L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Ligji Nr. 03/L-118 për Tubimet Publike, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, Ligji Nr. 02/L-65 Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, etj. Në përgjithësi, legjislacioni për lirinë e shprehjes dhe ligjet për media janë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe praktikën gjyqësore të GJEDNj-së. Duhet të theksohet se Gjykata Kushtetuese ende nuk ka dhënë ndonjë aktgjykim ku konstaton shkelje të lirisë së shprehjes të parashikuar nga neni 40 i Kushtetutës së Kosovës. Megjithatë, në Raportin e Vëndit për Kosovën për vitin 2023, Komisioni Evropian thekson se sa i përket lirisë së shprehjes “Kosova ka deri diku një nivel të përgatitjes dhe përfiton nga një mjedis pluralist dhe i gjallë mediatik. Megjithatë, ka shqetësime në lidhje me fushatat e shpifjeve publike, kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve”.<sup>92</sup> Për më tepër, vazhdon të ketë shqetësime të caktuara lidhur me lirinë e shprehjes në veri të Kosovës, duke përfshirë edhe vetë-censurën, e cila nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 40 të Kushtetutës dhe nenit 10 të KEDNj-së.<sup>93</sup>

**82.** Pacenueshmëria e së drejtës për privatësi trajtohet në mënyrë të ngjashme në DUDNj me anë të nenit 1, i cili thekson si në vijim: “Askush nuk duhet t’i nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare në privatësinë, familjen, shtëpinë ose korrespondencën e tij”.<sup>94</sup> KEDNj nga ana tjetër e përfshin në mënyrë eksplicite të drejtën e privatësisë në kornizën e saj në nenin 8 në të drejtën për respek-

90 DUDNj, [neni 19](#).

91 KEDNj, [neni 10](#).

92 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

93 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

94 DUDNj, [neni 12](#).

timin e jetës private dhe familjare.<sup>95</sup> Kushtetuta e Kosovës është veçanërisht shteruese kur bëhet fjalë për mbrojtjen e kësaj të drejte. Në të drejtën e privatësisë, siç renditet në nenin 36, mbrojtja e të dhënave personale (36.4) përfshihet krahas ruajtjes së fshehtësisë së korrespondencës (6.3) edhe paprekshmërisë së jetës private dhe familjare. Mbrojtja e të dhënave personale sigurohet ligjërisht përmes Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**83.** Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) është përgjegjëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për qasje në informata dhe të drejtën e privatësisë në Kosovë. Roli i saj kryesor është të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe të sigurojë që institucionet publike t'i respektojnë këto ligje. AIP gjithashtu ofron udhëzime dhe këshilla për individët dhe organizatat për çështje që lidhen me qasjen në informata dhe mbrojtjen e të dhënave personale, dhe ka kompetencë për të hetuar dhe vendosur sanksione në rastet e shkeljeve të këtyre ligjeve.<sup>96</sup> Në këtë drejtim, vlen të shtohet se AIP ende nuk e ka publikuar raportin e saj për vitin 2023.<sup>97</sup>

**84.** Korniza ligjore që garanton sigurinë e mjedisit mediatik është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjore.<sup>98</sup> Megjithatë, pavarësisht bazës së mirë ligjore dhe përmirësimeve ligjore në drejtim të avancimit të ndihmës juridike falas për gazetarët, kërcënimet, fushatat e urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes ndaj gazetarëve kanë qenë më të rriturat në krahasim me të kaluarën.<sup>99</sup> Ngjashëm me raportin e mëparshëm të përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut (2022), këto fushata të urrejtjes dhe bullizmit targetojnë si figura nga domeni publik ashtu edhe individë të tjerë që shprehin opinionet e tyre duke mbajtur qëndrime publike për tema të ndryshme me interes.

**85.** Gjatë vizitës së saj zyrtare në Kosovë në prill të vitit 2023, u mbajt një takim ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe Raportueses Speciale të Kombeve të Bashkuara për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e mendimit dhe shprehjes. Është e domosdoshme të theksohet se gjetjet e këtij takimi janë planifikuar t'i paraqiten Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në korrik 2024. Ky ndërveprim thekson rëndësinë e angazhimit të palëve të interesit në adresimin e shqetësimeve që lidhen me lirinë e shprehjes dhe implikimet e saj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe formulimin e politikave në nivel ndërkombëtar.

**86.** Krahasuar me vitin 2022, Kosova është ngritur me pesë vende në pozitën e 56<sup>-të</sup> në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit, siç raportojnë Reporters Without Borders. Ky shënon përmirësimin e dytë radhazi në dy vitet e fundit. Përkundër kësaj, Kosova mbetet e kategorizuar si vend problematik në indeks. Pjesërisht, kjo është për shkak se pavarësia e medias mbetet e brishtë, e kombinuar me rregullore të dobëta dhe mbështetje në shpërndarjen e fondeve publike nga partitë politike.<sup>100</sup>

95 KEDNJ, [neni 8](#).

96 AIP (2022), [Përmbledhje e aktiviteteve të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022](#).

97 AIP (2023), [Planet dhe raportet – Agjencia për Informim dhe Privatësi \(rks-gov.net\)](#)

98 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

99 Lëvizja Fol (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

100 Prishtina Insight (2023), [Kosova ngjitet renditje në indeksin botëror të lirisë së shtypit, por pavarësia e mediave është ende në rrezik](#)

**87.** Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) dhe Komisioni i Pavarur për Media (KPM) janë organet kryesore të pavarura dhe vetë-rregulluese të përfshira në sigurimin e rregullimit të mediave në Kosovë.

**88.** Dezinformimi mbetet një sfidë e rëndësishme në Kosovë, dhe karakterizohet nga mungesa e vizionit të qartë për ta luftuar këtë fenomen. Sipas një raporti të fundit të OJQ BIRN, i cili ofron një studim të thelluar mbi fenomenin dhe bën hartëzimin e dezinformimit në Kosovë, mediat dhe platformat online janë shpërndarësit kryesorë të dezinformimit, ku portalet e lajmeve shpesh luajnë një rol të rëndësishëm.<sup>101</sup> Sipas raportit, politikanët dhe mediat kontribuojnë në propagandimin e dezinformimit në lidhje me dialogun e lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke nxitur kështu tensionet ndëretnike që pengojnë integrimin në BE.

**89.** Në dhjetor të vitit 2023, Qeveria e Kosovës miratoi Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM). Kjo shënon një kalim nga vetë-rregullimi në kontrollin shtetëror të mediave online. Pikat kyçe përfshijnë licencimin shtetëror, regjistrimin e detyrueshëm të kompanive për OJQ-të që operojnë si media online, një regjistrim të mediave online të menaxhuar nga KPM-ja dhe lejet për ndryshim të pronësisë. Me gjatësi e mundshme deri në 40,000 euro dhe rritja e anëtarëve të KPM nga shtatë në njëmbëdhjetë anëtarë, iniciativa legjislative për rregullimin e mediave online përmes një sistemi licencimi konsiderohet si sulmi më i fundit ndaj lirisë dhe pluralizmit të mediave në Kosovë, duke theksuar shqetësimet se është keqinterpretuar direktiva për të harmonizuar legjislacionin kombëtar me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediatike Audiovizive. Përkundrazi, anashkalohet konteksti lokal dhe hidhet poshtë organi ekzistues vetë-rregullues në Kosovë, me direktivën e BE-së që nuk e mbështet kontrollin shtetëror përmes licencimit të detyrueshëm për mediat online.<sup>102</sup>

**90.** Nga pikëpamja ekonomike e mediave dhe funksionimit të tyre në Kosovë, qëndrueshmëria financiare varet kryesisht nga reklamat komerciale dhe donatorët financiarë, shpesh nga parti të ndryshme politike.<sup>103</sup> Sidomos në mesin e transmetuesve privatë, kjo situatë ka sjellë një paradoks ku qëndrueshmëria e organeve të medias varet nga financimi i jashtëm, mirëpo ruajtja e integritetit të medias me objektivitet dhe paanshmëri si dimensione thelbësore kërkon një pavarësi të plotë.

Në dhjetor të vitit 2023 BIRN Kosova publikoi Monitorimin e Pronësisë së Mediave (MPM) i cili do të shërbejë si një mjet për hartëzimin e bazës së të dhënave të qasshme për publikun, vazhdimisht nën përditësim, për të përfshirë të gjitha organet e mediave. Nga 44 media të monitoruara, vetëm 15 prej tyre ishin të gatshme të ndajnë të dhënat e tyre për pronësinë e medias dhe vetëm 8 prej tyre ishin në pronësi ose menaxhim të grave.<sup>104</sup>

**91.** Në vitin 2023, Qeveria e Kosovës e pezulloi certifikatën e biznesit të mediumit Klan Kosova.<sup>105</sup> Gazetarë, fotoreporterë, kameramanë dhe aktivistë u mblodhën para qeverisë, organizuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), duke deklaruar pezullimin si censurë mediatike dhe kërcënim për lirinë e fjalës. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) fillimisht kishte bërë kallëzim penal kundër Klan Kosovës, duke pretenduar se certifikata e biznesit përf-

101 BIRN (2023), [Vorbulla e rrenave](#).

102 ECPMF (2024), [Kosovë: Qeveria duhet t'i tërheqë ndryshimet tejet problematike të ligjit për median](#).

103 NDI (2022), [Integriteti i informacionit në Kosovë. Vlerësim i ekonomisë politike të dezinformimit](#).

104 BIRN (2023), [Monitorimi i Pronësisë së Medias, 2023](#).

105 Prishtina Insight (2023), [Pezullimi i certifikatës së biznesit të një mediumi ndez protesta në Kosovë](#)

shinte referenca për qytetet e Kosovës si pjesë e Serbisë. Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias i dënoi vendimin e MINT-it dhe disa media shprehën solidaritetin duke vendosur pajisjet e tyre të punës në tokë si shenjë proteste. Po ashtu, Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (RrDNj) dënoi mbylljen e Klan Kosovës, duke deklaruar publikisht se vendimi bie ndesh me vlerat dhe parimet e shoqërive demokratike. RrDNj më tej i bëri thirrje gjyqësorit që të trajtoj rastin e Klan Kosovës përmes një procesi gjyqësor të drejtë dhe të pavarur.<sup>106</sup> Presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani Sadriu, kërkoi sqarimin e dyshimeve ligjore juridike në këtë rast. Kryeministri theksoi lirinë e medias por tha se respektimi i rregullave të regjistrimit është një detyrë ligjore. Ambasadat e Francës, Gjermanisë, Italisë, Britanisë së Madhe, SHBA-së dhe BE-ja shprehën shqetësim të thellë, duke kërkuar një proces ligjor të drejtë dhe transparent. Implikimet përfshijnë shqetësimet për lirinë e medias, demokracinë dhe respektimin e procedurave ligjore.<sup>107</sup> Në gusht të vitit 2023, Gjykata Komerciale në Prishtinë vendosi kundër vendimit të MINT për pezullimin e certifikatës së biznesit të kanalit që do të çonte potencialisht në tërheqjen e licencës së transmetimit.<sup>108</sup> Megjithatë, akte presioni ndaj gazetarëve dhe aktivistëve që mbështesin Klan Kosovën vazhdojnë të ngrenë shqetësime për përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për lirinë e medias.

**92.** Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ngriti shqetësime për lirinë e medias dhe të drejtën e shprehjes së mendimit pas incidenteve të kërcënimeve fizike dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe sulmeve verbale ndaj mediave nga politikanë dhe figura të tjera publike.<sup>109</sup> Në lidhje me sulmet, kërcënimet dhe ngacmimet e përjetuara nga personeli i medias, numri i përgjithshëm i sulmeve, përfshirë sulmet fizike dhe verbale (online) është raportuar 74.<sup>110</sup> AGK-ja ka ofruar raporte të thelluara për të paktën katër raste të sjelljeve të pahijshme ndaj gazetarëve duke përfshirë pengimin e punës së Blerta Dalloshi Berishës (Klan Albania) nga ekipi i mbrojtjes së afërt të Kryeministrit. Kur ajo tenton të bëjë një pyetje, një video e publikuar tregon se si një pjesëtar i ekipit të tij të sigurisë e kap dhe e shtyn gazetaren në fjalë.<sup>111</sup> Po kështu, në gusht të vitit 2023, gazetari i Nacionale-s Vullnet Krasniqi dhe kameramani Arbër Latifi u sulmuan dhunshëm kur raportonin për protestat që shpërthyen në Prizren kundër festivalit Dokufest.<sup>112</sup> Gazetarja Rinë Haziri (Lajmi.net) është sulmuar dhunshëm nga një qytetar gjatë raportimit nga Brezovica në Shtërpcë. Sulmuesi ka dalë nga automjeti dhe i ka marrë me dhunë telefonin gazetares.<sup>113</sup> Rasti është raportuar në polici. Në dhjetor 2023, gazetari Fatlum Berisha mori kërcënime me vdekje nga llogari anonime në platformën e rrjetit social Tik Tok.<sup>114</sup> Nga ana tjetër, në maj dhe qershor 2023, gazetarja dhe kameramani i Kallxo.com, Adelina Ahmeti dhe Jetmir Hoxha, u sulmuan në Leposaviq, ku u dëmtua vetura, ndërsa Shkodrane Dakaj, Naser Fejza dhe Afrim Ejupi u sulmuan në Zveçan, ku kanë mbetur të bllokuar për një kohë dhe u është thyer vetura.<sup>115</sup> Së fundi, ndër incidentet më të rënda të dhunës në vitin 2023 ishte shënjestrimi i gazetarit Valon Syla në prill. Ai u sulmua nga tre sulmues të paidentifikuar, duke rezultuar në lëndime të rënda dhe gjakosje në fytyrë. Sulmi erdhi pas postimit të Sylës në rr-

106 RrDNj (2023), [Deklaratë: Rasti Klan Kosova](#).

107 Prishtina Insight (2023), [Pezullimi i certifikatës së biznesit të një mediumi ndez protesta në Kosovë](#)

108 Article 19 (2023), [Kosovë: Vendimi i gjykatës, një lëvizje e mirëpritur për lirinë e medias](#).

109 AGK (2022), [Hrw sjell në pah klimën e rënduar të të bërit gazetarit në Kosovë](#).

110 AGK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut.

111 AGK (2023), [Pengim në kryerjen e detyrës ndaj gazetares Blerta Dalloshi Berisha](#)

112 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, [Sulm fizik ndaj gazetarit Vullnet Krasniqi dhe kameramanit Arbër Latifi, Prizren, 11.08.2023](#)

113 Telegrafi (2023), [Gazetarja Rinë Haziri sulmohet dhe pengohet teksa po raportonte nga Brezovica](#).

114 AJK (2023), [Kërcënim me jetë ndaj gazetarit Fatlum Berisha](#).

115 BIRN (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

jetet sociale që satirizonte stilin e pasur të jetesës së një imami në Prizren. AGK-ja e dënoi me shpejtësi sulmin, duke theksuar kontradiktën e tij me lirinë e shprehjes të garantuar me Kushtetutë në Kosovë. Lidhur me këtë çështje janë duke u zhvilluar procedura ligjore.<sup>116</sup> Këto raste nënvizojnë kushtet e pasigurta që rrethojnë punën e gazetarëve në Kosovë dhe ndërhyrjen e policisë shpesh të kufizuar në disa sulme ndaj gazetarëve.

**93.** Në janar të vitit 2023, Rilind Gërvalla, aktivist i Lëvizjes Vetëvendosjes u emërua Drejtor i Televizionit në Radio Televizionin e Kosovës (RTK). Kjo ka ngjallur dyshime se partia në pushtet Vetëvendosje po e kap transmetuesin publik. Gërvalla, një mbështetës i partisë që e ka mbështetur financiarisht Vetëvendosjen në vitin 2020, është përballur me kritika për lidhjet e tij me partinë. Emërimi i Gërvallës bie ndesh me premtimet e mëparshme për depolitizimin e RTK-së. Sindikatat e medias, partitë opozitare dhe Federata Evropiane e Gazetarëve kanë shprehur shqetësime, duke pretenduar ndërhyrje politike në transmetues. Edhe partitë opozitare kanë kërkuar anulimin e emërimit të Gërvallës, duke theksuar nevojën për një televizion publik të pavarur.<sup>117</sup> Krahas kësaj, RTK-ja po përballet me akuza për diskriminim gjinor pasi tre gra, Ilire Zajmi, Flora Durmishi dhe Mihrije Bejqi nuk arritën të sigurojnë pozita të larta drejtuese edhe pse morën rezultatet më të lartat në proceset e rekrutimit, duke u siguruar pozita burrave me rezultate më të ulëta.<sup>118</sup>

**94.** OJQ IRS thekson se ndalimi i importit të produkteve serbe nga Qeveria e Kosovës më 14 qershor 2023 ka rezultuar në mungesë të mediave të shtypura nga Serbia, duke cenuar të drejtën për informim dhe lirinë e informimit.<sup>119</sup> Duhet theksuar se ndalimi i importit nuk ishte parashikuar në një vendim të publikuar apo të disponueshëm për publikun, duke ngritur shqetësime të vazhdueshme për transparencën dhe ligjshmërinë e këtij vendimi si dhe për të drejtën e informimit. Për më tepër, më 9 gusht 2023, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë ia hoqi licencën kompanisë MTS DOO për shkak të adresës së shënuar si Kosovska Mitrovica, Republika e Serbisë, në dokumentacionin e pronësisë.<sup>120</sup>

**95.** Sulmet e dhunshme ndaj gazetarëve që raportojnë nga jashtë ndërtesës komunale në Zveçan gjatë incidentëve të 26 dhe 29 majit kanë ngritur shqetësime të mëdha për sigurinë. Gazetarët e sulmuar ishin kryesisht reporterë me prejardhje shqiptare, por edhe gazetarët e komunitetit serb të Kosovës pësuan dhunë nga protestuesit. Gazetarët nga media si RTV Dukagjini, Koha, Teve1, A2 CNN, Panorama, Kanal 10, RTV 21, Periskopi, RTK dhe KoSsev, një medium në gjuhën serbe, u shënjestruan në Mitrovicën e Veriut, Zveçan dhe Leposaviq.<sup>121</sup> Nga 26 maji deri më 30 qershor, AGK-ja ka regjistruar 30 sulme ndaj gazetarëve dhe mediave në 4 komunat veriore. Sulmi më i rëndë u regjistrua më 16 qershor në Leposaviq, kur së paku 9 anëtarë të ekipeve mediatike shqiptare u ndoqën nga një turmë, ku kameramani i RTK-së Bardh Bekteshi u godit me shkelma në kokë dhe kolegja e tij Venera Xhoxhaj Adili e incizoi incidentin.<sup>122</sup>

**96.** Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve është një mjet tjetër ligjor me të cilin mund të imponohet liria e shprehjes dhe mendimit dhe e drejta për informim. Raportet e fundit kanë thek-

116 AGK (2023), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

117 Balkan Insight (2023), [Partia në pushtet e Kosovës akuzohet për 'kapjen' e transmetuesit publik.](#)

118 Kosovo 2.0 (2023), [Pabarazia gjinore në media: media duhet të sfidojë seksizmin dhe diskriminimin gjinor në radhët e veta.](#)

119 N1 (2023), [Priştina potvrdila: Oduzet poslovni sertifikat MTS d.o.o. na Kosovu.](#)

120 IRS (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

121 IRS (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

122 AGK (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

suar zbatimin e pamjaftueshëm të serbishtes me alfabet cirilik.<sup>123</sup> Janë dokumentuar shkelje të vazhdueshme të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, veçanërisht në kontekstin e serbishtes si gjuhë zyrtare në mbarë Kosovën. Veçanërisht, fushata për liberalizimin e vizave fillimisht kishte billborde informative vetëm në gjuhën shqipe, madje edhe në komunat me shumicë serbe. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2023 theksoi raste të mosrespektimit të së drejtës së përdorimit të gjuhëve në komunikimin ndërmjet institucioneve publike dhe mediave lokale, veçanërisht atyre që raportojnë në serbisht. Shembujt përfshijnë dështimin e transmetuesit publik për t'i transmetuar konferencat e shtypit të qeverisë në serbisht dhe mungesën e përkthimit të seancave plenare të Kuvendit në serbisht. Cilësia jo-adekuate e përkthimit në ueb faqet e institucioneve publike pengon qasjen e qytetarëve në informacion. Çështja shtrihet edhe në publikimin e dokumenteve, veçanërisht në gjyqësor, ku mungesa e përkthyesve apo përkthimet me cilësi të dobët pengojnë drejtpërdrejt ushtrimin e të drejtave për komunitetin serb dhe komunitetet tjera jo-shumicë që përdorin gjuhën serbe.<sup>124</sup>

**97.** Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve janë miratuar, por ende nuk janë zbatuar në nivel të kënaqshëm.<sup>125</sup>

**98.** OJQ FOL nënvizon rëndësinë e “të drejtës për t’u harruar”. Ata deklarojnë se kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me të drejtën e individëve për të mos përdorur të dhënat e tyre personale në mënyra që nuk janë në përputhje me qëllimet origjinale të mbledhjes së të dhënave.<sup>126</sup> Ky koncept luan rol kryesor në kontekstin më të gjerë të privatësisë dhe ruajtjes së informacionit personal. Normalisht, rregullimi formal i “të drejtës për t’u harruar” ndodhi më 27 prill 2016, me zbatimin që filloi më 25 maj 2018, që përkon me zbatimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) (BE) 2016/679 në mbarë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Duke e njohur rëndësinë e saj, e drejta për fshirje, apo e drejta për t’u harruar, është kodifikuar në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky legjisllacion, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2019, është në përputhje me Rregulloren 2016/679 të Parlamentit Evropian.

**99.** Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 06/L-082 ofron një kornizë solide legjisllative që ruan ekuilibrin delikat ndërmjet të drejtës për t’u harruar dhe të drejtës për lirinë e shprehjes dhe informimit. Ekspertët kanë argumentuar se kjo e drejtë është e domosdoshme për ruajtjen e privatësisë dhe integritetit të individëve. Në kuadër të aplikimit të saj në kontekstin e Kosovës, AIP-ja deri më tani ka pranuar një ankesë të vetme që daton prej vitit 2022 në lidhje me mosfshirjen e të dhënave personale. Veçanërisht, në qershor të atij viti, një qytetar i cili kishte kërkuar pozitën e zyrtarit ligjor në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, kishte parashtruar ankesë kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ankesa erdhi nga kërkimi i individit në internet që e tregoi emrin e tij ende në listën e kandidatëve të refuzuar të publikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Si përgjigje, AIP-ja ka obliguar që KGJK-ja t’i shlyejë këto lista. Duke theksuar mungesën e një baze ligjore, AIP-ja nënvizoi se publikimi i listave, veçanërisht atyre që përfshijnë kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret për procedurat e rekrutimit, nuk ka arsyetim ligjor. AIP-ja e arsyetoi vendimin e vet duke pohuar

123 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

124 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

125 YIHR KS (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

126 FOL (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të individëve, duke theksuar këtu mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.<sup>127</sup>

## 100. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj një strategji gjithëpërfshirëse për të adresuar kërcënimet, fushatat e urrejtjes dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve;
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj një qasje të koordinuar për të luftuar dezinformimin, veçanërisht në lidhje me dialogun e lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- AIP-ja duhet të pajiset me kapacitete të shtuara mbikëqyrëse, veçanërisht në lidhje me aftësinë për të vepruar si një mekanizëm i pavarur për ankesa kur organet publike refuzojnë ose shpërfillin kërkesat për çasje në dokumente publike;
- Qeveria e Kosovës duhet të ndajë burime për të siguruar zbatimin efektiv të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike;
- AIP-ja duhet të publikojë urgjentisht raportin e vet për vitin 2023 për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj masa të targetuara për të forcuar pavarësinë e mediave dhe për të reduktuar mbështetjen në partitë politike;
- Qeveria e Kosovës duhet të forcojë respektimin e procedurave ligjore në lidhje me lirinë e medias duke siguruar procese të drejta dhe transparente në raste të tilla si pezullimi i certifikatës së biznesit të Klan Kosovës;
- Qeveria e Kosovës duhet të adresojë shqetësimet në lidhje me ndërhyrjet e mundshme politike në transmetuesin publik për të siguruar që televizioni publik të mbetet i pavarur dhe të adresojë mosbalancimin gjinor brenda RTK-së;
- Qeveria e Kosovës duhet të rivlerësojë ndalimin e importit të produkteve serbe për të parandaluar shkeljen e të drejtave të qytetarëve për informim dhe lirinë e informimit;
- Qeveria e Kosovës duhet të forcojë zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve duke siguruar pajtueshmërinë me gjuhën serbe si gjuhë zyrtare në mbarë Kosovën, si dhe të adresojë rastet e mospërputhjes me politikën zyrtare në komunikimin nga institucionet publike.

## 5.6 Liria e tubimit paqësor

**101.** Liria e tubimit paqësor si një e drejtë themelore e njeriut parashihet në nivel ndërkombëtar me nenin 20 të DUDNj-së që përcakton qartë se: “secili e ka të drejtën e lirisë së tubimit dhe organizimit paqësor” (shih gjithashtu pjesën 5.7 të këtij raporti, për lirinë e asociimit). Neni 11 i KED-Nj-së në mënyrë të ngjashme e formulon lirinë e asociimit si vlerë thelbësore. Në Kushtetutën e Kosovës, një formulim sinonim është miratuar në nenin 43 si liria e tubimit dhe jo e mbledhjes.

127

FOL (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.



Kushtetuta thotë se “Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to”.<sup>128</sup> Ligjet e tjera që formojnë sfondin legjislativ të kësaj të drejte në Kosovë janë Ligji Nr. 03/L-166 për Tubimet Publike, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë dhe Kodi Penal Nr. 06/L-074. Ligji për Tubimet Publike kërkon që të plotësohen disa kushte duke përfshirë njoftimin me kohë të protestës apo tubimit publik tek autoritetet përkatëse së paku 72 orë më herët. Ky ligj ka hyrë në fuqi në vitin 2023 dhe OJQ YIHR KS ka dorëzuar komente për Projektligjin për Tubimet Publike.

**102.** Çështja e pagave të sektorit publik, e cila bëri bujë përmes protestave në vitin 2023, veçanërisht në administratën publike dhe në arenën arsimore, me kërkesat e të punësuarve të shkollave publike për rritjen e ligjshme të pagave të tyre, u zgjidh në shkurt 2023 pas miratimit të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.<sup>129</sup> Qeveria më në fund përcaktoi koeficientët e pagave për sektorin publik pas muajsh grevash nga të punësuarit e sektorit publik dhe sindikatat në vitin 2022 dhe në fillim të vitit 2023.

**103.** Ashtu si në periudhat e mëparshme raportuese (2021 dhe 2022), tema qendrore rreth së cilës u organizuan protestat dhe demonstratat ishte dhuna në baza gjinore dhe dhuna ndaj grave si çështje më urgjente. Protestat publike pasuan pas rastit të femicidit të Liridona Ademajt në dhjetor 2023, kur po mbahej edhe fushata 16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës ndaj grave. Tema qendrore e protestës ishte përmbledhur në sloganin “Nuk ka paqe pa sigurinë e grave”.<sup>130</sup> Në vitin 2023, Ministria e Drejtësisë mori përsipër udhëheqjen e Fushatës 16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës ndaj grave, duke anashkaluar kështu rolin e aktivistëve dhe organizatave të shoqërisë civile.

**104.** Një temë tjetër për të cilën janë organizuar tubime publike në formë të protestave kishte të bënte me qëndrimin e shumë shqiptarëve të Kosovës kundër krijimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Debatet në lidhje me Asociacionin vijnë pas Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013, e cila u kthye në qendër të skenës në kontekstin e dialogut Prishtinë-Beograd. Në momente të ndryshme kohore përgjatë janarit, shkurtit dhe majit të vitit 2023, segmente të ndryshme të shoqërisë, përfshirë partinë politike PSD, studentë dhe qytetarë, protestuan kundër Asociacionit.<sup>131</sup>

**105.** Sipas OJQ IRS, e drejta për të protestuar është shkelur gjatë protestave të 26 dhe 29 majit para ndërtesës komunale në Zveçan. Gjatë ngjarjes së 26 majit, njësitë speciale të Policisë së Kosovës tentuan t’i shpërndajnë me forcë protestuesit paqësorë, ndërsa më 29 maj edhe KFOR-i ka tentuar ta bëjë këtë. Është thelbësore të theksohet se të dyja protestat mbajtën një karakter paqësor dhe jo të dhunshëm derisa anëtarët e formacioneve të lartpërmendura u përpoqën t’i shtypnin përmes përdorimit të forcës, duke shkaktuar kështu përshkallëzim të mëtejshëm.<sup>132</sup>

128 Kushtetuta e Kosovës (2008), neni 43.

129 Prishtina Insight (2023), [Qeveria tregon koeficientin e pagave në sektorin publik](#).

130 Top Channel Albania (2023), [Top news: Nuk ka paqe pa sigurinë e grave, protestë në Prishtinë për vrasjen e Liridona Ademajt](#).

131 RTK (2023),

132 IRS (2024) inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

**106.** Në maj të vitit 2023, protesta u zhvilluan në veri të Kosovës si përgjigje ndaj marrjes së detyrës nga kryetarët shqiptarë të Kosovës. Kjo pasoi zgjedhjet e prillit të bojkotuara nga serbët, duke rezultuar në një pjesëmarrje historikisht të ulët të votuesve. Fatkeqësisht, protestat u përshkallëzuan në përleshje të dhunshme me ushtarët e KFOR-it, duke rezultuar në lëndime mes forcave paqeruajtëse, ligjzbatuesve dhe përfaqësuesve të mediave. Sipas raportit të Komisionit Evropian, sulmet “duhet ende të dënohen nga Serbia dhe të ndërmerren veprime prej saj”.<sup>133</sup>

## 107. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj një strategji gjithëpërfshirëse që nxit dialogun e hapur dhe angazhimin publik për çështjet e kontestueshme që rezultojnë në protesta publike;
- Policia e Kosovës duhet t’i eliminojë kufizimet e panevojshme në të drejtën e tubimit, duke garantuar që në të njëjtën kohë ruhet siguria publike;
- Sistemi i drejtësisë duhet të kryejë një hetim të plotë dhe transparent për ngjarjet e 26 dhe 29 majit në Zveçan, veçanërisht duke u fokusuar në veprimet e njëjësive speciale të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it, për të përcaktuar nëse përdorimi i forcës ishte i justifikuar;
- Trajnimi i Policisë së Kosovës duhet të forcohet për të mbështetur teknikat e mbikëqyrjes paqësore që theksojnë rëndësinë e respektimit të të drejtave të qytetarëve për tubim paqësor.

## 5.7 Liria e asociimit

**108.** Liria e asociimit është një dimension thelbësor i kornizës së të drejtave të njeriut dhe njihet krahas lirisë së tubimit në nenin 20 të DUDNj. Një dispozitë shtesë është formuluar në nenin 20.1, si e drejta e secilit për të mos qenë i detyruar të bëjë pjesë në një shoqatë.<sup>134</sup> Liria e asociimit garantohet gjithashtu nga neni 11 i KEDNj-së dhe GJEDNj-ja ka konsoliduar jurisprudencën e saj mbi shtrirjen dhe kufizimin e lirisë së asociimit. Liria e asociimit garantohet gjithashtu përmes Kushtetutës së Kosovës, dhe përfshin të drejtën për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje” (neni 44.1) dhe të drejtën për të themeluar sindikata (neni 44.2). Përveç këtyre instrumenteve ndërkombëtare dhe kushtetuese, legjislationin e plotësojnë edhe një sërë ligjesh dhe rregulloresh të tjera.

**109.** Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare më tej rregullon të drejtën kushtetuese për asociim pa marrë leje. I njohur si Ligji për OShC-të, legjislationi për OShC-të ofron një mjedis të përmirësuar ligjor duke hequr kufizimet për shtetasit e huaj dhe duke futur forma të reja ligjore me periudha të shkurtuara për regjistrim.<sup>135</sup> Megjithatë, në praktikë, raporti i Komisionerit të BE-së vë në pah se nuk është bërë asnjë përparim i prekshëm në këtë drejtim.<sup>136</sup> Për më tepër, Ligji Nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë, dhe Ligji i Punës Nr. 03/L-212, rregullon të drejtën e secilit/es për të formuar sindikata në kontekstin e sektorit publik dhe privat

133 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

134 DUDNj, [neni 20](#).

135 Qendra Evropiane për të Drejtën Jo-fitimprurëse (2019), [Kosova miraton ligj të ri progresiv për OJQ-të](#).

136 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

të punësimit. Ligji 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare vlen për të gjitha llojet e OShC-ve, duke përfshirë organizatat me bazë në komunitet. Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës miratoi Udhëzimin e ri Administrativ Nr. 12/2022 për regjistrimin, funksionimin dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare, procesi i hartimit të të cilit ka filluar në vitin 2019.<sup>137</sup> Ky Udhëzim Administrativ i përcakton gjithashtu procedurat për regjistrimin, funksionimin dhe çregjistrimin e instituteve si një formë e re e organizimit të OShC-ve e njohur nga Ligji për OShC-të i miratuar në vitin 2019. Regjistri publik i OJQ-ve duhet të përditësohet dhe duhet të sigurojë që sistemi elektronik i organizatave joqeveritare të Kosovës të jetë plotësisht i besueshëm.

**110.** Përkundër këtij konteksti legjislativ, Qeveria e Kosovës themeloi Këshillin për Bashkëpunim në mes të Qeverisë me Shoqërinë Civile në vitin 2019. Ky Këshill ka si synim kryesor të funksionojë si mekanizëm këshillues dhe të lehtësoj bashkëpunimin ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe Qeverisë. Prej vitit 2022, nuk janë ofruar përditësime të reja në lidhje me Strategjinë e Qeverisë dhe Planin e Veprimit për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2019-2023).<sup>138</sup>

**111.** Prej korrikut të vitit 2023, shqetësime të rëndësishme janë shfaqur në mesin e OShC-ve për vendimin e BE-së për të kufizuar potencialisht fondet në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) deri në pajtueshmërinë e Kosovës me direktivat e BE-së për stabilitet. Për shkak se shoqëria civile mbështetet pjesërisht në financimin ndërkombëtar, dëmet e mundshme të pezullimit të IPA-s vis-à-vis mund të kenë pasoja në fushën e shoqërisë civile në vitin 2025, sipas OJQ KCSF, dhe të rezultojnë në shkurtime të mundshme të pagave dhe reduktime të vendeve të punës. Nëse ky shqetësim do të materializohet në vitin 2025, mbetet për t'u parë.<sup>139</sup>

**112.** Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e ka mbështetur fuqishëm vendimin e Sindikatës së Re të KEK-ut për protestën e 16 marsit 2023. Protesta kishte për qëllim të kërkojë rritje të pagave për të gjithë punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës. Komunikimi i Zyrës së Kryetarit të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës ishte solidar me vendimin e Sindikatës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës, duke theksuar përpjekjen kolektive për përmirësim të pagave për të gjithë punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës.<sup>140</sup>

### 113. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës, përmes bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe Ministrisë së Drejtësisë, duhet të zhvilloj dhe zbatojë programe edukimi që ndihmojnë në ngritjen e vetëdijes tek qytetarët e Kosovës lidhur me rëndësinë dhe shtrirjen e lirisë së asociimit, siç është përshkruar përmes instrumenteve ndërkombëtare dhe Kushtetutës së Kosovës;
- Projektligji për Lirinë e Asociimit duhet të shqyrtohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për të adresuar mangësitë në themelimin dhe funksionimin e OShC-ve pa kufizime të panevojshme;

137 Zyra për Qeverisje të mirë (2022), [Projektudhëzim administrativ nr. xx/2021](#).

138 Zyra e Kryeministrit (2023), [Këshilli për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile](#).

139 Balkan Insight (2023), [OJQ-të kanë frikë se masat e BE-së kundër Kosovës mund të godasin fondet e shoqërisë civile](#).

140 Klan Kosova 2023, [BSPK-ja përkrah punëtorët e KEK-ut në protestën për rritje të pagave](#)

- Duhet të iniciohet një Strategji dhe Plan Veprimi i përditësuar i Qeverisë për bashkëpunim ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile që mbulon vitet 2024-2028;
- Qeveria e Kosovës duhet të krijojë mekanizmat e duhur të shqyrtimit për të monitoruar ndikimin e mundshëm që mund të kenë kufizimet e IPA-s në fushën e shoqërisë civile dhe për t'i zbutur rreziqet.

## 5.8 Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

**114.** Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe fesë ka të bëjë me të drejtën e individëve për të manifestuar, adhuruar dhe praktikuar besimet e tyre vetëm ose në një komunitet me të tjerët. Njohja e saj si një e drejtë universale e njeriut është e përcaktuar në nenin 18 të DUDNj-së dhe në mënyrë ekuivalente shprehet edhe në nenin 9 të KEDNj-së. Në këtë Konventë, kufizimet në manifestimet e besimit ose fesë mund të përcaktohen me ligj vetëm në rrethana kur ato cenojnë interesat dhe vlerat e një shoqërie demokratike dhe janë të domosdoshme në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit publik ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Në kuadër të Kushtetutës së Kosovës, kjo e drejtë është formuluar në kuptimin e lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe fesë në nenin 38. Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës (Të Drejtat e Komuniteteve) parasheh në nenin 59, para. 1, se: “pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë, individualisht ose në komunitet, të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre”. E drejta për të besuar dhe manifestuar fenë e dikujt shkon paralelisht në Kushtetutë me të drejtën për të ndryshuar fenë (neni 3) ose për të mos qenë i detyruar për t’u bashkuar me një komunitet fetar ose për të bërë të njohur përkatësitë fetare. Megjithatë, duhet theksuar se Kosova është shtet laik dhe është neutral në çështjet e besimeve fetare siç parashihet me nenin 8 të Kushtetutës. Kjo u vërtetua në rastin e Arjeta Halimit, për të cilin Gjykata Kushtetuese deklaroi, ndër të tjera, se autoritetet publike janë të detyruara të respektojnë nenin 8 të Kushtetutës për të ruajtur neutralitetin e shtetit për çështjet fetare.<sup>141</sup>

**115.** Edhe pse KK-ja e pati në agjendën e vet legjislativë për vitin 2023 miratimin e Projektligjit për Liritë Fetare, i cili do t’u mundësojë komuniteteve fetare regjistrimin dhe përfitimin e të drejtave të barabarta, Projektligji është ende në shqyrtim.<sup>142</sup> Ndryshimet në statusin juridik të bashkësisë fetare përfshijnë të drejtën e pronësisë së ligjshme të pronës, marrjen me qira të pronës, mbajtjen e llogarisë zyrtare bankare, punësimin e punëtorëve dhe themelimin e institucioneve me karakter humanitar dhe arsimor. Ndryshimet përfshijnë edhe formimin e një komisioni për t’u marrë me çështjet praktike dhe për të përcaktuar kriteret për regjistrimin e komuniteteve të reja fetare në Kosovë. Projektligji për liritë fetare u miratua për herë të parë në vitin 2006 dhe synon të përditësojë kornizën ligjore për liritë fetare për të rritur përputhshmërinë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Kosovës.<sup>143</sup>

**116.** Marrëdhëniet e Qeveria e Kosovës me Kishën Ortodokse Serbe mbeten të tensionuara me zbatimin e vonuar të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Manastirin e Deçanit, i cili konfirmon

141 Lënda Nr. KI 36/1. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së pretendimit të mosekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan CN.nr.24/09 e 17 nëntorit 2009 dhe shkeljet e pretenduar të të drejtave të njeriut të aplikantit.

142 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën, fq. 32.

143 AA (2023), [Qeveria e Kosovës miraton projektligjin për lirinë fetare](#).

të drejtat pronësore të kishës mbi tokën.<sup>144</sup> Ky shqetësim është theksuar edhe në dy raportet e mëparshme të OShC-ve, pa asnjë veprim të ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës deri më tani.

**117.** Kuvendi i Kosovës ka miratuar një përkufizim punues për antisemitizmin, i cili është në përputhje me Aleancën Ndërkombëtare për Përkujtim të Holokaustit. Raporti i Komisionit Evropian nënvizon se edhe pse komuniteti hebre nuk ka një sinagogë në Kosovë, një zhvillim pozitiv ka të bëjë me ndërtimin e një qendre kulturore hebraike në Prizren me mbështetjen e Qeverisë.<sup>145</sup>

**118.** Kosova ka 43 zona në mbrojtje të veçantë, të cilat janë krijuar me Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, me qëllim të ruajtjes së lokacioneve me rëndësi fetare dhe kulturore. Këtyre zonave u ofrohet mbrojtje ligjore nga çdo aktivitet që potencialisht mund të shkaktojë dëm ose shqetësim në mjedisin historik, kulturor ose natyror. Një njësi e specializuar policore, e përbërë nga individë me prejardhje të ndryshme etnike, ofron vëzhgim gjatë gjithë orarit për të garantuar sigurinë e këtyre zonave. Përderisa asnjë incident i raportuar nuk ka ndodhur në këto vende brenda dy viteve të fundit, raste të vjedhjes dhe vandalizmit janë raportuar në hapësirat e Kishës Ortodokse Serbe që ndodhen jashtë këtyre zonave të caktuara mbrojtëse.

**119.** Në fund të tetorit, si pjesë e projektit të rindërtimit në Mitrovicën e Veriut, punëtorët e ngarkuar me gërmimin e rrugës zbuluan pa dashje varrezat e vjetra të Kishës Ortodokse Serbe. Veçanërisht, parcela ku ndodhet varreza është e regjistruar zyrtarisht si pronë e Kishës Ortodokse Serbe në Kadastrën e Kosovës. Gjatë këtij operacioni ka ndodhur një krim i rëndë, i cili ka të bëjë me përdhosjen e varreve dhe monumenteve, siç pohon Veton Elshani, zëvendës komandant i Policisë së Kosovës për Rajonin e Veriut. Kryetari Erden Atiq i Mitrovicës së Veriut e pranoi incidentin si një gabim fatkeq.<sup>146</sup>

**120.** Në nëntor, me rastin e përkujtimit të Ditës së Armëpushimit të Luftës së Parë Botërore, në Prishtinë u zhvendos monumenti kushtuar ushtarëve serbë të rënë në luftërat e viteve 1912-1918, me iniciativë të Ambasadës Franceze dhe Gjermane në Kosovë. Ky monument, së bashku me gjithë varrezat, janë nën juridiksionin e Kishës Ortodokse Serbe, por as Kisha dhe as autoritetet komunale të Prishtinës nuk janë konsultuar lidhur me këtë lëvizje. Mungesa e konsultimeve ngriti shqetësimet për procesin e duhur dhe respektimin e rëndësisë fetare dhe historike të vendit.<sup>147</sup>

**121.** Në fund të tetorit, aboti i manastirit të Devina Vodës u përball me deportim nga Kosova, pavarësisht se kishte një leje qëndrimi valide, një proces që ai e kishte rinovuar vitet e mëparshme. Edhe pse jo shtetas i Kosovës, aboti u informua në Prishtinë se duhet të largohet nga vendi, duke i ndaluar kthimin e tij për pesë vitet e ardhshme, duke përmendur shqetësimet e sigurisë kombëtare. Përfaqësuesit e OSBE-së dhe EULEX-it thuhet se ishin të pranishëm gjatë këtij deportimi, duke ngritur pikëpyetje për drejtësinë procedurale. Ky veprim bie ndesh me nenin 7 para. 3 të Ligjit për Liritë Fetare në Kosovë, i cili në mënyrë eksplicite ndalon ndalimin arbitrar të hyrjes për figurat fetare.<sup>148</sup>

144 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 31-32.

145 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 31-32.

146 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

147 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

148 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**122.** Kisha Ortodokse Serbe e gjen veten të përfshirë në një debat me Nikolla Xhufkën, një prift ortodoks shqiptar. Kontesti filloi kur Xhufka, së bashku me një grup, pohoi se kisha në Rakinicë, komuna e Podujevës, ishte “Kishë Ortodokse Shqiptare” kushtuar Theofan Nolit. Duke akuzuar Kishën Ortodokse Serbe për fshehje të armëve, Xhufka e cilësoi atë një “Kishë Ortodokse Kombëtare Shqiptare”. Më pas, Dioqeza e Kishës Ortodokse Serbe Rashkë-Prizren ka paraqitur një kallëzim penal kundër Xhufkës për ndërhyrje, keqpërdorim të objekteve fetare dhe nxitje të përçarjes. Kjo përplasje nënvizon tensionet në lidhje me identitetet fetare dhe etnike, të shoqëruara nga pretendimet kontradiktore për pronësinë dhe rëndësinë e kishës. Veprimet provokuese të Xhufkës, duke përfshirë shkatërrimin e pronave dhe gjuhën e urrejtjes kundër Kishës Ortodokse Serbe, kanë rritur shqetësimet në lidhje me pohimet e tij për identitetin ortodoks shqiptar, duke pretenduar mbështetjen e Kishës Ortodokse Serbe për terroristët dhe aktivitetet jo- ligjore. Përkundër indiferencës fillestare nga institucionet e Kosovës, kisha në fund ishte kthyer nën kontrollin e Kishës Ortodokse Serbe, e shoqëruar me ndërrimin e bravës së derës. Vlen të theksohet se sipas OJQ IRS, ky incident nuk është rasti i parë i përfshirjes së Xhufkës në armiqësi dhe përdorim të gjuhës së urrejtjes kundër Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë.<sup>149</sup>

### 123. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për manastirin e Deçanit, duke konfirmuar të drejtat e pronësisë mbi tokën e Kishës Ortodokse Serbe;
- Kuvendi i Kosovës duhet t’i përmbahet plotësisht rekomandimeve të Komisionit të Veneçias me Projektligjin për Lirinë Fetare në mënyrë që të lehtësoj statusin ligjor dhe të eliminojë kufizimet në të drejtën për të manifestuar fenë;
- Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duhet të forcojnë masat e sigurisë për të mbrojtur hapësirat fetare dhe objektet e trashëgimisë historike, si dhe për të parandaluar përdhosjen e objekteve fetare;
- Policia e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duhet të zhvillojnë mekanizma efektivë të monitorimit dhe raportimit për të adresuar sa më shpejt çështjet e vjedhjes, vandalizmit dhe dëmtimit të objekteve fetare;
- Qeveria e Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet të kërkojnë respektimin e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë duke lehtësuar kështu qasjen e figurave fetare në objektet e tyre fetare;
- Liderët politikë të Kosovës duhet të iniciojnë masa për të inkurajuar dialogun ndërfaqet dhe mirëkuptimin ndërmjet bashkësive të ndryshme fetare.

## 6. PJESA B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

### 6.1 Të drejtat e punës

**124.** Të drejtat e punës e kanë bazën e tyre ligjore universale dhe ndërkombëtare në nenin 23 të DUDNj-së, kurse KEDNj-ja ndalon çdo formë të punës së detyruar me nenin 4 të saj kur thotë se: “askujt nuk duhet t’i kërkohet të kryejë punë të detyruar ose të detyrueshme”.<sup>150</sup> Në nivel lokal, të drejtat e punës mbrohen me Kushtetutën e Kosovës. Kushtetuta garanton të drejtën për të punuar dhe për të zgjedhur lirisht profesionin, siç përcaktohet në nenin 49.2 se: “Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”. Liria e asociimit, liria e formimit të sindikatave dhe ndalimi i punës së detyruar mbrohet edhe me Kushtetutë. Dispozitat e tjera përfshijnë sigurimet bazike sociale lidhur me papunësinë në nenin 51, si dhe përfaqësimin e drejtë të komuniteteve dhe anëtarëve në punësimin publik në nenin 61.<sup>151</sup> Baza legjislative është formuar edhe me Ligjin Nr. 03/L-212 për Punën, Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Ligjin Nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal, i cili rregullon dhe përcakton të drejtat dhe liritë e punëtorëve për të krijuar sindikata në sektorin publik dhe privat.

**125.** Pavarësisht se ekzistojnë disa ligje të punës, zbatimi i këtyre ligjeve mbetet i dobët në Kosovë. Mungesa e zbatimit shpie në shkelje të të drejtave të punës, përfshirë pagat e ulëta, oraret e gjata të punës dhe kushtet e pasigurta të punës. Një përqindje e konsiderueshme e fuqisë punëtore në Kosovë është e punësuar në sektorin joformal, i cili nuk është i rregulluar me ligjet e punës. Ky lloj punësimi shpesh shoqërohet me paga të ulëta, mungesë të sigurisë në punë dhe qasje të kufizuar në mbrojtje shoqërore. Një numër i konsiderueshëm i punëtorëve në Kosovë nuk mbulohehen nga skemat sociale, siç janë pensionet, sigurimi shëndetësor dhe skemat sociale për papunësinë. Kjo mungesë e mbrojtjes sociale i bën punëtorët më të ekspozuar ndaj krizave ekonomike dhe varfërisë.

**126.** Në shkurt hyri në fuqi Ligji i ri Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Qëllimi i ligjit është krijimi i një sistemi uniform të pagave që në qendër ka parime dhe rregulla transparente. Nga ana tjetër, ai mundëson të kuptuarit në mënyrë konsistente me standarde ndërkombëtare të shpenzimeve buxhetore të Qeverisë së Kosovës, duke mundësuar një menaxhim më të kontrolluar të të ardhurave dhe shpenzimeve të qeverisë. Me kërkesë të IAP-it lidhur me kushtetutshmërinë e Ligjit, Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim që anulon pjesërisht një numër të neneve, duke i cilësuar ato jokushtetuese.<sup>152</sup> Në veçanti, Gjykata ka konstatuar se reduktimet e pagave për disa kategori pune janë jokushtetuese dhe si të tilla janë të kundërligjshme.<sup>153</sup> Si pasojë, Gjykata i ka bërë thirrje Kuvendit të Kosovës që brenda gjashtë muajve ta ndryshojë ligjin ekzistues.<sup>154</sup>

150 KEDNj, [neni 4](#).

151 Kushtetuta e Kosovës (2008).

152 Telegrafi (2023), [Gjykata Kushtetuese rrëzon disa nene të Ligjit të Pagave, i kërkon Kuvendit që brenda 6 muajsh ta ndryshojë](#)

153 Për një analizë të thelluar të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ju lutemi referojuni [ueb faqes](#).

154 Telegrafi (2023), [Gjykata Kushtetuese rrëzon disa nene të Ligjit të Pagave, i kërkon Kuvendit që brenda 6 muajsh ta ndryshojë](#)

**127.** Edhe pse në programin e saj legjislativ për vitin 2023, Qeveria e Kosovës planifikoi të paraqesë një Projektligj për ndryshimin e Ligjit ekzistues Nr. 03/L-212 të Punës, Qeveria e Kosovës nuk ka qenë në gjendje të avancojë me përmirësime gjatë periudhës raportuese.<sup>155</sup> Sipas një analize të publikuar nga Kosovo 2.0, ligji aktual nuk arrin të përshtatet me kushtet aktuale socio-ekonomike të Kosovës. Megjithatë, përkundër propozimeve të OShC-ve për një rishikim më gjithëpërfshirës të Ligjit të Punës, qeveria duket e prirur drejt ndryshimeve sipërfaqësore, të cilat sipas raportit të Kosovo 2.0, e komprometojnë cilësinë e ligjit. Për më tepër, vonesa pengon të drejtat e punëtorëve, me greva të vazhdueshme dhe veprime që reflektojnë urgjencën për një ligj të ri të punës, më gjithëpërfshirës, dhe në përputhje me normat e BE-së.<sup>156</sup>

**128.** Në korrik të vitit 2023 Kuvendi i Kosovës miratoi projektligjin e ri për pagën minimale, duke e ngritur pagën minimale nga 170 në 264 euro. Megjithëse i mirëpritur nga ekspertët për adresimin e përditësimit të vonuar nga viti 2011, lindin shqetësime në lidhje me përshtatshmërinë e tij në dritën e rritjes së kostove të jetesës në kontekstin e post-pandemisë dhe inflacionit.<sup>157</sup> Veçanërisht, ligji nuk ndikon në pensionin minimal për veteranët e luftës, duke e mbajtur atë në 170 euro. Kjo ka ngjallur pakënaqësi në mesin e veteranëve dhe ka rezultuar në një sërë protestash.<sup>158</sup>

**129.** Në korrik 2023, u miratua Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të financuara nga shteti. Ligji zgjidh çështjen për ata që e lanë punën nën administratën serbe gjatë viteve të 90-ta. Krahasuar me ligjin e mëparshëm, i cili përcaktonte se vetëm ata që mund të dëshmonin 15 vjet kontribut në ish-fondin pensional të Kosovës kishin të drejtë për pension kontributdhënës, ligji i ri përfshin qytetarët që kanë lënë vendin e punës në vitet 1990 dhe për rrjedhojë nuk kanë mundur të grumbullojnë 15 vite të përvojës së punës. Plotësim/ndryshimi vjen pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2022 që e konsideroi një dispozitë të ish Ligjit të Pensioneve si jokushtetues, pasi që u mohonte shumë qytetarëve të drejtat e pensionit kontributdhënës. Sipas MFPT-së, plotësim/ndryshimi eliminon diskriminimin dhe padrejtësinë me të cilën përballen ata që u detyruan të largohen nga puna gjatë fillimit të viteve të 90-ta. Lartësia e pensionit do të përcaktohet në bazë të viteve që kontribuesit kanë kaluar në fondin pensional, duke i kushtuar shtetit rreth 60 milionë euro në vit.<sup>159</sup>

**130.** Inspektorati i Punës i Kosovës është organi qëndror monitorues që mbikëqyr zbatimin e ligjeve të punës në praktikë. Kjo përfshin menaxhimin e marrëdhënieve të përgjithshme të punës si dhe dispozitat shëndetësore në punë. E fundit është në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Veprimtaritë e inspektoratit janë gjithashtu të kontekstualizuara kundrejt një nëngrupi ligjesh dhe rregulloresh të tjera. Këtu përfshihet Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, i cili është ndryshuar në vitin 2022,<sup>160</sup> Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt, Ligji Nr. 03/L-019 për Avancimin Profesional dhe Punësimin e Individëve me Aftësi të Kufizuara dhe Ligji Nr. 02/L-81 për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri.

**131.** Shkalla e papunësisë sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për kategoritë e moshave 15-64 vjeç është 11.5 përqind në vitin 2023. Përshkrimi i paraqitur tregon një rënie të theksuar të

155 Kosovo 2.0 (2023), [Ligji i Punës është i vjetëruar](#).

156 Kosovo 2.0 (2023), [Ligji i Punës është i vjetëruar](#).

157 Prishtina insight (2023), [Projektligji i ri për pagën minimale mirëpritur nga ekspertët](#).

158 Top Channel (2023), [Veteranët protestë në Kosovë](#).

159 Zëri i Amerikës (2023), [Kosovë, miratohet projektligji që rregullon pensionet](#).

160 Gazeta zyrtare (2022), [për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit](#).



papunësisë në krahasim me të tre vitet e mëparshme. Është e mundur që rënia të mos përfaqësojë një ulje faktike të papunësisë, përkundrazi, mund të jetë rezultat i migrimit.<sup>161</sup>

**132.** Vazhdojnë shqetësimet e rëndësishme për masat e papërshtatshme të sigurisë në vendin e punës në sektorin privat, me sektorin e ndërtimit si fushën me më shumë lëndime dhe një shkallë vdekshmërie katër herë më të lartë se mesatarja rajonale.<sup>162</sup> Sindikatat kanë bërë thirrje për veprime më urgjente dhe rritje të inspektimeve për të trajtuar vazhdueshmërinë e këtij problemi. Si rezultat i sfidave ekonomike, punëtorët e ndërtimit detyrohen të rrezikojnë sigurinë e tyre.<sup>163</sup> Vetëm në vitin 2023 (të dhënat përfaqësojnë shtatë muajt e parë), janë raportuar 18 vdekje në vendin e punës.<sup>164</sup> Në raportin "Menaxhimi i punëtorëve pa procedura"<sup>165</sup>, OJQ BIRN Kosova zbulon se nga viti 2016 deri në qershor 2023, ka pasur 1,072 aksidente në vendin e punës, duke rezultuar me 102 të vdekur. Raporti gjithashtu zbuloi se 20 përqind e 23,524 punëtorëve të inspektuar nga Inspektorati i Punës në gjysmën e parë të vitit 2023, nuk kishin certifikata shëndetësore, dhe 5 përqind nuk punonin me kontrata pune. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e bizneseve dështojnë të përmbushin standardet minimale për zbatimin e të drejtave të mbrojtjes dhe sigurisë në vendin e punës.<sup>166</sup>

**133.** Eksodi i të rinjve të Kosovës drejt vendeve të Evropës Perëndimore, i nxitur nga kërkimi i mundësive të punësimit dhe një standardi më dinjitoz të jetesës, nënvizon një trend të vazhdueshëm në vitin 2023 dhe paraqet një sfidë serioze për tregun e punës në Kosovë. Shqetësimet për mungesën e fuqisë punëtore në sektorë të ndryshëm kanë rezultuar në nevojën për intervenime më të nuancuara të politikave.<sup>167</sup> Në veçanti, kreu i Odës Ekonomike të Kosovës ka kërkuar nga Qeveria që të zhvilloj një strategji të qartë që ndihmon në parandalimin e emigrimit të të rinjve nga vendi pasi që fenomeni ka vazhduar të rritet në dy vitet e fundit.<sup>168</sup>

**134.** Kombinuar me kushtet e dobëta të punës, disa ekspertë kanë shprehur shqetësimet për mundësinë e emigrimit masiv pas liberalizimit të vizave për Kosovën në janar 2024. Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit po ashtu kërkon nga Qeveria që të subvencionojnë sektorin privat për të parandaluar largimin e punëtorëve dhe vëren se janë nënshkruar kontrata me punëtorë të huaj kryesisht nga Azia dhe Turqia për të përballuar mungesën në Kosovë.<sup>169</sup>

**135.** Sektori i shëndetësisë në veçanti është i prekur nga eksodi, duke rezultuar në një largim të konsiderueshëm të trurit nga Kosova. Oda e Mjekëve në Kosovë nënvizon se vetëm në vitin 2023, 170 mjekë janë larguar nga Kosova duke iu shtuar 80-ve që janë larguar në vitin 2022. E shoqëruar me një shkallë papunësie prej 80 përqind mes mjekëve për shkak të kushteve të pakënaqshme të punës, emigrimi i punëtorëve mjekësorë në vende më të pasura paraqet një krizë serioze të

161 Gazeta Express (2023), [Emigrimi e zbret papunësinë në Kosovë në 10.8 percent, në pikën më të ulët të pasluftës.](#)

162 Nacionale (2023), [Mes punës dhe vdekjes: Sindikata ankohen për kushtet e punës në sektorin privat.](#)

163 Radio Evropa e Lirë (2023), [Kompensimi i munguar për vdekjen në vendin e punës.](#)

164 Telegrafi (2023), [18 vdekje për shtatë muaj në vendin e punës, KMDLNJ: Ndërtimtaria – sektori që po rrezikon më së shumti jetën e punëtorëve.](#)

165 Birn (2023), [Menaxhimi i punëtorëve pa procedura.](#)

166 BIRN (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

167 Enigma (2023), [Paga të ulëta e kushte minimale në pune – vazhdon trendi i madh i ikjes së rinisë Kosovare drejt vendeve evropiane.](#)

168 Zëri (2023), [Rafuni i bën thirrje Qeverisë që urgjentisht të hajtojë strategji për parandalimin e ikjes së të rinjve.](#)

169 Alb Info (2024), [Frika e mbetjes pa punëtorë në Kosovë pas liberalizimit të vizave.](#)

personelit mjekësor. Sipas Odës së Mjekëve dhe Odës së Infermierëve të Kosovës, kushtet për personelin mjekësor ende nuk janë adresuar nga Qeveria e Kosovës në një mënyrë që reflekton konsiderim serioz të krizës shëndetësore.<sup>170</sup>

**136.** Në vitin 2023, Kosova u përball me një sfidë të madhe në ofrimin e punësimit për popullatën me aftësi të kufizuara, e cila përbën mbi 150,000 individë (sipas të dhënave të OBSH-së). Përkundër kornizës legjislative që i detyron punëdhënësit të punësojnë një person me aftësi të kufizuara për çdo 50 të punësuar, ky përcaktim nuk zbatohet në praktikë pavarësisht se Ministria e Financave (MFPT) ka ndarë 5 milionë euro në vitin 2022. Pjesërisht, problemi qëndron te strategjia 2013-2023, së cilës i mungojnë specifikimet për trajtimin e aftësisimit profesional dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara.<sup>171</sup>

**137.** Peizazhi i punësimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian mbetet i rëndë në vitin 2023, pasi që ata vazhdojnë të vuajnë nga një papunësi veçanërisht e lartë (mbi 90 përqind), e cila është e ndikuar nga diskriminimi.<sup>172</sup> Si rezultat, anëtarët e këtyre komuniteteve zakonisht janë të punësuar në sektorin informal me punë të pasigurta.<sup>173</sup> Përkundër miratimit të Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali (2022-2026), diskriminimi i ndërlikon problemet e tyre dhe i shtyn anëtarët e këtyre komuniteteve në punë joformale, të pasigurta dhe me kërkesa profesionale të ulëta. Përpjekjet për të luftuar diskriminimin dhe për të ndryshuar perceptimet dhe padrejtësitë shoqërore janë thelbësore për ndryshimin e kushteve të këtyre komuniteteve.<sup>174</sup>

**138.** Sipas Bankës Botërore (BB) (2023), vetëm 20 përqind e grave marrin pjesë në fuqinë punëtore, duke reflektuar një nga normat më të ulëta në botë dhe një pabarazi të konsiderueshme ndërmjet kornizës legjislative të Kosovës dhe realitetit ekonomik në terren. BB-ja thekson se normat tradicionale që ua caktojnë grave përgjegjësitë e kujdesit, vazhdojnë si në fushën e kujdesit për fëmijët ashtu edhe në atë të kujdesit për të moshuarit.<sup>175</sup> OJQ QKSGj nënvizon në këtë drejtim mungesën e dispozitave të detyrueshme për pushimin e lehonisë dhe atë prindëror, duke përfshirë kohëzgjatjen dhe kompensimin adekuat dhe sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës për gratë. Ky shihet si një faktor kontribues që gratë të privohen nga qasja e barabartë në tregun e punës.<sup>176</sup> Rritja e pritshme e kostove të kujdesit për fëmijët në vitin e ardhshëm (2024) ka gjasa të kontribuoj në marginalizimin e mëtejshëm të grave, duke i detyruar ato ta lënë punën e tyre për t'u kujdesur për fëmijët.

**139.** Sipas Institutit GAP, pabarazitë gjinore në peizazhin e punës mbeten të përhapura, me vetëm biznese mikro dhe të vogla në pronësi të grave. Në raportet e tyre të fundit, Instituti GAP thekson se gratë pronare mungojnë tek ndërmarrjet e mëdha me më shumë se 250 punëtorë. Për më tepër, peizazhi komunal pasqyron pabarazitë ndërmjet rajoneve të ndryshme: Dragashi, Malisheva dhe Rahoveci shfaqin shkallën më të lartë të pabarazisë në pronësinë e bizneseve në Kosovë. Për dallim, Parteshi qëndron si komuna më e barabartë në pikëpamjen gjinore.<sup>177</sup>

170 Kosova news (2024), [mbi 300 mjekë të larguar, a do të ndikoj liberalizimi i vizave në krizë të stafit mjekësor](#).

171 Kallxo (2023), [Mundësitë e punësimit të personave me aftësi të kufizuara](#)

172 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

173 Balkan Sunflowers Kosova (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

174 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

175 Banka Botërore (2023), [Nevojiten më shumë reforma për të kontribuar drejt ekonomisë dhe prosperitetit të vendit](#).

176 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

177 GAP (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**140.** Lidhur me paragrafin e mëparshëm, Instituti GAP nënvizon vazhdimësinë e stereotipeve gjinore përmes gjuhës së përdorur në njoftimet për vendet e lira të punës në tregun e punës. Në veçanti, ata zbulojnë se 59 përqind e vendeve të lira të punës të postuara në portalet e njohura Kosovajob dhe 79 përqind në Superpuna, shfaqin raste tipike të stereotipeve gjinore me stereotipet gjinore për burrat në ekonomi, tregti, inxhinieri dhe ndërtim dhe me përdorim të gjuhës së fokusuar te gratë në arsim dhe administrim. Vlen të theksohet se vendet e punës me stereotipe gjinore të burrave ofrojnë paga më të larta se punët që mbështeten në rolet stereotipe të grave. Ata theksojnë rëndësinë e lehtësimit të gjuhës neutrale ndaj gjinisë në përshkrimet e vendeve të punës me praktika shpërblimi të barabartë.<sup>178</sup>

### 141. Rekomandime

- Kuvendi i Kosovës duhet të sigurohet që projektligji i Punës të miratohet në përputhje me Acquis-in përkatës të BE-së (balanci punë-jetë), veçanërisht në lidhje me mosdiskriminimin në punësim dhe pushimin prindëror, si dhe të ndaj burime për të financuar këto leje dhe për të investuar në zgjerimin e shërbimeve të kujdesit;
- Inspektorati i Punës duhet të rris kapacitetet dhe inspektimet si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat;
- Kuvendi i Kosovës duhet të miratoj urgjentisht Ligjin e ri për Punën;
- Qeveria e Kosovës dhe Agjencia për Barazi Gjinore duhet të zbatoj masa afirmative sipas Ligjit për Barazi Gjinore në proceset e rekrutimit, veçanërisht në pozitat më të larta vendimmarrëse në Administratën Publike;
- Inspektorati i Punës duhet të zhvilloj trajnime për punëdhënësit e sektorit publik dhe privat lidhur me kornizën legjislative;
- Qeveria e Kosovës duhet të zbatoj politikat e parapara në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2026 me qëllim të rritjes së punësimin të këtyre komuniteteve;
- Inspektorati i Punës duhet të mbroj ligjet në fuqi dhe të drejtat e punëtorëve, duke respektuar të gjitha të drejtat e parapara me ligj;
- Qeveria e Kosovës duhet të bëjë promovimin adekuat të të drejtave të punës për punëdhënësit në mënyrë që të respektohen të drejtat themelore të njeriut, duke përfshirë të drejtën për lirinë e shprehjes, organizime dhe tubim paqësor.

## 6.2 E drejta për arsim

**142.** Sfondi ndërkombëtar në të cilin e drejta për arsim kuptohet më së miri në kontekstin e zhvillimit të Kosovës si shoqëri demokratike është neni 26 i DUDNj dhe neni 2 i KEDNj. Konkretisht, paragrafi 26.1 i DUDNj-së thekson se “secili ka të drejtën e arsimit” dhe vë në pah se arsimi duhet të jetë falas dhe të jetë i qasshëm për të gjithë të paktën në nivelin fillor dhe të mesëm.

**143.** Në kornizën legjislative të Kosovës, e drejta për arsim është e mbrojtur me Kushtetutë. Neni 47 siguron të drejtën për arsim fillor falas dhe mundësi të barabarta për arsim për të gjithë individët në përputhje me nevojat dhe aftësitë e tyre specifike. Në nenin 59 të të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, Kushtetuta garanton të drejtën e grupeve jo-shumicë për të vijuar arsimin në gjuhën e tyre amtare, me kusht që gjuha të jetë zyrtarisht në përdorim në Kosovë. Kjo është përsëritur në Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Ligji mbron gjuhën e folur nga grupet jo-shumicë si gjuhë e mësimin në arsimin fillor dhe të mesëm. Korniza legjislative e mjedisit arsimor të Kosovës është kompletuar me Ligjin Nr. 03/L-068 për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës. Ky ligj rregullon organizimin e institucioneve publike në shkollat fillore dhe të mesme. Konteksti parësor legjislativ për arsimin në nivelin terciar është Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë. Në dhjetor 2022, Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe Projektligjin për Arsimin e Lartë.

**144.** Në vitin 2023, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës shënoi një moment historik të rëndësishëm duke lansuar programin inaugurues Master në të Drejtat e Njeriut, të Drejtën Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësinë Tranzicionale. Veçanërisht, kjo nismë progresive ka marrë mbështetje nga UNMIK/OHCHR përmes OJQ-së Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS). UNMIK-u, përmes YIHR KS, po e mbështet në mënyrë aktive programin pasi që dallohet si i pari i këtij lloji në Kosovë, duke mirëpritur studentëve ndërkombëtarë në studim të rregullt dhe me themelimin e klinikës ligjore. Një Memorandum thelbësor Mirëkuptimi (MM) është nënshkruar me Fakultetin Juridik për të përmirësuar koordinimin dhe zbatimin praktik të kësaj përpjekje të rëndësishme arsimore.<sup>179</sup>

**145.** Në korrik 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Veçanërisht, ligji rregullon sigurimin e standardeve cilësore të arsimit dhe e bën edukimin parashkollor të detyrueshëm nga viti 2024. Sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ligji “vendos themelet për rritjen dhe zhvillimin e më të rinjve”. Deri më tani, UNICEF-i në Kosovë raporton se qasja në edukimin parashkollor në Kosovë është shumë më e ulët se standardi evropian prej 96 përqind, dhe më e ulët se mesatarja e rajonit. Në të vërtetë, vetëm 38 përqind e fëmijëve të Kosovës 3 deri 5 vjeç kanë qasje në ndonjë lloj strukture të mësim-nxënies. Rrjedhimisht, MASHTI nënvizon se Ligji do të kontribuoj si konceptualisht ashtu edhe substancialisht në edukimin në fëmijëri të hershme.<sup>180</sup> Mbetet për t’u vlerësuar se si rritja e shpenzimeve për kujdesin për fëmijë, e theksuar në seksionin e mëparshme, mund të implikoj zbatimin faktik të ligjit.

179 YIHR (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

180 AA (2023), [Kosovë, prezantohet Ligji për edukimin në fëmijërinë e hershme.](#)

**146.** Rishikimi i teksteve shkollore ka nisur në prill 2023 me qëllim përafrimin e cilësisë së teksteve me standardet ndërkombëtare dhe kriteret e testimit. Procesi i rishikimit të teksteve zhvillohet në disa faza dhe fillimisht fokusohet në gjuhën dhe matematikën si dy fushat më vendimtare për përmirësimin e teksteve shkollore dhe arsimin cilësor.<sup>181</sup> Në një fazë të mëvonshme, numri i teksteve shkollore do të reduktohet; ky proces do të kryhet nga një ekip me ekspert lokal dhe ndërkombëtar, sipas MASHTI-t.<sup>182</sup>

**147.** Në lidhje me rishikimin e teksteve shkollore, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) publikoi një raport ex-officio për gjuhën e urrejtjes brenda teksteve shkollore në gusht të vitit 2023, duke mbuluar materialet nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Raporti thekson gjendjen përgjithësisht të respektueshme në tekste shkollore, me raste minimale të gjuhës së urrejtjes në tema të ndryshme. Sipas IAP, në mesin e 47 teksteve të shqyrtuara, në disa raste është gjetur përmbajtje që pasqyron gjuhën e urrejtjes. IAP rekomandoi lehtësimin e programeve të trajnimit për autorët e teksteve shkollore dhe edukatorët për lirinë e shprehjes dhe luftën kundër gjuhës së urrejtjes gjatë zhvillimit të materialit të mësimnxënies dhe fazave vijuese të mësimdhënies, me qëllim të rritjes së përkushtimit institucional dhe shoqëror të Kosovës për nxitjen e kulturës së tolerancës dhe barazisë në arsim.<sup>183</sup>

**148.** Krahasuar me raportin e IAP, OJQ VoRAE shpreh shqetësime në lidhje me diskriminimin e ngulitur ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në tekstet shkollore. Ata deklarojnë se tekstet shkollore ekzistuese shfaqin mungesë të përfshirjes dhe pranimit që injoron praninë historike dhe vlerat kulturore të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Tekstet e njëanshme shkollore formësojnë perceptimet ndaj "tjetrit" dhe sigurojnë vazhdimësinë e intolerancës etnike.<sup>184</sup>

**149.** Në prill 2023, u lansua Programi Kombëtar i Shkencës (2023-2028). Ky dokument strategjik ofron një vizion për zhvillimin e hulumtimit shkencor dhe inovacionit në Kosovë duke përshkruar ndarjet buxhetore për periudhën 2023-2028. Strategjia përputhet me Draft Strategjinë Zhvillimore Kombëtare 2030, Agjendën e Integritimit Evropian të Kosovës, dhe është në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, neni 38 për Programin Kombëtar të Shkencës.<sup>185</sup>

**150.** Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) bëri publike planet e buxhetore vjetore për vitin 2024 për sektorin e arsimit, të cilat do të shënojnë një rritje të njëpasnjëshme prej vitit 2023.<sup>186</sup> Sipas raportit të Komisionit Evropian, teksa përqindja për arsimin është e krahasueshme me vendet e BE-së, shpenzimet për kokë-banori mbeten dukshëm më të ulëta. Prandaj, Qeverisë së Kosovës i kërkohet të rishikojë formulën e saj të financimit me më shumë saktësi mbi bazën për kokë-banori.<sup>187</sup>

181 Tëvë (2023), [Fillon rishikimi i teksteve shkollore](#).

182 Kallxo (2023), [Ministrja Nagavci prezantoi punën në arsim gjatë vitit 2023](#).

183 OIK (2023), [Avokati i Popullit publikoi raportin në lidhje me gjuhën e urrejtjes në tekstet shkollore](#).

184 VORAE (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

185 Republika e Kosovës, Zyra për Qeverisje të Mirë (2024), [Programi Kombëtar i Shkencës 2023-2028](#).

186 Kallxo (2023), [Ministrja Nagavci prezantoi punën në arsim gjatë vitit 2023](#).

187 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

**151.** Pjesëmarrja e Kosovës në programin Erasmus+ 2021-2027 është e dukshme, sepse lehtëson mobilitetin e studentëve dhe stafit brenda shteteve anëtare të BE-së dhe lehtëson shkëmbimin e praktikave të mira në shkencë dhe teknologji. Në vitin 2023, 37 institucione të Kosovës përfituan nga skemat Erasmus+ si në arsimin e lartë ashtu edhe në atë profesional.<sup>188</sup>

**152.** Sipas raportit të Komisionit Evropian, vlen të përmendet angazhimi i Kosovës në Studimi Ndërkombëtar i Kompjuterit dhe Literaturës së Informacionit (ICILS) 2023, duke ofruar një mekanizëm për të vlerësuar kompetencat digjitale të studentëve dhe për të ndjekur progresin drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së. Gjithashtu, raporti njihë pjesëmarrjen aktive të Kosovës në grupet punuese të Zonës Evropiane të Arsimit për periudhën 2021-2025. Këto grupe shërbejnë për të rritur bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve candidate, duke nxitur zhvillimin e një sistemi arsimor dhe trajnimit kombëtar më të fuqishëm dhe gjithëpërfshirës. Objektivi i përbashkët është përgatitja e të rinjve për sfidat e paraqitura nga tranzicioni i gjelbër dhe digjital, siç theksohet në analizën gjithëpërfshirëse të Komisionit Evropian për sektorin e arsimit në Kosovë.<sup>189</sup>

**153.** Edhe pse mbi gjysma e nxënësve të shkollave të mesme të larta të Kosovës janë të regjistruar në arsimin dhe aftësimin profesional (AAP), sfidat vazhdojnë në këtë sektor pasi që shkollat e AAP-së shpesh nuk janë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe shpesh mungon cilësia e ofrimit.<sup>190</sup> Përkundër regjistrimit të nxënësve, financimi i përgjithshëm i arsimit në vitin 2023 përbëhej prej vetëm 9.6 përqind për arsimin profesional. Sipas MASHTI-t, alokimet buxhetore për vitin 2024 do të rriten ndjeshëm për shkollat e AAP-së me fokus në zbatimin e arsimit dual për shkollat e AAP-së. Kjo përfshin orë praktike për nxënësit përmes vendosjes në biznese të ndryshme.<sup>191</sup>

**154.** Fëmijët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Kosovës vazhdojnë të përballen me sfida të rënda sa i përket qasjes së barabart në arsim. Stigmatizimi i kulturës së tyre i ndjekur nga forma të vazhdueshme të diskriminimit kundër tyre pengon përpjekjet aktive të qeverisë për të arritur në një kontekst në të cilin të gjithë fëmijët mund të zhvillohen në një mjedis arsimor të barabart. Në aspektin numerik, përderisa është bërë deri diku progres në përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë, niveli i pjesëmarrjes së tyre mbetet nën mesataren në krahasim me popullsinë e përgjithshme. Vetëm 7.6 përqind e fëmijëve të moshës parashkollore ndjekin forma të edukimit parashkollor. Në arsimin e mesëm, shifrat janë veçanërisht të dukshme në krahasim me popullsinë e përgjithshme. Vetëm 31 përqind e komuniteteve jo-shumicë të moshës shkollore marrin arsim formal kundrejt 86.8 përqind të popullsisë së përgjithshme.<sup>192</sup>

**155.** Ekziston një nevojë kritike për të përmirësuar qasjen në arsim të nxënësve me aftësi të kufizuara.<sup>193</sup> Deri më tani, gjithsej 38,000 nxënës me aftësi të kufizuara janë të privuar nga çdo qasje në arsimin formal. Në vitin 2023, nga MASHTI u publikua Udhëzimi i ri Administrativ Nr. 19/2023 për Rolin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Asistentit për Fëmijë/nxënës me Nevoja të Veçanta Arsimore.<sup>194</sup> Ky Udhëzim Administrativ ka si qëllim kryesor rregullimin e ofrimit të mbështetjes adekuate dhe kompetencave profesionale për fëmijët me nevoja të veçanta.

188 Klan Kosova (2023), [Gjendja në arsim - Dobët në PISA, suksesshëm në Erasmus](#)

189 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

190 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

191 Kallxo (2023), [Mësimi dual: si do të funksionojë në Kosovë?](#)

192 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI 2022), [Draft Strategjia e Arsimit 2022-2027](#).

193 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

194 MASHTI (2023), [Udhëzim administrative, Nr. 19/2023 mbi detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit për nxënës me nevoja të veçanta arsimore](#).

**156.** Në shkurt të vitit 2023, sulmi fizik kundër një fëmije pesë vjeçar me nevoja të veçanta nga asistentja e tij në një çerdhe private në Mitrovicën Jugore, shkaktoi zemërim publik përmes platformave të rrjeteve sociale dhe theksoi nevojën institucionale për t'u dhënë përparësi sigurisë së fëmijëve gjatë procedurave të punësimit të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta. Vendosja e mekanizmave të fuqishëm që ndihmojnë në parandalimin, identifikimin dhe reagimin ndaj rasteve të keqtrajtimit në institucionet arsimore, mund të lehtësoj një mjedis të sigurt për mësimxënie për fëmijët me nevoja të veçanta.<sup>195</sup>

**157.** Fëmijët e komunitetit serb ndjekin mësimin në përputhje me kurrikulat e Serbisë, ndërsa shumica e shqiptarëve ndjekin kurrikulën e MASHTI-t. Teksa fokusi i shumë hulumtimeve ka qenë në ndarjen institucionale ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb, alarmet e sigurisë në veri të Kosovës në maj të vitit 2023 kanë pasur pasoja negative për vitin e rregullt shkollor për serbët e veriut të Kosovës. OJQ IRS thekson se duke pasur parasysh praninë e shtuar të njësive speciale të Policisë së Kosovës pas incidentit të 26 majit, institucionet paralele arsimore serbe në veri të Kosovës morën vendim që vitin shkollor ta mbyllin më herët. Çka pati ndikim vendimtar në marrjen e një vendimi të tillë ishte prania e njësive speciale në dhe rreth ndërtesës komunale në Zveçan, në afërsi të së cilës ndodhen shkollat fillore dhe të mesme në këtë qytet.

**158.** Situata e segregacionit etnik në shkolla i përkeqëson ndarjet etnike dhe pengon zhvillimin e një shoqërie të mirëfilltë multietnike dhe multikulturore. Segregacioni i komuniteteve Rom dhe Ashkali mbetet i rëndësishëm në vitin 2023 duke përfshirë në kurrikulën e sponsorizuar nga Qeveria e Serbisë në Mitrovicë të Veriut. Shkollat mbesin të ndara sipas vijave etnike, shkalla e braktisjes së shkollës është më e lartë për këto komunitete sesa për nxënësit me prejardhje të tjera etnike, dhe ndjenja e përgjithshme e diskriminimit mbetet një tipar i përhapur i peizazhit arsimor të Kosovës.<sup>196</sup>

**159.** Në vitin 2023, rastet alarmante të diskriminimit ndaj fëmijëve Rom dhe Ashkali në Kosovë hedhin dritë mbi barrierat e vazhdueshme që pengojnë qasjen e tyre në arsim, si dhe sfidat sistematike dhe praktikak diskriminuese që pengojnë mundësitë e tyre arsimore. Sipas një raporti të fundit të Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM), në Fushë Kosovë, 25 fëmijë u përballën me diskriminim kolektiv kur iu mohua mundësia për arsim alternativ në shkollën "Selman Riza", një shkelje e raportuar nga OJQ Terres des Hommes Kosova (TDHK) dhe e adresuar në vitin 2023. Refuzimi i shkollës për të vazhduar arsimin alternativ çoi në raportimin tek Inspektorati i Arsimit dhe IAP-ja. Një tjetër incident në Prizren zbuloi ndarjet e klasave në baza etnike në vitin 2023, duke nxitur ndërhyrjen e menjëhershme të Drejtorisë Komunale për të parandaluar segregacionin e mëtejshëm dhe praktikak diskriminuese. Po ashtu, raporti i ZQM-së ilustron një rast tjetër në Fushë Kosovë, ku një nxënës i klasës së 6-të iu mohua padrejtësisht shkollimi sepse u pretendua se po përsëriste vitin shkollor.<sup>197</sup>

195 Bota Press (2023), "[S'po muj ia fali vetes.../ Edukatorja që rrahu 5-vjeçarin me nevoja të veçanta i kërkon falje prindërve](#)

196 Radio Kosova e Lirë (2023), [Edukimi, armë kundër diskriminimit.](#)

197 ZQM (2023), [Raport mbi zbatimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi bazuar në rastet e raportuara në platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.](#)

## 160. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të përshpejtoj zbatimin e projektligjit për Arsimin e Lartë dhe Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, duke ofruar një kornizë ligjore për sigurimin e cilësisë, financimin e bazuar në performancën dhe themelimin e Komisionit të Etikës;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) duhet të zhvilloj masa në lidhje me rritjen e shpenzimeve për kujdesin për fëmijë për të siguruar qasje universale në edukim parashkollor cilësor në vitin 2024;
- Qeveria e Kosovës duhet të forcojë zbatimin e Udhëzimit Administrativ për rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit/es për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore;
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj strategji për të trajtuar segregacionin etnik, veçanërisht në mesin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në mënyrë që të promovoj arsimin e vërtetë multietnik dhe multikulturor;
- Qeveria e Kosovës duhet të iniciojë masa më serioze për parandalimin e diskriminimit ndaj romëve dhe ashkalive, duke ndihmuar në uljen e shkallës së braktisjes së shkollës në mesin e këtyre komuniteteve dhe për të nxitur një mjedis të sigurt për rritjen e tyre arsimore;
- MASHTI duhet të fokusohet në përditësimin e teksteve shkollore përmes një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin dimensionet kulturore dhe historike të komuniteteve jo-shumicë;
- MASHTI duhet të krijojë programe të specializuara trajnimi për edukatorët për zhvillimin e ligjëratave për përfshirjen sociale dhe diversitetin kulturor, duke vënë theksin në të menduarit kritik;
- Qeveria e Kosovës duhet të rivlerësojë formulën e financimit për të alokuar financim më të sakt për kokë banori për arsimin profesional, me fokus në zbatimin e modeleve të arsimit dual përmes rritjes së alokimeve buxhetore.

## 6.3 E drejta për kujdes shëndetësor

**161.** Baza ndërkombëtare e të drejtave të njeriut mbi të cilën mund ta vlerësojmë të drejtën për kujdes shëndetësor në kontekstin e Kosovës është DUDNj. Në nenin 5 të DUDNj-së fokusi i drejtohet të drejtës së të gjithë individëve për “një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe të familjes, duke përfshirë ushqimin, veshjen, banimin [...]”<sup>198</sup> Edhe pse GjEDNj-ja nuk e thekson në mënyrë eksplicite të drejtën për kujdes shëndetësor, GjEDNj-ja është marrë me çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin dhe shëndeti është specifikuar si nocion themelor në lidhje me “moralin” në dispozita të tjera të ndryshme.

**162.** Korniza legjislative e Kosovës për të drejtën për kujdes shëndetësor përfshin ligje dhe dispozita të shumta. Një pasqyrë e përgjithshme është renditur me nenin 51 të Kushtetutës së Kosovës për Mbrojtjen Shëndetësore dhe Sociale. Konkretisht, paragrafi 1 formulon se kujdesi shëndetësor dhe sigurimet shoqërore rregullohen me ligj, ndjekur në paragrafin 2 nga sigurimet sociale themelore që

198

DUDNj, [neni 5](#).



kanë të bëjnë me papunësinë, sëmundjen, paaftësinë dhe pleqërinë, siç rregullohet edhe me ligj. Në maj të vitit 2022 është miratuar Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor.<sup>199</sup> Ky ligj përbën një hap të rëndësishëm në nivel të Qeverisë së Kosovës drejt rregullimit të sigurimit shëndetësor publik për qytetarët e Kosovës. Korniza legjislative plotësohet më tej me ligjet e mëposhtme: Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, Ligji Nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues, Ligji Nr. 06/L-042 për Gjakun dhe Përbërës të Gjakut dhe Ligji Nr. 02/L-200 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

**163.** Realiteti i sistemit të shëndetësisë të Kosovës është në kontrast të thellë me themelet legjislative të vendit. Progresi drejt përmirësimit të shëndetësisë kërkon një ristrukturim të konsiderueshëm të sistemit, të cilin Qeveria e Kosovës ende nuk e ka bërë me anë të një skeme funksionale të shëndetësisë. Pjesërisht si pasojë e kushteve të këqija infrastrukturore për mjekët dhe punëtorët e shëndetësisë dhe pagave të ulëta në përgjithësi në sektorin publik, migrimi drejt vendeve më të pasura është bërë i zakonshëm. Kjo është problematike pasi rezulton në një ikje të konsiderueshme të trurit në të gjithë vendin. Në vitin 2022, Oda e Mjekëve të Kosovës raportoi se 674 mjekë janë larguar nga Kosova prej vitit 2018. Vetëm në vitin 2022, 210 mjekë që punonin në institucionet publike në Kosovë kanë emigruar në vendet e Evropës Perëndimore.<sup>200</sup> I njëjti trend vazhdon edhe në vitin 2023 me 170 mjekë dhe punëtorë shëndetësorë që kanë emigruar.<sup>201</sup> Deri më tani, Qeveria e Kosovës nuk ka marrë masa thelbësore për të kundërvepruar ndaj emigrimit të profesionistëve të shëndetësisë në vendet e Evropës Perëndimore. Ky eksod ka pasojë të rënda për sektorin e shëndetësisë në Kosovë, duke çuar në mungesë të personelit të kualifikuar mjekësor dhe duke ndikuar në cilësinë e përgjithshme të shërbimeve shëndetësore.<sup>202</sup>

**164.** Duke nënvizuar cilësinë e përgjithshme nën standarde të sektorit të shëndetësisë, shpenzimet për shëndetësi në Kosovë shënojnë shkallën e dytë më të ulët në rajon dhe me vetëm 3 përqind të BPV-së totale janë tri herë më të ulëta se mesatarja e BE-së prej përafërsisht 11 përqind. Përkundër kësaj, viti 2023 vendosi një rekord për buxhetin e sektorit të shëndetësisë i cili arriti në 300 milionë euro dhe për këtë arsye reflektoi një rritje prej afërsisht 15.6 përqind krahasuar me vitin e kaluar, sipas raportit të Komisionit Evropian 2023.<sup>203</sup>

**165.** Përkundër ndarjes së përgjithshme buxhetore, raporti i Komisionit Evropian nënvizon se Qeveria e Kosovës nuk tregon stimuj të qartë për të rritur produktivitetin, efikasitetin dhe cilësinë e përgjithshme në sektorin e shëndetësisë.<sup>204</sup>

**166.** Ekziston gjithashtu një skepticizëm i përhapur ndaj sistemit të shëndetësisë publike, i cili lind nga favoritizmi, duke lënë kështu një pjesë të konsiderueshme të popullsisë pa qasje në kujdesin shëndetësor cilësor për shkak të mungesës së lidhjeve. Rrjedhimisht, shumë individ përdorin fondet personale për shërbimet e kujdesit shëndetësor në sektorin privat.<sup>205</sup>

199 Gazeta Zyrtare (2022), [Ligji Nr. 08/L-42 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-084 për Sigurimin Shëndetësor](#).

200 Kosova news (2024), [mbi 300 mjekë të larguar, a do të ndikoj liberalizimi i vizave në krizë të stafit mjekësor](#).

201 Kosova news (2024), [mbi 300 mjekë të larguar, a do të ndikoj liberalizimi i vizave në krizë të stafit mjekësor](#).

202 Kosova news (2024), [mbi 300 mjekë të larguar, a do të ndikoj liberalizimi i vizave në krizë të stafit mjekësor](#).

203 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën.

204 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën.

205 QIPS (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**167.** Ofrimi i sigurimeve shëndetësore publike për banorët e Kosovës mbetet i pakapshëm dhe periudha e pritjes mund të zgjatet deri në pesë vjet, sipas Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK).<sup>206</sup> PRAK thekson se situata shkel të drejtat e pacientëve ku 84 përqind e pacientëve në Kosovë përballen me vështirësi financiare kur kërkojnë qasje në shëndetësi. Veçanërisht grupet e cënueshme në varfëri, nga zonat rurale dhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, janë të prekur në mënyrë disproporcionale nga mungesat e sistemit të shëndetësisë.<sup>207</sup> Raporti i fundit i Komisionit Evropian thekson se një e treta e popullsisë përballlet me kufizime të rënda.<sup>208</sup>

**168.** Edhe pse shumë kompani private në Kosovë ofrojnë sigurime shëndetësore, mungesat në sistemin e shëndetësisë të mbështetur nga qeveria kanë rezultuar në mungesë të të dhënave faktike në lidhje me mbulimin e kujdesit shëndetësor privat për banorët e Kosovës. Mungesa e mekanizmave të qartë mbikëqyrës pengon aftësinë e qeverisë për të monitoruar dhe vlerësuar statuset individuale të sigurimeve. Mundësia e përparimit të afërt në këtë drejtim turbullohet nga vonesa e vazhdueshme e Qeverisë së Kosovës në hartimin e një ligji të ri për Sigurimet Shëndetësore.<sup>209</sup>

**169.** Përveç mungesës së një sistemi institucional për sigurime shëndetësore, mungesa e një Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH) e pengon më tej progresin. Operacionalizimi i SISH-it mund të lehtësoj gjenerimin e të dhënave të shëndetësisë dhe përpilimin, analizën dhe komunikimin ndërmjet sektorit privat dhe atij publik të shëndetësisë. Në pasqyrën e buxhetit të vitit 2024 më 16 nëntor 2023, MSH-ja njoftoi lansimin e SISH-it në vitin 2024 me një buxhet të ndarë prej 7 milionë eurosh.

**170.** Sistemi Informativ i shëndetësisë publike, edhe pse pjesërisht i përafuar me Treguesit Bazë Evropianë, është vetëm pjesërisht funksional.<sup>210</sup> Kosova ka bërë përparim në trajtimin e sëmundjeve ngjitëse, miratimin e ligjeve në përputhje me rekomandimet e BE-së, por sfidë mbetet përfundimi me rregulloret e BE-së në fushën e gjakut, indeve, qelizave dhe organeve, sipas raportit më të fundit të Komisionit Evropian.

**171.** Për sa i përket shëndetit mendor, aktualisht nuk ka një politikë apo strategji kombëtare në fushën institucionale që artikulon një vizion të qartë për kujdesin ndaj shëndetit mendor. I vetmi dokument përkatës në dispozicion është Ligji Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, i cili përcakton në terma të përgjithshëm përkufizimet që kanë të bëjnë me shëndetin mendor në Kosovë. Buxheti i ndarë për shëndetin mendor ka mbetur në stagnim gjatë shumë viteve, me rreth 300,000 euro të caktuara për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për shërbimet e shëndetit mendor. Për shkak se shpenzimet për shëndetin mendor variojnë rreth 1 përqind deri në 2 përqind të shpenzimeve vjetore, shëndeti mendor renditet i ulët në prioritetet e qeverisë dhe aktualisht është më i ulëti në rajon.<sup>211</sup>

**172.** Për më tepër, për sa i përket strukturës organizative të objekteve të shëndetit mendor, MSH-ja ende nuk ka formuluar ndonjë plan për ndarjen e tyre. Shërbimet e kujdesit të shëndetit mendor

206 Evropa e Lirë (2023), [Saga e pafund e sigurimeve shëndetësore në Kosovë](#).

207 Evropa e Lirë (2023), [Saga e pafund e sigurimeve shëndetësore në Kosovë](#).

208 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën.

209 Evropa e Lirë (2023), [Saga e pafund e sigurimeve shëndetësore në Kosovë](#).

210 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 94-95.

211 QIPS (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

shpërndahen aktualisht në 7 rajone, secili i menaxhuar nga një institucion përkatës. Ndryshe nga rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë që avokojnë për ngritjen e një qendre të shëndetit mendor në çdo komunë për të rritur qasjen e qytetarëve dhe për të mbështetur kujdesin shëndetësor mendor të bazuar në komunitet, asnjë nismë e tillë nuk është aktualisht në progres.<sup>212</sup>

**173.** Çështja ndërlikohet nga mungesa e planifikimit strategjik për de-institucionalizimin dhe kalimin në një model të bazuar në komunitet. Komunitete specifike përballen me mungesë të plotë shërbimesh, shembull i mungesës së një qendre klinike për qytetarët e moshës mbi 65 vjeç, duke i lënë ata pa mbështetje thelbësore. Përveç kësaj, nuk ka shërbime të dedikuara për individët LGBTIQ+, dhe shërbimet e shëndetit mendor pas lindjes mungojnë dukshëm, duke theksuar nevojën urgjente për reforma gjithëpërfshirëse të shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë.

**174.** Gjendja kritike e shëndetit mendor në Kosovë nënvizohet nga pamjaftueshmëria e objekteve dhe masave të sigurisë në klinikat psikiatrike, siç ilustron nga një zjarr i ndezur nga pacientët në njësinë psikiatrike në Prishtinë në vitin 2023, duke treguar një mungesë të madhet të aparateve zjarrfikëse. Për më tepër, përdorimi i vazhdueshëm i metodave shtrënguese për të trajtuar çrregullimet e shëndetit mendor bie ndesh me rekomandimet e OBSH-së dhe Këshillit të të Drejtave të Njeriut (HRC), duke shkaktuar dëme të konsiderueshme mendore dhe fizike tek individët. Mungesa e shërbimeve publike, e shoqëruar me mungesën e planeve për qendra të reja të shëndetit mendor, e përkeqëson krizën.<sup>213</sup>

**175.** Shqetësuese është gjithashtu se banorët e dikurshëm dhe aktual rralë shprehin ankesa kundër institucioneve psikiatrike, një rrethanë që shpesh i atribuohet natyrës së qenësishme të çrregullimeve të trajtuara dhe stigmës mbizotëruese që rrethon shëndetin mendor.<sup>214</sup> Një faktor kritik që kontribuon në këtë heshtje është heqja e fuqisë së veprimit e përjetuar nga shumë pacientë, veçanërisht ata me gjendje ekonomikisht të pafavorshme ose me mungesë të dokumentacionit të duhur, duke i bërë ata praktikisht të paaftë për të ngritur ndonjë sfidë ligjore. Si rezultat i mungesës së të dhënave konkrete që kuantifikojnë vetëdijesimin për shëndetin mendor në Kosovë, vlerësimet aktualisht mbështeten në përvoja anekdotike. Veçanërisht, sipas OJQ QIPS, një trend i dukshëm është gatishmëria në rritje e individëve për të kërkuar shërbime në klinika private, ndërkohë që në institucionet publike, numri i individëve që i nënshtrohen trajtimit po rritet vazhdimisht. Ky model në zhvillim mund të shërbejë si një tregues premtues i rritjes së vetëdijesimit për shëndetin mendor brenda vendit.<sup>215</sup>

**176.** Kosova aktualisht është në proces të vazhdueshëm të formulimit të politikave të ndryshme lidhur me shëndetësinë. Megjithëse ekziston një listë kombëtare e barnave esenciale të destinuara për përdoruesit, mungesat e shpeshta vazhdojnë. Kjo mungesë është veçanërisht shqetësuese në fushën e mjekimeve psikiatrike, pasi paraqet rrezik për dëmtimin e pacientëve duke çuar potencialisht në çrregullime që rrjedhin nga planet e ndërprera të trajtimit. Për më tepër, lista nuk përfshin të gjitha medikamentet që konsiderohen esenciale nga OBSH-ja, as ndonjë zëvendësues

212 QIPS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

213 QIPS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

214 QIPS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

215 QIPS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

të mundshëm. Rrjedhimisht, individët, përfshirë ata me diagnozë për ADHD, e gjejnë veten të detyruar të blejnë privatisht medikamente jashtë Kosovës.<sup>216</sup>

**177.** Imunizimi rutinë po përmirësohet, por shkalla e mbulimit mbetet nën nivelet e para-COVID-19.<sup>217</sup> Si përgjigje, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë hapa për të forcuar mbrojtjen kundër sëmundjeve të parandalueshme me vaksina. Në veçanti, MSH-ja miratoi përfshirjen e tri vaksinave shtesë – PCV, rotavirus dhe HPV – në kalendarin rutinë të imunizimit. Ky vendim strategjik jo vetëm që zgjeron fushën e mbrojtjes, por gjithashtu nënvizon një qasje proaktive për ruajtjen e shëndetit të fëmijëve.<sup>218</sup>

**178.** Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve në Kosovë është alarmante në krahasim me BE-në dhe rajonin: është trefishi i mesatares së vdekshmërisë së fëmijëve në BE dhe më e larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor.<sup>219</sup> Veçanërisht në grupet jo-shumicë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Kosovës, shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve është më e lartë, duke treguar si të tillë që nevojat themelore shëndetësore nuk janë përmbushur. Një pjesë e problemit duhet kërkuar në fushën mjekësore dhe mungesën e mjekëve të specializuar. Për ilustrim, Kosova ka numrin më të ulët të anesteziologëve në Evropë, me specialistët që po emigrojnë gjithnjë e më shumë në rajone të tjera.<sup>220</sup>

**179.** Pavarësisht se Kosova ka një program të depistimit të kancerit, procesit të depistimit i mungon zbatimi sistematik sipas raportit të Komisionit Evropian. Për më tepër, Shërbimi Klinik Universitar i Kosovës ka raportuar një rritje të ndjeshme të rasteve me kancer, duke kaluar 2,000 në vitin 2023, krahasuar me 1,750 raste në vitin 2022. Ndërsa sipas departamentit të onkologjisë, ky numër lidhet drejtpërdrejt me një rritje të sëmundjeve malinje, mund të jetë gjithashtu një reflektim i qasjes në përgjithësi të ulët në shëndetësinë publike<sup>221</sup> dhe i mungesës së fushatave parandaluese të shëndetësisë publike.

**180.** Shëndeti mendor në Kosovë paraqet një shqetësim që rezulton nga mjedisi i pasluftës, varfëria, përjashtimi social dhe qasja e kufizuar në shërbimet e shëndetit mendor. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë vuan nga depresioni, ankthi dhe çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD).<sup>222</sup> Organizata Botërore e Shëndetësisë raportoi një rritje prej 25 përqind të çështjeve të shëndetit mendor, përfshirë ankthin dhe depresionin, gjatë pandemisë COVID-19, duke ndikuar edhe në Kosovë.<sup>223</sup> Në një raport të fundit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 30 përqind e qytetarëve të Kosovës raportohet se kanë përjetuar probleme mendore duke përfshirë ndjenjat e depresionit, trishtimit, ankthit dhe apatisë.<sup>224</sup> Në muajin maj u organizua java e shëndetit mendor me moton “Marshi i Mendjes: Së bashku për shëndetin mendor”. Ky shënoi marshimin e parë që synonte ndërgjegjësimin për rëndësinë e shëndetit mendor dhe tejkalimin e stigmatizimit shoqëror në lidhje me këtë temë.<sup>225</sup> Organizatorët bënë thirrje për rritjen e fondeve

216 QIPS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

217 Komisioni Evropian 2023, Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 94-95.

218 UNICEF (2023), [Raporti Vjetor i Zyrës së Vendit 2023](#).

219 Banka Botërore (2022), [shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve në Kosovë](#).

220 Koha (2022), [Kosova ndër kampionet evropiane për mungesë të anesteziologëve - KOHA.net](#).

221 Telegrafi (2023), [Rritët numri i rasteve me kancer në Kosovë, mbi 2 mijë gjatë vitit 2023](#).

222 KTV (2022), [Sonte me Rronin: Shëndeti mendor në Kosovë](#)

223 Evropa e Lirë (2023), [Prishtina pyet “Qysh je?”](#)

224 Revista Psika (2023), [Statistikat e sfidave të shëndetit mendor në Kosovë: Një realitet shqetësues në raportin e BERZH-it për vitin 2023](#).

225 Evropa e Lirë (2023), [Prishtina pyet “Qysh je?”](#)

për shërbimet e shëndetit mendor, përfshirjen e duhur të orëve mësimore të kujdesit për shëndetin mendor në sistemin arsimor dhe zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për parandalimin e vetëvrasjeve. Ata gjithashtu ngritën shqetësime për kostot e larta të shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë.

**181.** Në lidhje me vendimin për ndalimin e importit të produkteve serbe nga 14 qershori 2023, si dhe çështje të tjera procedurale, është penguar importi i barnave dhe mjeteve tjera mjekësore për institucionet shëndetësore që funksionojnë në kuadër të sistemit paralel të Serbisë në Kosovë. Situata në një moment u bë alarmante sepse në Qendrën Klinike dhe Spitalore në Mitrovicën e Veriut, si dhe në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor në mbarë Kosovën, nuk kishte furnizim me burime të besueshme dhe stabile, përveç vaksinave që janë të detyrueshme për fëmijët. Megjithatë, ky problem u zgjidh në fillim të nëntorit kur Ministri i Shëndetësisë i Kosovës miratoi importin e barnave dhe materialeve mjekësore. Kontingjenti i parë mbërriti në Qendrën Klinike dhe Spitalore në Mitrovicën e Veriut në nëntor 2023. Problemi i mungesës së një farmacie shtetërore funksionale në sistemin serb mbetet ende i hapur. Kjo posaçërisht prek grupet e ndjeshme të banorëve dhe përdoruesve të cilët nuk mund të marrin barna me përshkrim, por duhet t'i blejnë ose t'i gjejnë në Serbi, që në disa raste karakterizohet si import ilegal i barnave.<sup>226</sup>

## 182. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të fokusohet urgjentisht në përmirësimin e infrastrukturës së saj të shëndetësisë përmes një strategjie të shëndetësisë që përfshin masa për të frenuar largimin e konsiderueshëm të trurit të profesionistëve të shëndetësisë;
- MSH-ja duhet të zhvilloj masa strategjike për të ristrukturuar dhe përmirësuar sistemin e shëndetësisë, duke adresuar kushtet infrastrukturore dhe shqetësimet e pagave për të mbajtur personelin mjekësor të kualifikuar;
- Qeveria e Kosovës duhet të rrisë alokimin e buxhetit për sektorin e shëndetësisë për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të shërbimeve shëndetësore;
- Qeveria e Kosovës duhet të përshpejtoj krijimin e një sistemi publik të sigurimeve shëndetësore, duke siguruar kështu mbulimin në kohë për banorët e Kosovës me fokus të veçantë në grupet e cenueshme;
- Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH) duhet të funksionalizohet në mënyrë që të lehtësoj gjenerimin e të dhënave dhe të siguroj komunikim adekuat ndërmjet sektorëve privat dhe publik të shëndetësisë;
- Qeveria e Kosovës duhet të adresoj çështjen e shkallës së vdekshmërisë së fëmijëve, veçanërisht në komunitetet jo-shumicë, pjesërisht duke u fokusuar në plotësimin e nevojave themelore shëndetësore dhe përmirësimin e qasjes në kujdesin shëndetësor;

- Qeveria e Kosovës duhet të fillojë me rritjen e fondeve për kujdesin e shëndetit mendor dhe të përfshijë orët e kujdesit për shëndetin mendor në sistemin arsimor për të adresuar çështjet e shëndetit mendor në Kosovë;
- Qeveria e Kosovës duhet të zbatoj masa për të adresuar mungesën akute të anesteziologëve në Kosovë.

## 6.4 Të drejtat pronësore

**183.** Standardet ndërkombëtare mbi të cilat duhet të kuptojmë më së miri situatën e të drejtave të banimit dhe pronës në Kosovë janë nenet 17 dhe 1 respektivisht të DUDNj-së dhe KEDNj-së. DUDNj-ja është e qartë kur thotë se: “secili ka të drejtë të ketë pronë” dhe se “askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga prona e tij”.<sup>227</sup> Nga ana tjetër, GjEDNj-ja e përshkruan më në detaje lirinë themelore të pronës, duke e cilësuar atë në termat e “pasurisë”. Këtu përcaktohen edhe të drejtat e bartësve të detyrave për të kërkuar mekanizma rregullator për kontrollin e pronësisë së pasurisë.

**184.** Janë miratuar një sërë ligjesh dhe rregulloresh për të përcaktuar dhe rregulluar të drejtat pronësore në Kosovë. Në sferën e Kushtetutës, mbrojtja e pronës garantohet si nëpërmjet nenit 46, ashtu edhe nenit 156. Në përgjithësi, në nenin 46, mbrohet e drejta për të pasur pronë. Privimi arbitrar i të drejtave ligjore mbi pronën e dikujt bie ndesh me Kushtetutën. Më konkretisht duke iu referuar personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) dhe të kthyerve, fillimisht pas luftës në Kosovës dhe më gjerë, Kushtetuta e obligon Qeverinë e Kosovës të ofroj ndihmë të përshpejtuar për rikuperimin e ligjshëm të pronës. Ligjet dhe rregulloret e tjera që përshkruajnë pasqyrën legjislative të të drejtave pronësore në Kosovë janë si në vijim: Ligji Nr. 03/L-154 për Pronën dhe të Drejtat e tjera Sendore, Ligji Nr. 08/L-052 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Ligji Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës (AKKVP), i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2002. Gjithashtu, kornizën legjislative e plotësojnë Ligji Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligji Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore, Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë e Kosovës, Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Ligji Nr. 2004/32 për Familjen e Kosovës dhe Rregullorja Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme.

**185.** Projektligji i ri Nr. 08/L-268 për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme është miratuar në nëntor 2023. Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ligji synon të përmirësojë të drejtat pronësore dhe të sigurisë në Kosovë.<sup>228</sup> Duke vepruar kështu, ai përcakton rregullat dhe kushtet që rregullojnë shpronësimin e të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme nga Qeveria e Kosovës me qëllim të shërbimit të interesit publik. Gjithashtu, ligji përshkruan rregullat dhe kushtet për kufizimin dhe shfrytëzimin e përkohshëm të pronës së paluajtshme dhe përcakton procedurat për përcaktimin e vlerësimit dhe kompensimit në lidhje me këto veprime sipas Ministrisë.<sup>229</sup>

227 DUDNj, [neni 17](#).

228 Tëvë 1 (2023), [Miratohet projektligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme](#)

229 Kosova News (2023), [Miratohet vendimi i Projektligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme](#)

**186.** Mekanizmi mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e të drejtave pronësore, ligjeve dhe rregulloreve është Agjencia Kosovare për Verifikim të Pronës (AKVP). Kjo Agjenci ka për detyrë zgjidhjen e kërkesëpadive pronësore dhe për të drejtën e përdorimit të pronës së paluajtshme të natyrës rezidenciale dhe komerciale. Kjo përfshin pretendimet pronësore dhe mosmarrëveshjet që lidhen me luftën e Kosovës në fund të viteve '90, me të zhvendosurit dhe të kthyerit<sup>230</sup>.

**187.** Për shkak të pabarazisë strukturore gjinore në Kosovë, qasja e grave në pronë dhe të drejtat e trashëgimisë pengohen, megjithëse kornizat kushtetuese, ligjore dhe të politikave promovojnë dhe garantojnë qasjen e grave në to. Më tej, paaftësia e autoriteteve publike për të verifikuar vlefshmërinë e të dhënave kadastrale, si dhe paragjykimet personale të bazuara në normat dhe vlerat patriarkale që vetëm burrat duhet të zotërojnë ose trashëgojnë prona, ndikojnë në qasjen praktike të grave në pronë. Sipas raporteve të fundit të kryera nga OJQ Norma, e cila është pjesë e RrGK-së, vlerësohet se 23 përqind e grave në Kosovë trashëgojnë pronë,<sup>231</sup> me një burim tjetër që citon se vetëm 4 përqind janë pjesë e trashëgimisë familjare.<sup>232</sup>

**188.** Nga perspektiva legjislative, Qeveria e Kosovës i njeh të drejtat e përbashkëta martesore mbi pasurinë e fituar gjatë martesës. Përkundër kësaj, ushtrimi prej grave i këtyre të drejtave sfidohet në nivel shoqëror si rezultat i normave patriarkale. Prandaj, hendeku në pronësi mbetet i vazhdueshëm në vitin 2023 dhe ndikon në fuqizimin ekonomik të grave në një kuptim shumë të prekshëm. Përpjekjet e qeverisë për ta adresuar këtë çështje përmes një Udhëzimi Administrativ që daton nga viti 2016, duke inkurajuar regjistrimin e përbashkët pa pagesë të pronave, rezultuan në një rritje prej 4 përqind të pronave në pronësi të grave. Megjithatë, sfidat mbeten me zbatimin e pamjaftueshëm të legjislacionit ekzistues.<sup>233</sup> Instituti GAP vë në dukje se për vitin 2023, vetëm 14 përqind e grave posedojnë pronë, krahasuar me 74 përqind në pronësi të burrave. Përqindja e mbetur është në pronësi të personave juridikë.<sup>234</sup>

**189.** Kushtet e banimit të personave në situata të cenueshme nuk janë në përputhje me kërkesat minimale të sigurisë. Mungon vullneti dhe përkushtimi nga përgjegjësit zyrtarë për të ndihmuar në zgjidhjen e kushteve të tyre të jetesës.<sup>235</sup> Përmirësimi i kushteve të jetesës së grupeve të cenueshme mbetet i dobët nga ana institucionale dhe kryesisht varet nga bamirësia dhe donatorët.

**190.** OShC-të kanë shprehur shqetësimet e tyre për vendimet e Qeveria e Kosovës lidhur me shpronësimin e tokave në veri të Kosovës.<sup>236</sup> Në muajt e parë të vitit, Qeveria ekzekutoi dy vendime për shpronësim në komunat veriore Leposaviq dhe Zubin Potok. Toka e synuar, që përfshin 138 hektar, ishte caktuar për zhvillimin e bazave të reja të Policisë së Kosovës. Kjo iniciativë shkaktoi një përgjigje nga Zyra e BE-së në Prishtinë, duke theksuar rëndësinë e respektimit të procesit të shpronësimit sipas ligjit të Kosovës, i cili mandaton konsultimin publik dhe u ofron qytetarëve të

230 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës [AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS – \(kpcva.org\)](https://www.kpcva.org)

231 RrGK (2023), [Hulumtimi I OJQ "Norma" gjen se në Kosovë vetëm 23 përqind e grave dhe vajzave e trashëgojnë pronën.](#)

232 Zëri (2023), [As një e pesta e pronave në Kosovë nuk zotërohet nga grate.](#)

233 Zëri (2023), [As një e pesta e pronave në Kosovë nuk zotërohet nga grate.](#)

234 GAP (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

235 Kallxo (2022), [Barazia gjinore: rreth 126 mijë prona në emër të grave në Kosovë.](#)

236 Aktiv (2022), [Shqetësim lidhur me vendimet për shpronësim në veri të Kosovës.](#)

prekur mundësinë për t'i kundërshtuar ligjërisht vendimet para finalizimit. BE-ja i kërkoi qeverisë së Kosovës që të respektoj me kujdes procesin e duhur dhe të respektoj plotësisht të drejtat e pronarëve të pronave.<sup>237</sup>

**191.** Në tetor të vitit 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë nxorri aktgjykimin për anulimin e vendimit paraprak të Qeveria e Kosovës për shpronësim në lidhje me katër paditësit nga Leposaviqi, duke e urdhëruar Qeveria e Kosovës të rishqyrtoj një vendim të ri paraprak. Kërkesa e tetëmbëdhjetë (18) paditësve të tjerë u refuzua për shkak të mos ofrimit të dëshmisë së pronësisë për parcelat në fjalë, duke ngritur çështje lidhur me qasjen në drejtësi dhe të drejtën për mjete juridike efektive.<sup>238</sup>

**192.** Në fillim të shtatorit 2023, shtëpia e të kthyerit serb R.J. u dogj qëllimisht për herë të tretë. Ngjashëm, në korrik, shtëpia e një familje tjetër të kthyer serbe iu nënshtrua zjarrvënies dhe kah fundi i majit 2023, shtëpia e një tjetër të kthyeri serb M.D. në komunën e Pejës u rrënuar me forcë, përkundër një vendimi të vlefshëm të Gjykatës Supreme në favor të tij. Kjo pronë ishte konfiskuar nga autoritetet komunale në të kaluarën dhe përkundër vendimit të gjykatës, ajo nuk u kthye më. Në maj të vitit të kaluar, ai u përball me arrestimin me akuza në lidhje me një krim lufte kundër popullatës civile në vitin 1999. Procesi ligjor është në vazhdim, i shënuar me pesë zgjatje të paraburgimit. Vendimi për rrënimin e shtëpisë së tij ka ndodhur në një periudhë kur ai ende nuk ishte në paraburgim.<sup>239</sup>

### 193. Rekomandime

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPH) duhet të forcoj Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) si mekanizëm mbikëqyrës për të drejtat pronësore, duke siguruar efikasitetin e saj në zgjidhjen e kërkesave dhe kontesteve pronësore;
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj masa që adresojnë paragjykimet shoqërore dhe pabarazinë strukturore gjinore që ndikojnë në qasjen e grave në pronë dhe të drejtat e trashëgimisë, duke u fokusuar në verifikimin e të dhënave kadastrale, sfidimin e normave patriarkale dhe zbatimin e legjislacionit për të rritur pronësinë e grave në pronë;
- Qeveria e Kosovës duhet të forcojë përpjekjet e saj për të përmirësuar kushtet e banimit për grupet e cenueshme, duke kaluar përtej nismave të bamirësisë dhe donatorëve drejt angazhimeve institucionale, duke siguruar harmonizim me kërkesat minimale të sigurisë, veçanërisht për anëtarët e komuniteteve të cenueshme;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të zbatojë masat për të përshpejtuar ndihmën për rimarrjen e ligjshme të pronës, veçanërisht për personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) dhe të kthyerit, në përputhje me detyrimet kushtetuese pas konfliktit të viteve 1998-1999;

237 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

238 Koha (2024), [Qeveria heq dorë nga pronat në veri për të cilat i humbi lëndët gjyqësore](#).

239 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.



## 6.5 Të drejtat kulturore

**194.** Standardet ndërkombëtare që i njohin të drejtat kulturore si kritike për dinjitetin dhe vetë-përmbushjen e individëve janë nenet 22 dhe 27 të DUDNj-së. Në kornizën legjislative të Kosovës, Kushtetuta është shumë e qartë në mbrojtjen e të drejtave kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Neni 59 thotë se anëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të: “shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre”.<sup>240</sup> Për më tepër, komunitetet kanë të drejtë të: “themelojnë shoqata për kulturë, art, shkencë dhe arsim, si dhe shoqata akademike dhe të tjera për shprehjen, inkurajimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre”.<sup>241</sup> Shkelja e të drejtave kulturore kuptohet në Rezolutën 30/20 të Këshillit të të Drejtave të Njeriut si një kërcënim për “stabilitetin, kohezionin social dhe identitetin kulturor”.<sup>242</sup> Në programin e saj qeveritar, Qeveria e Kosovës angazhohet për përmirësimin e kornizës ligjore për promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.<sup>243</sup> Duke ditur këtë, është e rëndësishme të theksohet se Kosova ende nuk e ka integruar Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore si instrument thelbësor të kornizës së saj kushtetuese.

**195.** Infrastruktura për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kosovës përshkruhet në nenin 9 të Kushtetutës së Kosovës. Në nenin 9, trashëgimia kulturore e komuniteteve përshkruhet si “pjesë integrale e trashëgimisë së Kosovës”, dhe në përputhje me rrethanat, thuhet se “[...] Kosova e ka detyrë të veçantë për të siguruar një mbrojtje efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve me rëndësi kulturore dhe fetare për komunitetet”.<sup>244</sup> Në Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, fushëveprimi i trashëgimisë kulturore është përcaktuar si “trashëgimia arkitekturore, arkeologjike, e luajtshme dhe shpirtërore, pavarësisht nga koha e krijimit dhe ndërimit, lloji i ndërtimit, përfituesi, krijuesi apo zbatuesi i një vepre”.<sup>245</sup>

**196.** Dështimi i Qeverisë së Kosovës për ta amandamentuar Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, të përcaktuar si parakusht për transformimin politik të Kosovës në Aneksin V të Pakos së Ahtisaarit (2007), mbetet një çështje shqetësuese. Siç është theksuar në dy raportet e mëparshme të OShC-ve dhe në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2023, Këshilli i Zbatimit dhe Monitorimit (KZM) vazhdon të mbetet i vetmi mekanizëm formal për dialogun ndërmjet Qeveria e Kosovës dhe KOS-it.<sup>246</sup>

**197.** Sipas raportit të Komisionit Evropian, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) duhet të shtojë përpjekjet e saj për të përmirësuar statusin e komuniteteve artistike në Kosovë.<sup>247</sup> Shpenzimet buxhetore për kulturën shpesh minohen nga shpenzimet tjera qeveritare që shihen si më

240 Kushtetuta e Kosovës (2008).

241 Kushtetuta e Kosovës (2008).

242 Kushtetuta e Kosovës (2008).

243 QK (2021), [Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf \(rks-gov.net\)](#).

244 Kushtetuta e Kosovës (2008).

245 Ligji për Trashëgiminë Kulturore <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2533>Ligji Nr. 022/L-88 për Trashëgiminë Kulturore

246 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

247 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

urgjente në kontekstin e zhvillimit të Kosovës. Si rezultat, iniciativat që synojnë promovimin e artit dhe kulturës në Kosovë shpesh janë të vetëfinancuara dhe nuk kanë bashkëpunim me institucionet e Kosovës.<sup>248</sup>

**198.** Në vitin 2023, MKRS ka ndarë 500,000 euro për themelimin e Qendrës Kulturore Hebraike në Prizren. Qendra do të kontribuoj me ekspozita rreth lidhjeve kulturore hebraike në Kosovë, dhe avancimit të të kuptuarit të kulturës dhe traditave hebraike.<sup>249</sup>

**199.** Kosova aktualisht merr pjesë në programin Creative Europe. Nevojiten më shumë përpjekje për të rritur numrin e përfituesve të kulturës brenda partnerëve të BE-së.

**200.** Mosmarrëveshja ndërgrupore mes shqiptarëve dhe serbëve për karakterin etnik të Kosovës vazhdon të ndikoj në politizimin e trashëgimisë kulturore të njëri-tjetrit në vend. Dështimi i Qeverisë së Kosovës për të zbatuar Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 për të drejtat pronësore të Kishës Ortodokse Serbe mbi manastirin e Deçanit si dhe tokën fqinje, minon lirinë etno-fetare të komunitetit serb. Si përgjigje kundër kësaj, përfaqësuesit ortodoks Serb kanë dorëzuar një pyetje parlamentare në Parlamentin Evropian duke pyetur për të drejtat fetare në Kosovë. Në përgjigjen parlamentare të vënë në dispozicion përmes faqes së internetit në korrik, Parlamenti i BE-së theksoi presionet e bëra ndaj Qeverisë së Kosovës për zbatimin e vendimit.<sup>250</sup> Në maj 2022, Qeveria e Kosovës ritheksoi zotimin e saj për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të Kosovës dhe kërkoi që manastiri i Deçanit, Patriarkana e Pejës, Manastiri i Graçanicës dhe Kisha e Shën Premtës të hiqen nga Lista e Trashëgimisë Botërore në Rrezik.<sup>251</sup> Sipas raportit më të fundit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Qeveria e Kosovës nuk ka bërë asnjë përparim në këtë drejtim. Në maj, Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm përsëriti thirrjet për veprim.<sup>252</sup>

**201.** Kosova aktualisht nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) sepse nuk është njohur si shtet i pavarur nga të gjitha shtetet anëtare të OKB-së. Për t'u bërë anëtar i UNESCO-s, një shtet duhet së pari të jetë anëtar i Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, kjo nuk e ka zbrapsur kërkesën e Kosovës për anëtarësim në UNESCO, megjithëse aplikimi i saj është bllokuar vazhdimisht nga Serbia dhe aleatët e saj.

**202.** Raporti i Këshillit të Sigurimit të OKB-së thekson një seri incidentesh alarmante që targetojnë objektet fetare ortodokse serbe brenda Kosovës.<sup>253</sup> Këto përfshijnë rastet e vjedhjeve në Kishën Ortodokse Serbe dhe zonat e përcaktuara si zona të veçanta të mbrojtura sipas legjislacionit të Kosovës. Një incident i fundit përfshin vjedhjen e parave dhe sendeve nga një kishë ortodokse në fshatin Osojan të Istogut. Kleri ka denoncuar ngjarjen në polici, e cila nuk ka konstatuar asnjë shenjë të hyrjes me forcë apo dëmtimit të derës së kishës. Rasti tashmë është klasifikuar si 'vjedhje e rëndë' dhe me identifikimin e të dyshuarve do të ndërmerren veprimet ligjore.<sup>254</sup> Një tjetër rast i rëndësishëm ka ndodhur në Prizren, ku të miturit tentuan t'i vënë zjarrin derës së hyrjes së një kisha ortodokse serbe.<sup>255</sup>

248 Kosova live (2023), [Artistja Kosovare tregon sfidat që hasi gjatë karrierës: Arti në Kosovë është mbrapa me vendet e tjera](#).

249 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

250 Parlamenti Evropian (2022), [pyetje parlamentare për të drejtat ortodokse serbe në Kosovë](#).

251 Këshilli i Sigurimit i OKB-së (2021), [Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën 2021](#).

252 Këshilli i Sigurimit i OKB-së (2023), Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën 2023, fq. 14.

253 Këshilli i Sigurimit i OKB-së (2023), Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën 2023, fq. 14.

254 Sinjali (2023), [Vjedhje e rëndë në kishën ortodokse në Istog, Policia nis hetimet](#).

255 Koha (2023), [Kisha Ortodokse Serbe mirënjohëse ndaj Policisë për Kosovës për reagimin e saj ndaj incidentit në kishën në Prizren](#).

### 203. Rekomandime

- Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës duhet të përmirësojnë kornizën ligjore për promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës pjesërisht me plotësim/ndryshim të Ligjit për Trashëgimi Kulturore në përputhje me parakushtet e përcaktuara në Pakon e Ahtisaarit (2007);
- Kuvendi i Kosovës duhet të përfshijë në Kushtetutën Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore si instrument thelbësor të të drejtave të njeriut;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve duhet të mbrojë tërësinë e objekteve dhe monumenteve me rëndësi kulturore dhe fetare për komunitetet;
- Qeveria e Kosovës duhet të zbatojë vendimin e Gjykatës të vitit 2016 për të drejtat pronësore të Kishës Ortodokse Serbe mbi manastirin e Deçanit për të shmangur cenimin e lirisë etno-fetare të komunitetit serb;
- Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë masat e duhura për të garantuar sigurinë e objekteve fetare të Kishës Ortodokse Serbe dhe objekteve të tjera fetare;
- Qeveria e Kosovës duhet të ndajë më shumë fonde për kulturën në Kosovë dhe promovimin e qytetarëve për të marrë pjesë në jetën kulturore.

## 7. PJESA C: TË DREJTAT E PERSONAVE DHE TË GRUPEVE TË CAKTUARA

### 7.1 Të drejtat e grave dhe barazia gjinore

**204.** Të drejtat e grave mbrohen me ligje dhe rregullore të ndryshme. Në fushën kushtetuese, barazia gjinore njihet “si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, që ofron mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve në fushat politike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore”.<sup>256</sup> Përveç kësaj dispozite, Kushtetuta është në harmoni edhe me një sërë marrëveshjesh dhe konventash ndërkombëtare për mbrojtjen e diskriminimit në baza gjinore. Në veçanti, neni 22 thotë se përparësi ndaj ligjeve dhe dispozitave vendore u jepet konventave të zbatueshme drejtpërdrejt.<sup>257</sup> Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave dhe Konventa e Stambollit janë instrumente drejtpërdrejtë të zbatueshme të të drejtave të njeriut për të drejtat e grave.<sup>258</sup> Edhe pse nuk përmendet në mënyrë eksplicite në

<sup>256</sup> Kushtetuta e Kosovës (2008).

<sup>257</sup> Në veçanti, vetëm në rast konflikti apo keqkuptimi, marrëveshjet ndërkombëtare kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

<sup>258</sup> Konventa e Stambollit njihet formalisht si Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Kushtetutë, legjislacioni i Kosovës e njeh Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (Rezoluta 1325 e OKB-së).<sup>259</sup>

**205.** Neni 24 i Kushtetutës së Kosovës e përshkruan barazinë para ligjit si e drejta që askush “të mos diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”. Ligjet dhe rregulloret e tjera vendore për barazinë gjinore pasqyrojnë parimet dhe legjislacionin ndërkombëtar për barazinë gjinore dhe promovimin e të drejtave të grave. Kjo përfshin Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjin Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore që zëvendësoi Ligjin Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.<sup>260</sup>

**206.** OJQ QKSGj thekson se edhe pse Ligji për Barazi Gjinore ka përcaktuar obligimin e institucioneve publike që të sigurojnë përfaqësim minimal të grave në 50 përqind, kjo nuk reflektohet në ligjin për zgjedhjet në Kosovë, të cilin Kuvendi i Kosovës e ka miratuar. Neni 28 i Ligjit të ri për zgjedhjet ka përcaktuar se “Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku 30 përqind janë meshkuj dhe së paku 30 përqind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë”. Organizatat e grave kanë avokuar që ligji për zgjedhjet të jetë në harmoni me Ligjin për Barazi Gjinore, por ato nuk janë marrë parasysh.<sup>261</sup>

**207.** Dhuna në baza gjinore njihet si formë e diskriminimit sipas nenit 4 të Ligjit për Barazi Gjinore. Sipas Ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë, si subjektet publike ashtu edhe ato private duhet të inkorporojnë parimin e barazisë dhe integritet gjinor gjatë planifikimit, buxhetimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve. Kjo kërkesë shtrihet në fusha të tilla si lindja e fëmijëve dhe kompensimi. Për më tepër, ligji në mënyrë eksplicite ndalon ngacmimin dhe ngacmimin seksual në të gjitha kontekstet. Gjithashtu, Kodi Penal përcakton dhunën në baza gjinore, dhunën në marrëdhëniet familjare dhe veprat penale të dhunës seksuale, me rregullimin e bazës ligjore për dënime shtesë për personat e shpallur fajtorë për dhunë në familje dhe dhunë seksuale, si dhe duke i dhënë përparësi hetimeve dhe gjykimeve për këto raste.<sup>262</sup>

**208.** Në kuadër të kornizës legjislative të Kosovës është edhe neni 180 i Kodit Penal, i cili penalizon gjymtimin gjenital femëror dhe neni 239, i cili kriminalizon martesën e detyruar. Kodi Penal i Kosovës ka inkorporuar në thelb Konventën e Stambollit. Veç kësaj, Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale u fokusua në standardizimin “e veprimeve të nevojshme për përgjigje të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, fuqizimin dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarve të sulmit seksual dhe dhunës përmes ndërhyrjes së menjëhershme dhe profesionale nga institucionet përgjegjëse.” Kriminalizimi i vrasjes për nder mund të rrjedhë nga neni 173 i Kodit Penal.<sup>263</sup>

259 [Rezoluta 1325](#) pohon ndikimin e luftës tek gratë dhe vajzat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së plotë të grave në zgjidhjen e konflikteve

260 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

261 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

262 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

263 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**209.** Në shtator 2023, u miratua Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore. Ky njihet si një hap kryesor drejt një sistemi më të fuqishëm për parandalimin dhe trajtimin e një dhune të tillë. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Stambollit dhe Acquis të BE-së, ligji përforcon përgjegjësitë institucionale. Zyra e BE-së në Kosovë inkurajon Qeverinë e Kosovës që të sigurojë fonde të mjaftueshme për zbatimin efektiv të ligjit dhe nënvizon rëndësinë e zbatimit në kohë të masave adekuate dhe gjithëpërfshirëse legislative.<sup>264</sup>

**210.** Mekanizmat institucional që mbrojnë zbatimin e barazisë gjinore si e drejtë kushtetuese në institucionet publike dhe që i mbrojnë politikën që sigurojnë qasje të barabartë të grave në shoqëri dhe shërbime, rregullohen me ligj. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) është organi qeverisës i ngarkuar me monitorimin e zbatimit lokal të politikave publike ndërkombëtare dhe sistemimin e integritimit gjinor në politikën e Qeverisë së Kosovës.

**211.** Një avancim i rëndësishëm drejt integritimit gjinor në politikëbërjen lokale të Kosovës dhe zbatimin e kornizës ligjore është Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 (PKBGJ).<sup>265</sup> Obligimi për zhvillimin e PKBGJ-së si platformë referuese për zhvillimin e aktiviteteve dhe strategjive institucionale drejt zbatimit të kornizës ligjore është specifikuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore. Objektivi kryesor i PKBGJ-së është: “të avancojë parimet e barazisë gjinore dhe të krijojë një shoqëri paqësore, prosperuese dhe me harmoni për gratë dhe burrat në Kosovë”.<sup>266</sup> Për ta bërë këtë, PKBGJ i klasifikon veprimet e saj strategjike në tri shtylla: (1) fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale e grave, (2) rolet e zhvillimit njerëzor dhe marrëdhëniet gjinore, dhe (3) të drejtat e grave dhe qasja në drejtësi dhe siguri.

**212.** Barazisë gjinore i jepet prioritet në proceset integruese të Kosovës në BE, dhe për këtë arsye është një nocion qendror në tranzicionin e vazhdueshëm të Kosovës drejt një shoqërie demokratike. Megjithatë, në praktikë, OJQ RrGK dhe OJQ QKSGj theksojnë se integrimi gjinor nuk është i mjaftueshëm, si dhe nuk është në përputhje me kornizën legislative.<sup>267</sup> Për më tepër, përderisa buxheti i përgjegjshëm gjinor është i përcaktuar me ligj, Kosovës i mungon një kornizë gjithëpërfshirëse e buxhetit të përgjegjshëm gjinor dhe përfshirja e sektorëve kyç si ekonomia e kujdesit, siç është theksuar në një koment të fundit të RrGK-së për Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.<sup>268</sup>

**213.** Sipas Raportit të Komisionit Evropian (2023), në fushën e administratës publike mund të vërehet progres në rekrutimin e stafit.<sup>269</sup> Megjithatë, vazhdimësia e formave të hapura dhe të fshehta të diskriminimit vazhdon të minojë zhvillimin demokratik të shoqërisë, me ndarje të vazhdueshme shoqërore dhe hierarki pushteti të orientuara kah burrat.

264 Zyra e BE-së në Kosovë (2023), [BE-ja në Kosovë mirëpret miratimin e ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore](#)

265 Termi integrim gjinor është përcaktuar në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore në nenin 1.16 si vijon: “[...] përfshirja e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit, planifikimit, miratimit të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të legjislacionit, politikave apo programeve [...] duke marrë parasysh promovimin dhe avancimin e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave” (fq. 3).

266 Programi i Kosovës për Barazi Gjinore [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore](#) (2020).

267 RrGK (2023), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

268 RrGK (2023), [Ligji për Ndarjet Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës nga pikëpamja gjinore](#).

269 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

**214.** Pjesërisht si rezultat i pabarazive të përmendura më sipër, përfaqësimi i barabartë i grave në pozita kryesore vendimmarrëse në domenin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor mbetet sfida. Duke iu referuar raportit të mëparshëm, korniza zgjedhore nuk arrin të pasqyrojë kuotën e barazisë gjinore prej 50 përqind të përfaqësimit të grave.<sup>270</sup> Përmirësimi në përgjigjen ndaj Ligjit për Barazi Gjinore ka të bëjë me numrin e grave në ulëset e kuvendeve komunale, që korrespondon me 1,937 gra ose 37 përqind gra.<sup>271</sup> E njëjta gjë nuk vlen për partitë politike në të cilat diferencimi sipas gjinisë ekziston ende, duke shfaqur pritsmëritë patriarkale gjinore në struktura që nuk rregullohen nga mekanizmat rregullues nga lart-poshtë. Situata nuk është më e mirë as në drejtësi. Kosova ka 432 gjyqtarë (148 gra dhe 284 burra), dhe 183 prokurorë (78 gra dhe 105 burra), që është një përqindje e ulët e gjyqtareve dhe prokuroreve gra në krahasim me shumicën e vendeve të tjera evropiane.<sup>272</sup>

**215.** Hendeku ndërmjet politikave dhe praktikës pasqyrohet edhe në nënpërfaqësimin e grave në agjendat e paqes dhe sigurisë. Sipas rezolutës 1325, proceset e sigurisë dhe të ndërtimit të paqes në Kosovë kërkojnë përfshirjen e grave në ekipet negociuese gjatë dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, sipas OJQ RrGK, gratë mbeten të nënpërfaqësuar në pozitat e larta politike, duke mos arritur kështu përfshirjen e grave në tryezën e negociatave.<sup>273</sup> Zbatimi i Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore është parakusht për korrigjimin e disbalancës. Prandaj, dështimi në zbatimin e masave afirmative të ligjit të lartpërmendur shpesh fshihet pas konceptit të meritokracisë.<sup>274</sup> Megjithatë, një hap pozitiv përpara në vitin 2023 është se megjithëse numri i deputeteve gra ka mbetur i njëjtë, ka një rritje të numrit të grave që drejtojnë më shumë se gjysmën e komisioneve të Kuvendit të Kosovës.<sup>275</sup>

**216.** Gjuha seksiste dhe komentet nënçmuese drejtuar politikaneve gra vazhduan pa pushim në vitin 2023, duke ilustruar mjedisin armiqësor që cenon aspiratat e grave për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike. Një rast veçanërisht ilustrues ishte sulmi ndaj nënkryetares Saranda Bogujevci, e cila shprehu dëshirën e saj të mundshme për të pasur fëmijë pa partner. Diskursi i ashpër që pasoi, i përdorur kundër saj, shkeli dinjitetin e saj individual dhe minoi vetë parimet e barazisë gjinore të mishëruara në themelet legjislative të Kosovës.<sup>276</sup>

**217.** Përveç kufizimeve të vendosura ndaj grave në strukturat qeveritare nga lart-poshtë, diskriminimi në baza gjinore vazhdon edhe në sferat socio-ekonomike të shoqërisë. Megjithatë, në aspektin numerik, Tabela 1 tregon rikonfigurimin e normave të papunësisë sipas gjinisë, sipas të dhënave më të fundit të disponueshme nga ASK-ja.<sup>277</sup> Nënpërfaqësimi i grave në tregun e punës mbetet me një çekuilibrë prej 18.6 përqind të grave të papuna krahasuar me 8.6 përqind të burrave në vitin 2023 (shih tabelën). Krahasuar me shkallën e përgjithshme të pjesëmarrjes në punë në Ballkanin Perëndimor, Kosova ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes në rajon.<sup>278</sup>

270 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

271 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

272 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

273 RrGK (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

274 RrGK (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

275 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 8.

276 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

277 ASK (2024), [shkalla e papunësisë në Kosovë](#).

278 RrGK (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

**Tabela 2 Analiza e trendit të shkallës së papunësisë në Kosovë sipas gjinisë ndërmjet viteve 2020-2023 (mosha 15 deri në 65 vjeç)**

<b>2020</b>	<b>Burra</b>	<b>Gra</b>	<b>Gjithsej</b>
numri	80.173	42.206	121.379
përqindja	23.5	32.3	25.9
<b>2021</b>	<b>Burra</b>	<b>Gra</b>	<b>Gjithsej</b>
numri	66.154	34.007	100.161
përqindja	19.0	25.0	20.7
<b>2022</b>	<b>Burra</b>	<b>Gra</b>	<b>Gjithsej</b>
numri	51.863	25.357	77.220
përqindja	15.6	18.9	11.8
<b>2023</b>	<b>Burra</b>	<b>Gra</b>	<b>Gjithsej</b>
numri	27.999	24.718	52.717
përqindja	8.6	18.6	11.5

**218.** Edhe në vitin 2023 Qeveria e Kosovës e ka vonuar ndryshimin dhe miratimin e Ligjit të Punës që do ta harmonizonte atë me Direktivën e BE-së për Ekuilibrin Punë-Jetë. Vonesa e vazhdueshme në miratimin e këtij ligji kontribuon në vazhdimin e diskriminimit në baza gjinore në punë. Vetëm disa raste janë raportuar për shkak të njohurive të pamjaftueshme të mekanizmave të referimit institucional, dhe inspektimeve të pamjaftueshme për këtë çështje (me ato pak raste ekzistuese të mbështetura nga BE-ja përmes kontaktit me OShC-të e grave dhe ndihmës juridike falas). Ligji dështon në mbrojtjen e grave në pushim të lehonisë nga skadimi i kontratave të shkurtra.

**219.** OJQ QKSGj thekson se përkundër kriminalizimit të ngacmimit seksual në vendin e punës në legjislacionin e Kosovës, kjo dukuria ende duhet të shqyrtohet më thellë në sektorin privat, pasi që Kosovës i mungojnë të dhënat për sferën private pasi që është nuk është formalizuar bashkëpunimi institucional me këtë sektor. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ia ka adresuar çështjen Inspektoratit të Punës duke thënë se ata nuk i trajtojnë sa duhet rastet e ngacmimeve seksuale në vëzhgimin dhe raportimin e tyre.<sup>279</sup>

279 OJQ QKSGj (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**220.** Ekziston një shqetësim i madh për situatën e rëndë me të cilën përballen strehimoret që ofrojnë shërbime rezidenciale për viktimat e dhunës në familje, fëmijët pa kujdes prindëror dhe viktimat e trafikimit në vitin 2023. Krahasuar me periudhën e mëparshme raportuese dhe mbështetjen e mëparshme financiare nga MD-ja, strehimoret po përballen me një krizë financimi, sipas një publikimi të fundit të RrGK-së.<sup>280</sup> Veç kësaj, OJQ QKSGj thekson mungesën e transparencës kur bëhet fjalë për ndarjet buxhetore të MD-së për strehimoret. Ata deklarojnë se që kur Qeveria e Kosovës ka marrë përsipër financimin e strehimoreve me buxhetin e shtetit, ata e kanë pasur të vështirë të sigurojnë të dhëna që kanë qenë më të qasshme në të kaluarën.<sup>281</sup> Marrë parasysh numrin e kufizuar të strehimoreve në Kosovë dhe mungesën e organizatave të specializuara për të ndihmuar të mbijetuarat e keqtrajtimin në familje pas largimit nga strehimoret, shumë gra përballen me sfida të karakterizuara nga të hyra të ulëta financiare, duke i lënë ato pa alternativa veçse të kthehen në familjen keqtrajtuese.<sup>282</sup>

**221.** Vlerësimi i vazhdueshëm për punësimin e të mbijetuarave të dhunës në familje shënon një hap vendimtar përpara në vitin 2023, sipas OJQ QKSGj.<sup>283</sup> Udhëzuesi për optimizimin e mekanizmave lokal kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, shoqëruar me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026), po nxit në mënyrë aktive një përpjekje bashkëpunuese midis institucioneve dhe shoqërisë.<sup>284</sup>

**222.** Në një raport të publikuar së fundi të kryer nga OJQ QKSGj në bashkëpunim me OJQ IKD, janë analizuar 50 aktgjykime gjyqësore nga viti 2022 për lëndë që kanë të bëjnë me elemente të dhunës në familje, të cilat janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga gjykatat themelore në Kosovë, së bashku me 14 aktgjykime të tjera nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Objektivi ishte vlerësimi i respektimit të standardeve të përcaktuara në Konventën e Stambollit në vendimet e gjykatave të Kosovës. Afati kohor procedural ishte një nga elementët nën shqyrtim. Gjetjet treguan se koha mesatare e trajtimit nga vepra penale deri në vendimin e shkallës së parë është gjithsej 266 ditë ose 8.5 muaj në rastet e dhunës në familje. Kjo sugjeron që rastet mesatarisht përpunohen brenda një afati kohor adekuat dhe rrjedhimisht në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit.<sup>285</sup>

**223.** I njëjti raport shqyrtoi edhe kornizën ligjore, duke zbuluar se 58 përqind e rasteve klasifikohen si vepra penale sipas nenit 248 të Kodit Penal. Raporti përmbledh se në 12 përqind të rasteve vepra është kategorizuar si dhunë në familje e shoqëruar me një tjetër vepër penale dhe 20 përqind të tjera janë klasifikuar si lëndim i lehtë trupor sipas nenit 185 të Kodit Penal. 4 përqind e rasteve u kategorizuan si sulm apo kërcënim dhe 2 përqind përfshinin vepra të ngacmimeve të vazhdueshme. Në këtë aspekt, OJQ IKD thekson përafrimin e veprave të kryera në kontekst familjar me Kodin Penal, Udhëzimet e Gjykatës Supreme dhe Konventën e Stambollit, duke kërkuar kështu klasifikimin e tyre si “dhunë në familje” kurdo që është e mundur.<sup>286</sup>

280 RrGK (2023), [RrGK i bën thirrje Qeverisë të adresojë nevojat e strehimoreve dhe shërbimeve tjera sociale](#),  
281 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.  
282 RrGK (2023), [Pas strehimorës e pastrehë](#).  
283 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.  
284 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.  
285 QKSGj (2023) dhe IKD (2023), [Konventa e Stambollit në aktgjykimet e gjykatave në Kosovë, fq. 21](#).  
286 QKSGj (2023) dhe IKD (2023), [Konventa e Stambollit në aktgjykimet e gjykatave në Kosovë, fq. 21](#).



**224.** Veçanërisht, sipas të njëjtit raport, 72 përqind e viktimave të dhunës në familje nuk kanë përfaqësim profesional, në kundërshtim me Konventën e Stambollit dhe legjislacionin në fuqi. Për më tepër, politika e përgjithshme ndëshkimore në rastet e keqtrajtimit në familje u karakterizua nga një qasje e butë: 74 përqind e rasteve rezultuan me burgim me kusht kundrejt vetëm 10 përqind në burgim efektiv të kryesve të dhunës në familje. Prandaj, ndëshkimet më të rrepta mund të lehtësojnë frenimin e autorëve dhe luftimin e incidenteve.<sup>287</sup>

**225.** Në dhjetor të vitit 2022, u lansua Protokoli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Kosovë. Kjo ishte një iniciativë e MD-së dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore në bashkëpunim të ngushtë me OJQ RrGK, BE-në dhe UN Women Kosovo, të cilët ofruan mbështetje në hartimin e dokumentit. Protokoli i përgjigjet zotimit të Kosovës ndaj Konventës së Stambollit dhe "[...] thekson nevojën për të pasur një përgjigje të standardizuar, të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, fuqizimin dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarve të sulmit seksual dhe dhunës përmes ndërhyrjes së menjëhershme nga institucionet përgjegjëse."<sup>288</sup>

**226.** Një shqetësim i rëndësishëm institucional është stigmatizimi i vazhdueshëm dhe fajësimi i viktimave. Ndërhyrja e papërshtatshme nga gjyqtarët dhe prokurorët konsiston në presionin që u bëhet viktimave për t'u pajtuar me autorët e dhunës në familje. Kjo tregon nevojën për trajnimin e gjyqtarëve në zbatimin e legjislacionit aktual.<sup>289</sup>

**227.** Nga janari 2023 deri në dhjetor 2023, në Policinë e Kosovës janë raportuar 2,638 raste të dhunës në familje. Nga këto raste, 2,120 (ose 80.3 përqind) janë raste të dhunës ndaj vajzave dhe grave në mjediset shtëpiake, ndërsa 597 përfshijnë burra. Në këto raste kryesit kanë qenë 2,375 burra, ndërsa gra vetëm 374. Kjo do të thotë se rastet e dhunës në familje vazhdojnë të rriten, krahasuar me vitet e tjera, dhe të mbijetuarat e këtyre rasteve janë kryesisht gra, gjë që tregon dhunë sistematike ndaj grave dhe vajzave. Këto të dhëna janë vënë në dispozicion në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë, platformë e cila është mbështetur jashtëzakonisht shumë nga UN Women. OJQ QKSGj konsideron se ky hap i vonuar është vendimtar për gjurmimin e rasteve të dhunës në familje si dhe të femicidit, ndonëse duhet të lansohet edhe një platformë e veçantë për rastet e femicidit.<sup>290</sup>

**Tabela 2. Rastet e dhunës në familje midis viteve 2019 dhe 2023<sup>291</sup>**

Viti	2019	2020	2021	2022	2023
Rastet e dhunës në familje në shifra	1,915	2,069	2,200	2,273	2,638

287 QKSGj (2023) dhe IKD (2023), [Konventa e Stambollit në aktgjykimet e gjykatave në Kosovë, fq. 21.](#)

288 UN Women (2022), [Protokoli i ri për reagim ndaj dhunës seksuale në Kosovë.](#)

289 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022.](#)

290 QKSGj (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

291 Ministria e Drejtësisë (MD 2024), [databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje.](#)

**228.** Edhe pse trendet tregojnë se dhuna në familje është në rritje, numri i përgjithshëm i incidenteve ka gjasa të nën-raportohet. Në këtë aspekt, UN Women thekson se një spektër i gjerë faktorësh i shtyjnë viktimat e dhunës në familje të heshtin. Në një kontekst të normave patriarkale, gratë në veçanti përjetojnë frikë nga partnerët dhe familjet e tyre për ta raportuar dhunuesin në polici. Faktorë të tjerë, duke përfshirë mungesën e trashëgimisë dhe kushtet e pasigurta financiare, kontribuojnë në hezitimin e shumë të mbijetuarave për t'i raportuar incidentet në polici. Mesatarisht, sipas RrGK-së, viktimat që i raportojnë rastet e keqtrajtimit kanë pësuar dhunë të gjatë për 7 deri në 10 vjet përpara se të shkojnë në polici.<sup>292</sup> Situata aktuale thekson nevojën kritike për veprim shoqëror, veçanërisht në fuqizimin e brezit të ri për të avokuar për promovimin e një shoqërie në të cilën gratë kanë të drejta të barabarta për arsim, punësim dhe pronë. Parandalimi i dhunës në familje mund të arrihet vetëm nëpërmjet një ndryshimi shoqëror që kontribuon në një mjedis më të barabartë.<sup>293</sup>

**229.** Përgjatë tri periudhave të fundit raportuese që përfshijnë vitet 2021, 2022 dhe 2023, femicidi intim fatkeqësisht është rrënjësor në shoqërinë kosovare, duke shfaqur trende shqetësuese dhe të vazhdueshme shoqërore. Në vitin 2023 janë regjistruar katër raste të femicidit intim.<sup>294</sup> Të dhënat tregojnë një trend shqetësues me të paktën 55 gra të vrara në Kosovë prej vitit 2010, kryesisht nga bashkëshortët, baballarët dhe djemtë.<sup>295</sup>

**230.** Protestat për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje kanë vazhduar prej disa vitesh, por kanë marrë një vrull të veçantë në vitet 2021, 2022 dhe 2023. Protestat u nxitën nga disa raste të dhunës ndaj grave me rastin më të rënd në vitin 2023 atë të vrasjes së Liridona Ademajt.<sup>296</sup> Ky rast hodhi dritë mbi dështimin e Policisë së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse për t'i mbrojtur viktimat. Protestat u drejtuan nga organizata të të drejtave të grave, aktiviste dhe të mbijetuara të dhunës, të cilat kërkuan që qeveria të veprojë për të trajtuar çështjen e sigurisë për të gjitha gratë në Kosovë dhe të dhunës në baza gjinore në rajon.<sup>297</sup>

**231.** Lidhur me paragrafin paraprak dhe detyrimet pozitive të autoriteteve shtetërore për të mbrojtur të drejtën e jetës, Gjykata Kushtetuese vendosi për rastin e femicidit të Sebahate Morinës. Gjykata konkludoi se policia dhe prokuroria nuk reagueshan menjëherë dhe nuk arritën të kryenin një vlerësim të duhur të rrezikut, si dhe nuk morën masa të mjaftueshme parandaluese të cilat përfundimisht e rrezikuan jetën e Morinës. Vendimi thekson detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur individët nga dhuna në familje dhe nënvizon mangësitë sistematike në trajtimin e dhunës në baza gjinore.<sup>298</sup>

292 Gazeta Express (2024), [katër gra u vranë brenda vitit 2023 në Kosovë](#).

293 Gazeta Express (2024), [katër gra u vranë brenda vitit 2023 në Kosovë](#).

294 Gazeta Express (2024), [katër gra u vranë brenda vitit 2023 në Kosovë](#).

295 Evropa e Lirë (2023), [Si të këputet zinxhiri i femicidit?](#)

296 Kallxo (2023), [Vrasja e Liridona Ademajt, nis protesta e thirrur nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist](#).

297 Kallxo (2023), [Vrasja e Liridona Ademajt, nis protesta e thirrur nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist](#).

298 Betimi për Drejtësi (2023), [Rasti i Sebahate Morinës: Gjykata Kushtetuese konstaton se i është shkelur e drejta për jetë](#).

## 232. Rekomandime

- Kuvendi i Kosovës duhet të harmonizojë Ligjin për Zgjedhjet me Ligjin për Barazi Gjinore në mënyrë që të sigurojë konsistencë institucionale në promovimin e përfaqësimit të grave;
- Qeveria e Kosovës dhe Agjencia për Barazi Gjinore duhet të zhvillojnë masa për të luftuar gjuhën seksiste dhe komentet nënçmuese ndaj politikaneve gra, duke nxitur një mjedis politik më të respektueshëm dhe gjithëpërfshirës;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të zhvilloj strategji të targetuara për të adresuar diskriminimin në baza gjinore në sferat socio-ekonomike, duke u fokusuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe uljen e hendekut gjinor;
- Inspektorati i Punës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Oda Ekonomike e Kosovës duhet të formalizojnë bashkëpunimin institucional me sektorin privat për të adresuar ngacmimet seksuale dhe të bëjnë ekzaminime të thelluara të shfaqjes së tij;
- Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurojnë ndarje buxhetore transparente për strehimoret, duke siguruar fonde të mjaftueshme për të adresuar krizën e financimit me të cilën përballen strehimoret, si dhe për të ofruar shërbime rezidenciale;
- Qeveria e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit duhet të përmirësojnë fushatat gjithëpërfshirëse shoqërore për të fuqizuar brezin e ri që të avokojë për barazinë gjinore, parandalimin e dhunës në familje dhe sfidimin e normave patriarkale;
- Përgjegjshmëria e Policisë së Kosovës duhet të përmirësohet me strategji për vlerësimin e riskut në rastet e dhunës në familje, të cilat sigurojnë masa parandaluese në kohë dhe efektive për të mbrojtur individët në risk;
- MD-ja duhet të iniciojë procedura për kriminalizimin e femicidit;
- MD-ja, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, duhet të krijojë një bazë të dhënash me informata të sakta dhe të besueshme për rastet e femicidit, pasi që informatat në dispozicion janë të pasakta dhe ka mospërputhje.

## 7.2 Të drejtat e fëmijëve

**233.** Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), e cila i përcakton fëmijët si persona nën moshën 18 vjeçare, është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës dhe ka përparësi ndaj ligjeve dhe akteve vendore. Megjithatë, kjo Konventë, e cila nuk po zbatohet mjaftueshëm nga gjyqtarët dhe prokurorët, siç parashihet me nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës, përcakton të drejtat e fëmijëve në gjashtë traktatet themelore të të drejtave të njeriut.<sup>299</sup> Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve si shtyllë themelore e zhvillimit demokratik të Kosovës është përcaktuar

299 UNHCR (1989), [Konventa për të Drejtat e Fëmijës](#).

me Kushtetutë në nenin 50 (nga paragrafët 50.1-50.5). Kushtetuta e vë theksin në mirëqenien, barazinë dhe mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi, dhuna dhe çdo formë shfrytëzimi. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, legjislacioni primar është plotësuar së fundmi me Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve. Sipas UNICEF (2021), Ligji, i cili hyri në fuqi në vitin 2020, shënoi një "arritje historike" në kornizën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.<sup>300</sup> Ky ligj i mbron fëmijët nga forma të ndryshme të keqtrajtimit fizik, mendor dhe emocional; nga neglizhenca; dhe nga shfrytëzimi në të gjitha sferat shoqërore duke filluar nga institucionet e përkujdesjes, objektet publike, e deri te shtëpia.

**234.** Zbatimi faktik i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili ka hyrë në fuqi më 19 korrik 2020, ende nuk është zbatuar plotësisht në vitin 2023. Shumica dërmuese e profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve nuk kishin njohuri për përgjegjësitë që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe as risitë që sjell ky ligj. Nga gjithsej 17 Udhëzime Administrative të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, vetëm 9 prej tyre janë miratuar deri më tani.<sup>301</sup> Sipas monitorimit të fundit të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) të publikuar si Karta e Vlerësimit, ende nuk janë krijuar shërbimet dhe programet e reja të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve.<sup>302</sup> Parandalimi nuk është ende një element kyç i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës. Në veçanti, ende nuk janë krijuar linja falas e ndihmës për fëmijët dhe shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve. Ndër sfidat kryesore në mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore mbetet vonesa në zgjidhjen e statusit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe shërbimeve për fëmijët pa përkujdesje prindërore në kushte të vështira dhe ata pas moshës 18 vjeç. Një hap pozitiv është rritja e pagesës mujore për fëmijët në kujdestari dhe zhvillimi i programeve të dedikuara për rritjen e kapaciteteve të familjeve kujdestare për fëmijët pa përkujdesje prindërore, prindërve potencialë birësues dhe profesionistëve. Identifikimi dhe raportimi apo vetë-raportimi i fëmijëve në situata dhune dhe trajtimi sistematik i rasteve të dhunës, janë ende çështje problematike. Kosovës ende i mungojnë shërbimet e specializuara që do të merreshin me mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve. Për sa i përket trafikimit, identifikimi i fëmijëve viktimë të trafikimit, trajtimi i sistemit të drejtësisë dhe riintegrimi afatgjatë, mbeten ndër sfidat më të mëdha.<sup>303</sup>

**235.** Siç është cekur në pjesën 6.2, Ligji Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijëri të Hershme është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Për shkak se ky ligj rregullon ofrimin e standardeve cilësore të edukimit dhe e bën edukimin parashkollor të detyrueshëm nga viti 2024, qasja në edukimin parashkollor në Kosovë duhet të ketë rritje të dukshme. Ligji gjithashtu ofron bazën ligjore për ofrimin e shërbimeve të Edukimit në Fëmijëri të Hershme përmes modeleve të ndryshme, duke përfshirë qendrat me bazë në komunitet si një formë alternative e Edukimit në Fëmijëri të Hershme, të cilat Save the Children Kosova po i zgjeron në të gjithë vendin, duke kontribuar në një rritje prej 8 përqind në qasjen e fëmijëve 0-6 vjeç në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme të bazuar në komunitet, krahasuar me shkallën totale të regjistrimit në Kosovë të vitit 2022.<sup>304</sup> Në total, shifrat janë mjaft alarmante, me frekuentimin e edukimit parashkollor shumë nën standardin evropian prej 96 përqind dhe më të ulët se mesatarja rajonale. Krahasuar me vendet e tjera të rajonit, Kosova mbetet vendi me përfshirjen më të ulët të fëmijëve në edukimin parashkollor. Vetëm 15 përqind e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç ndjekin programet e edukimit në fëmijëri të hershme, të cilët zakon-

300 UNICEF (2021), [Gjendja e të drejtave të fëmijëve në Kosovë](#).

301 Terres des Hommes Kosova (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

302 KOMF (2024), [Karta e Vlerësimit: Cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve?](#)

303 KOMF (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

304 Save the Children Kosova / (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

isht jetojnë në familje më të pasura.<sup>305</sup> Të dhënat më të fundit në dispozicion tregojnë se vetëm 38 përqind e fëmijëve të Kosovës 3 deri 5 vjeç kanë qasje në ndonjë lloj strukture të mësimnxënies.<sup>306</sup> Në Raportin e tyre, OJQ KOMF ka theksuar se arsyeja kryesore për përfshirje kaq të ulët është kapaciteti i vogël absorbues i institucioneve parashkollore dhe ndërgjegjësimi i përgjithshëm për format tradicionale të edukimit në familje. Institucionet parashkollore janë kryesisht të fokusuar në zonat urbane dhe zonat rurale janë pothuajse të përjashtuara nga qasja në shërbimet e zhvillimit në fëmijëri të hershme.<sup>307</sup>

**236.** Mekanizmat institucional që garantojnë zbatimin e legjislacionit dhe përfshijnë mekanizmat për pjesëmarrje të fëmijëve, janë përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.<sup>308</sup> Ato përfshijnë Komitetin Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve, i cili funksionon në kuadër të ZKM-së përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë, dhe mekanizma të tjerë në nivel qendror dhe lokal.<sup>309</sup> Shumë e rëndësishme për sigurimin e zbatimit efektiv të mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë është Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Fëmijës (2019-2023).<sup>310</sup> Zyra për Qeverisje të Mirë luan një rol kryesor në proceset që lidhen me hartimin dhe zbatimin e Strategjisë. Në bashkëpunim të ngushtë me UNICEF-in, OJQ Save the Children Kosova, OJQ Syri i Vizionit dhe OJQ të tjera, dokumenti parasheh katër objektiva strategjike që kanë si synim kryesor "[...] ndërmarrjen e iniciativave që përmirësojnë situatën e fëmijëve në kontekste ekonomike, sociale dhe politike në Kosovë".<sup>311</sup> Fokusi kryesor është instrumentalizimi i kornizës ligjore dhe njohja e interesit më të lartë të fëmijës në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe ofrimit të shërbimeve.<sup>312</sup> Prandaj, strategjia katërvjeçare ka në qendër reformimin e sistemit të drejtësisë për fëmijët. Po kështu, ofrimi i shërbimeve që kontribuojnë në shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve janë të detajuara në këtë Strategji.

**237.** Shkollave u mungon stafi profesional dhe mbështetës si psikologë, pedagogë dhe asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Aktualisht janë rreth 200 psikologë dhe pedagogë në shkolla në shkallë vendi. Marrë parasysh se janë 1,047 institucione arsimore, mund të konstatohet se as një e katërta e shkollave nuk kanë psikologë. Përfshirja e fëmijëve më të cenueshëm në të gjitha nivelet e arsimit, si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga komunitetet jo-shumicë, të cilët nuk marrin mbështetjen e duhur për të arritur potencialin e tyre të plotë, vazhdon të mbetet çështja më sfiduese.<sup>313</sup>

**238.** Vlerësimi i mekanizmave institucional lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë është i pandashëm nga kuptimi i gjendjes faktike në terren. Ndryshe nga periudha e mëparshme raportuese, është krijuar pjesërisht mekanizmi kryesor institucional i paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.<sup>314</sup> Kjo ka të bëjë me Këshillin për të Drejtat e Fëmijëve, i cili funksionon si mekanizmi

305 KOMF (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

306 AA (2023), [Kosovë, prezantohet Ligji për edukimin në fëmijërinë e hershme](#).

307 KOMF (2024), [Karta e Vlerësimit: Cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve?](#)

308 Save the Children Kosova (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

309 Terres des Hommes Kosova (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

310 Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023 [Strategjia-per-te-Drejtat-e-Femijeve-ANG-FINAL\\_20190219.pdf \(rks-gov.net\)](#).

311 Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023 [Strategjia-per-te-Drejtat-e-Femijeve-ANG-FINAL\\_20190219.pdf \(rks-gov.net\)](#).

312 Save the Children Kosova (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

313 KOMF (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

314 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 38.

më i lartë në nivel qendror që koordinon punën për zbatimin e ligjit, si dhe mekanizma të tjerë në nivel qendror dhe institucional.<sup>315</sup> Për më tepër, ekipet komunale për të drejtat e fëmijëve janë themeluar në 14 komuna, ndërsa themelimi në komunat e mbetura duhet të mbetet prioritet.<sup>316</sup>

**239.** Kosova ka një kornizë ligjore për ta adresuar delikuecën e të miturve, e cila siguron mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe promovon rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Sipas Kodit për Drejtësinë për të Miturit, fëmijët që kryejnë vepra penale u nënshtrohen procedurave dhe sanksioneve që dallojnë nga ato që zbatohen për të rriturit. OJQ KOMF (2024) ka vlerësuar se edhe pse Kodi i ri i Drejtësisë për të Mitur i ka dyfishuar masat alternative, të cilat luajnë një rol vendimtar në parandalimin e fillimit të proceseve gjyqësore ndaj të miturve dhe promovimin e rehabilitimit dhe riintegrimin të tyre në shoqëri, zbatimi i masave alternative përballat me sfida. Sipas “Raportit” të publikuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, vitet e fundit në sistemin e drejtësisë për të miturit vërehet një rënie e ndjeshme në zbatimin e këtyre masave. Të miturit me masa edukative vendosen në një institucion të tipit të mbyllur, gjë që përbën shkelje të dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe që përbën shkelje të rëndë të të drejtave themelore të fëmijëve. Kjo për faktin se Qendra e Hapur e Edukimit nuk bën pranime të drejtpërdrejta në bazë të vendimit të Gjykatës, por vetëm transferime nga Qendra Korrektuese. Shqetësim i vazhdueshëm është fakti se në mungesë të një qendre korrektuese për të miturat femra, ato vendosen në një qendër me gra të paraburgosura/të dënuara. Më tej, ekziston një numër i madh i zyrtarëve të Qendrës Korrektuese dhe një numër shumë i vogël i stafit profesional që evidenton qëllimin kryesor të sistemit aktual korrektues për të parandaluar arratisjen dhe jo për të punuar për rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve.<sup>317</sup>

**240.** Gjithashtu, sipas OJQ KOMF (2024), mungojnë të dhënat për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve që konsumojnë duhan, alkool, dhe të fëmijëve që përdorin drogë. Mbështetja e qeverisë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuara, mbetet shumë e kufizuar. Vendi ynë ende nuk ofron shërbime dhe programe të qëndrueshme parandaluese që janë më se të nevojshme marrë parasysh trendet në rritje të përdorimit të drogës nga fëmijët dhe adoleshentët. Vlerësohet se numri total i përdoruesve i ka kaluar për herë të parë 30 mijë përdorues, fëmijët dhe adoleshentët vazhdojnë të jenë çdo vit e më shumë pjesë e këtij numri përdoruesish. Moshë mesatare e fillimit të përdorimit të drogës ka rënë nga 18 vjeç në 2018 në 16 vjeç në periudhën e fundit. Megjithatë, Kosova nuk ka shërbime të veçanta rehabilitimi për fëmijët viktimë të abuzimit me drogë. Kërkesat e fëmijëve për shërbime të shëndetit mendor janë shtuar, veçanërisht që nga pandemia Covid-19. Vdekshmëria foshnjore në Kosovë, edhe pse është ulur me kalimin e viteve, është ende më e larta në krahasim me vendet e rajonit.<sup>318</sup>

**241.** Sipas një analize të bërë nga KIKS Kosova (KLAN), rastet e delikuecës në Kosovë kanë qenë në rritje me një numër në rritje të incidenteve të raportuara në Policinë e Kosovës.<sup>319</sup> Trendi vjetor dëshmon si më poshtë: Në vitin 2021 janë raportuar gjithsej 1,658 raste, në vitin 2022 janë 1,886 raste, ndërsa në vitin 2023 rreth 2,000 raste.<sup>320</sup> Sipas të njëjtit raport të Klan Kosovës, 17-vjeçarët kryesojnë me numrin më të madh të veprave penale që sipas Policisë së Kosovës janë kryesisht

315 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 38.

316 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 38.

317 KOMF (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

318 KOMF (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

319 KIKS Kosova (2023), [Rriten rastet e delikuecës te të miturit](#).

320 Telegraf (2024), [Gjatë 2023-ës rreth 2.000 raste për vepra të ndryshme penale nga të miturit në Kosovë](#)

“lëndim i lehtë trupor”.<sup>321</sup> Sipas KIKS Kosova, këto statistika mund të jenë tregues i një trendi të ri shqetësues që kërkon vëmendje të kujdesshme dhe strategji të intervenimit.

**242.** Në dhjetor të vitit 2023, Qeveria e Kosovës ndau mjete për shtesa të njehershme në vlerë prej 100 euro për fëmijët dhe pensionistët.<sup>322</sup> Ky vendim nënkupton një lëvizje strategjike për zbatimin e masës 3.5, që trajton shtesat për familjet me fëmijë, dhe masës 3.2 me fokus mbështetjen e pensionistëve dhe familjeve me ndihmë sociale. Këto masa janë komponente integrale të Pakos gjithëpërfshirëse të Ringjalljes Ekonomike.

**243.** Sistemi i shërbimeve sociale në Kosovë vazhdon të jetë i mbingarkuar, i financuar dobët dhe i paaftë për të përballuar kërkesat në rritje të njerëzve në nevojë dhe grupeve të cenueshme. Miratimi i Ligjit të ri për Shërbimet Sociale dhe Familjare i mbështetur fuqishëm nga OJQ KOMF, hap procesin e reformës së shërbimeve sociale në vend. Sfida kryesore në fushën e shërbimeve sociale mbetet financimi i paqëndrueshëm, duke rrezikuar kështu mbylljen apo uljen e cilësisë së shumë shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë.<sup>323</sup> Fëmijët vazhdojnë të mbeten jashtë llogarive; barazia për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga pakicat etnike, fëmijët që rriten në zonat rurale, nënat e mitura dhe fëmijët që punojnë (fëmijë që kontribuojnë në të hyrat e familjes) mbetet një shqetësim i madh. Financimi për OJQ-të e licencuara për të ofruar shërbime sigurohet nga burimet dhe përqindjet e mëposhtme të fondeve: 11 përqind nga buxhetet e komunave; 20 përqind nga buxheti i Kosovës, 55.5 përqind nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe lokalë dhe pjesa tjetër nga burime të tjera fondesh.<sup>324</sup> 75 përqind e përfituesve marrin shërbime vetëm nga OJQ të licencuara si ofrues të shërbimeve sociale joformale në mbarë Kosovën.<sup>325</sup>

**244.** Qendrat për Punë Sociale në mbarë Kosovën përballen me një sërë sfidash. Kjo vlen veçanërisht në lidhje me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare që mund t’i adresojnë nevojat sociale të fëmijëve në situata të cenueshme. Kjo për shkak se Kosova vazhdon të ketë një sistem të decentralizuar të shërbimeve sociale. Në këtë drejtim, është e nevojshme të merret në konsideratë centralizimi i ofrimit të shërbimeve sociale pasi është dëshmuar të jetë një model më i suksesshëm për zbatimin dhe financimin adekuat në vendet evropiane. Në këtë drejtim, shërbimet sociale nuk kanë qenë prioritet i qeverisjes lokale.<sup>326</sup> Sipas “Analizës për gjendjen e Qendrave për Punë Sociale”, të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë dhe OJQ KOMF, më shumë se gjysma e Qendrave për Punë Sociale kanë qasje të vështirë ose të pamundur për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara. Qendrave për Punë Sociale u mungon personeli profesional i specializuar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Përfaqësimi i profesioneve është i pabalancuar, janë kryesisht juristë, pasuar nga sociologë, pedagogë, psikologë dhe punëtorë socialë. Gjithashtu, Qendrat për Punë Sociale janë të mbingarkuara me raste, me një mesatare prej 85 rastesh për një ofrues të shërbimeve sociale. Vetëm 28 përqind e Qendrave për Punë Sociale kanë kushte relativisht të mira infrastrukturore,

321 KIKS Kosova (2023), [Rriten rastet e delikuençës te të miturit](#).

322 Paparaci (2023), [Qeveria merr këtë vendim për shtesat 100 euro për fëmijët dhe pensionistët](#).

323 KOMF (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

324 Save the Children Kosova / (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

325 Save the Children Kosova (2024), vlerësimi përfundimtar i projektit ‘Forcimi i Ofrimit të Shërbimeve Sociale për Grupet e Cenueshme në Kosovë, në Përgjigje ndaj COVID-19’ (2023).

326 Save the Children Kosova (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

ndërsa pjesa tjetër ofrojnë shërbime në hapësira të papërshtatshme pune.<sup>327</sup> Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (neni 15) pohon se çdo Qendër për Punë Sociale do të caktojë së paku një zyrtar përkatës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe intervenimet për mbrojtjen e fëmijëve, edhe pse në praktikë vetëm katër Qendra për Punë Sociale kanë emëruar një punëtor të specializuar për mbrojtjen e fëmijëve me mbështetjen e OShC-ve. Nisur nga këto sfida, Qeveria e Kosovës i vendosi Qendrat për Punë Sociale nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë (MD) në janar 2023.<sup>328</sup> MD-ja, e mandatuar nga Qeveria e Kosovës për mbrojtjen sociale duke filluar nga viti 2023, ka rritur fondet për OJQ-të e licencuara në një shumë maksimale prej 1.5 milion euro. Sipas Save the Children Kosova, ky investim i shtuar kontribuon në rritjen e fondeve për 35 nga 47 OJQ-të e licencuara. Përkundër këtij zhvillimi pozitiv, skema aktuale e financimit nuk është e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat e vajzave, djemve, grave dhe burrave që jetojnë në situata të cënueshme në mbarë vendin.<sup>329</sup>

**245.** Është e domosdoshme të nënvizohet ndryshimi i rëndësishëm në mandatin për politikat sociale dhe familjare në vitin 2023, duke kaluar nga kompetenca e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në atë të MD-së. Gjatë gjithë vitit 2023, ka ndodhur një ristrukturim dhe riorganizim gjithëpërfshirës i sistemit të mbrojtjes sociale, duke përfshirë të gjitha aspektet – nga formulimi i politikave qendrore dhe mbikëqyrja e zbatimit deri te planifikimi, menaxhimi dhe ofrimi i shërbimeve komunale. Ky proces i ndërlikuar ka sjellë ndarjen e Divizionit/Departamentit për Politika Sociale dhe Familjen ndërmjet dy ministrive: Ministrisë së Financave të Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Ministrisë së Drejtësisë (MD). Veçanërisht, Departamenti për Politika Sociale dhe Familjen është integruar në mënyrë strategjike në të dyja ministritë, duke nënvizuar një qasje bashkëpunuese për menaxhimin e politikave sociale dhe familjen. Brenda këtij transformimi dinamik, Skema e Ndhmës Sociale ruan pozicionin e saj nën juridiksionin e Ministrisë së Financave të Punës dhe Transfereve (MFPT), e cila merr përgjegjësinë për menaxhimin e përpiktë dhe monitorimin e saj vigjilent. E parashikuar të ndikojë në të gjitha dimensionet e qeverisjes, kjo iniciativë ristrukturimi është gati të ushtrojë një ndikim të thellë, duke u shtrirë nga politikëbërja e nivelit qendror dhe mbikëqyrja e përpiktë e zbatimit deri në planifikimin, menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve në nivel komunal.<sup>330</sup>

**246.** Numri i fëmijëve që jetojnë në varfëri në Kosovë mbetet alarmant me skema të ndihmës sociale të pamjatuashme për ta përmbushur kërkesën e shtuar në ofrimin e qasjes në shërbimet themelore.<sup>331</sup> Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 22.7 përqind e fëmijëve jetojnë në varfëri dhe 7 përqind e tyre jetojnë në varfëri të skajshme. OJQ KOMF thekson se sistemi aktual i mbrojtjes sociale në Kosovë nuk i adreson mjaftueshëm nevojat e ndryshme të fëmijëve dhe familjeve në nevojë. Transferet sociale kanë ndikim shumë të kufizuar në uljen e varfërisë, duke rezultuar në shkallë të lartë të varfërisë së fëmijëve në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Ligji Nr. 2003/15 për Ndhmë Sociale përmban një sërë kriteresh diskriminuese që përjashtojnë një numër të konsiderueshëm të fëmijëve dhe familjeve nga skema e ndihmës sociale. Kështu, procesi i rishikimit të legjisllacionit të ndihmës sociale pritet të eliminojë kriteret diskriminuese për fëmijët dhe të rrisë përfshirjen e fëmijëve dhe familjeve që jetojnë në varfëri. Projektligji për financimin e qeverisjes lokale, i cili është finalizuar vite më parë dhe pritet të krijojë

327 KOMF dhe Ministria e drejtësisë (MD, 2023) [Analizë e gjendjes aktuale të Qendrave për Punë Sociale në vitin 2023](#).

328 Kosovo 2.0, [Ky janë Qendrat për Punë Sociale?](#)

329 Save the Children Kosova / (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

330 Terres des Hommes Kosova (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

331 Kosovo 2.0, [Të varfër që ndihmojnë të varfër](#).



një Grant Specifik për Shërbimet Sociale për të rregulluar financimin e qëndrueshëm të shërbimeve sociale, nuk është miratuar ende. Procesi i kostimit dhe formulës së financimit të shërbimeve sociale, i nisur vite më parë, ende nuk ka përfunduar.<sup>332</sup> Një zhvillim pozitiv ka qenë miratimi i shtesave të fëmijëve si një instrument efektiv për zbutjen e varfërisë dhe pabarazisë mes fëmijëve. Megjithatë, shumat e përfitimeve të fëmijëve prej 20 euro (0-24 muajsh) dhe 10 euro (mbi 2 vjeç), nuk mjaftojnë për të kontribuar në zbutjen e varfërisë. Shuma e ulët është e kufizuar për fëmijët deri në 16 vjeç, duke përjashtuar kështu fëmijët nga mosha 16 deri në 18 vjeç.<sup>333</sup> Sipas legjislacionit të Kosovës, përkufizimi i fëmijëve përfshin moshat nga 0 deri në 18 vjeç, prandaj, përfitimet e fëmijëve duhet të mbulojnë fëmijët deri në 18 vjeç. Të dhënat e OJQ KOMF tregojnë se përfitimet e fëmijëve nuk kanë bazë ligjore të qëndrueshme, ato ofrohen vetëm në bazë të një vendimi në kuadër të paketës emergjente nga periudha e Covid-19.<sup>334</sup>

**247.** Përveç kësaj, shfrytëzimi i fëmijëve përmes punës së fëmijëve dhe lëmoshës ka vazhduar të ndodhë në vitin 2023. Sipas Komisionit Evropian, rreth 9 përqind e fëmijëve janë të përfshirë në punë, prej të cilëve 5.6 përqind punojnë në kushte të rrezikshme.<sup>335</sup> Në lidhje me kërkimin e lëmoshës prej fëmijëve, vërehet një rënie. Krahasuar me raportet e mëparshme (2021 dhe 2022), ka një rënie të numrit të përgjithshëm të fëmijëve lypës. Krahasuar me vitin 2022 (175 fëmijë) kundrejt vitit 2021 (191 fëmijë), në vitin 2023 janë identifikuar gjithsej 34 fëmijë.<sup>336</sup> Është e paqartë se pse rastet e identifikuara janë krahasimisht më të ulëta se në vitet e kaluara, veçanërisht pasi Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë ndonjë iniciativë serioze institucionale për të adresuar çështjen e lypjes së fëmijëve në Kosovë. Përkundrazi, përpjekjet institucionale janë fokusuar në zgjidhje ad-hoc pa ofruar plane konkrete dhe afatgjata.<sup>337</sup>

**248.** Fëmijët nga komunitetet jo-shumicë janë fëmijët në pozitën më të cenueshme në aspektin social, ekonomik dhe kulturor. Pabarazitë në lidhje me qasjen në kujdesin bazë shëndetësor, arsim dhe kulturë mbeten të përhapura, pjesërisht pasi komunitetet rom dhe ashkali janë të diskriminuar vazhdimisht. Krahasuar me komunitetet tjera, shkalla e imunizimit në mesin e komuniteteve rom dhe ashkali është veçanërisht e ulët.<sup>338</sup> Institucionet publike nuk kanë bërë progres të mjaftueshëm përtej përcaktimeve legjislative drejt aktiviteteve sociale dhe programeve të gjithëpërfshirjes.<sup>339</sup> Sipas një raporti të fundit të kryer nga Save the Children Kosova (2023), ekziston gjithashtu një mungesë sistematike e mekanizmave për mbledhje të të dhënave, çka pengon punën e qendrave për punë sociale për të identifikuar dhe ofruar shërbime adekuata sociale për fëmijët në situata të cenueshme.<sup>340</sup>

332 Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

333 Kosovo 2.0, [Të varfër që ndihmojnë të varfër](#).

334 KOMF (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

335 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 101.

336 Dukagjini (2023), [bie numri i fëmijëve lëmoshkërkues](#).

337 Kosova Press (2022), [175 fëmijë lypës të identifikuar në Kosovë](#).

338 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 95.

339 Kosovo 2.0, [Të varfër që ndihmojnë të varfër](#).

340 Save the Children Kosova (2023), [Mbledhja dhe analiza e të dhënave dhe statistikave për grupet e cenueshme që përfitojnë nga shërbimet sociale në Kosovë](#).

**249.** Fëmijët romë kanë një disavantazh të hershëm në fillimin e tyre të jetës në krahasim me fëmijë me prejardhje të tjera etnike.<sup>341</sup> Kjo është veçanërisht e vërtetë kur shqyrtohet mjedisi familjar, siç raportohet nga Save the Children Kosova. Sipas të dhënave që ata japin, 72 përqind e fëmijëve deri në moshën 14 vjeç kanë pësuar forma të dhunës psikologjike dhe fizike brenda familjes. Në veçanti, fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me rrezik më të lartë për keqtrajtim fizik dhe emocional dhe forma të tjera të neglizhencës, dhunës dhe shfrytëzimit për shkak të diskriminimit dhe përjashtimit.<sup>342</sup>

**250.** Fenomeni i martesave të hershme vazhdon të jetë i përhapur dhe ndikon në jetën dhe edukimin e fëmijëve në Kosovë. Bazuar në raporte të besueshme ndërkombëtare, OJQ VoRAE thekson se 1 në 25 vajza dhe 1 në 50 djem (20-24 vjeç) janë martuar para moshës 18 vjeç. Nga të dhënat e mbledhura gjatë vizitave në terren të OJQ VoRAE, martesat e hershme vazhdojnë të jenë një çështje problematike me të cilën shoqëria jonë vazhdon të përballlet dhe kjo kërkon intervenime. Rrjedhimisht, OJQ VoRAE ka iniciuar një fushatë vetëdijesimi për të parandaluar martesat e hershme, jo vetëm për qytetarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.<sup>343</sup> Në dhjetor të vitit 2023 është nënshkruar vendimi për themelimin e grupit punues ndërinstitucional për parandalimin dhe raportimin e martesave të hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës.<sup>344</sup>

**251.** Fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe që kanë nevojë për kujdes të veçantë shpesh u privohet qasja e duhur në objektet shëndetësore dhe arsimore, si dhe ndihma e nevojshme për të ndjekur arsimin gjithëpërfshirës.<sup>345</sup> Shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara mbeten jashtë sistemit arsimor të Kosovës. Përkundër disa përparimeve pozitive të ndërmarra nga MASHTI në vitin 2023 (shih pjesën 6.2), Qeveria e Kosovës duhet ta rrisë më tej mbështetjen e saj financiare dhe shërbimet sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara.

## 252. Rekomandime

- Autoritetet publike duhet të zbatojnë Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, të ofrojnë trajnime për profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve për dispozitat e tij, si dhe të përshpejtojnë miratimin e Udhëzimeve Administrative të mbetura;
- MASHTI duhet të adresojë frekuentimin alarmant të ulët të edukimit parashkollor në Kosovë duke zbatuar Ligjin për Edukim në Fëmijërinë e Hershme, duke theksuar qendrat me bazë komunitare për të rritur qasjen;
- Duhet të forcohen mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve, siç parashihet në Ligjin për mbrojtjen e fëmijës;
- Autoritetet publike duhet të adresojnë rritjen e delikuencës së të miturve duke monitoruar nga afër rastet, duke zbatuar masa parandaluese dhe duke marrë parasysh strategjitë shtesë për intervenime bazuar në tendencat e identifikuara;

341 REYN (2022), [Thyerja e heshtjes. E drejta për lulëzim e fëmijëve të vegjël romë në Evropë](#).

342 Save the Children Kosova (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

343 VORAE (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

344 VORAE (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

345 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të adresojë mangësitë në skemat e ndihmës sociale, duke siguruar mbulim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe familjet në nevojë, si dhe të rishqyrtojë kriteret diskriminuese në Ligjin për Ndihmën Sociale;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të trajtojë shfrytëzimin e fëmijëve nëpërmjet punës së fëmijëve dhe lypjes, duke zbatuar nisma të targetuara dhe plane afatgjata për ta adresuar këtë çështje kritike;
- Komunat duhet të marrin përgjegjësinë për adresimin e pabarazive të rëndësishme me të cilat ballafaqohen fëmijët nga komunitetet jo-shumicë, duke përmirësuar qasjen në kujdes shëndetësor, arsim dhe mundësi kulturore;
- Shërbimet sociale duhet të fokusohen në intervenime dhe mbështetje të hershme për fëmijët romë, duke njohur cenueshmërinë e tyre dhe duke zbatuar masa për t'i mbrojtur ata nga dhuna dhe diskriminimi;
- Autoritetet publike duhet të adresojnë çështjen e përhapur të martesave të hershme duke rritur ndërgjegjësimin dhe zbatimin e masave parandaluese, duke përfshirë të gjitha komunitetet në Kosovë;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministrinë e Shëndetësisë, duhet të rrisin përpjekjet për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje të përshtatshme në objektet shëndetësore dhe arsimore, arsimin gjithëpërfshirës dhe ndihmën e nevojshme, duke rritur mbështetjen financiare dhe shërbimet sociale.

### 7.3 Të drejtat e të rinjve

**253.** Kushtetuta e Kosovës nuk i përmend të rinjtë dhe të drejtat e tyre në tekst. Ajo vetëm përcakton të drejtën për të votuar si në zgjedhjet lokale ashtu edhe në ato të përgjithshme nga moshë 18 vjeç. Korniza legjislative e Kosovës përcakton “rininë” në Ligjin Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë (neni 3 1.1) si: “grupmosha e të rinjve ndërmjet pesëmbëdhjetë (15) dhe njëzet e katër (24) vjeç”.<sup>346</sup> Veçanërisht, kjo kategori moshe përfaqëson një segment të madh të përbërjes demografike pasi 35 përqind e popullsisë së përgjithshme të Kosovës është ndërmjet moshës 15 dhe 24 vjeç.<sup>347</sup> Duke pasur parasysh këtë, Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë luan rol kyç në sigurimin e “[...] pjesëmarrjes së vazhdueshme të të rinjve [...] në zhvillimin e një shoqërie demokratike”.<sup>348</sup> Në nëntor të vitit 2023 u miratua Projektligji për Rininë, i cili është “reforma e parë e kornizës ligjore” në fushën e rinisë nga Qeveria e Kosovës me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve dhe cilësinë e përgjithshme të jetës së tyre në Kosovë.<sup>349</sup>

346 Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë [LIGJI NR. 03/L-145 PËR FUQIZIM DHE PJESËMARRJE TË RINISË \(rks-gov.net\)](#)

347 YIHR YIHR (2024), inpute për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

348 YIHR KS (2022), inpute për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

349 Zyra e Kryeministrit (2023), [Mbledhja e 174<sup>a</sup> e QK-së](#).

**254.** Në vitin 2023, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) ka hartuar një strategji të re për Rininë, e cila është në përputhje me Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë. Sipas strategjisë, Qeveria e Kosovës do të angazhohet më tej për fuqizimin e nevojave të individëve të Kosovës duke siguruar realizimin e nevojave, të drejtave dhe potencialit njerëzor të tyre. Duke mbuluar periudhën 2024-2032, ajo synon të integrojë të rinjtë në shoqëri dhe t'i fuqizojë ata si kontribues në një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Objektivat kryesore të strategjisë përfshijnë zhvillimin dhe koordinimin e politikave për rininë në nivel qendror. I shoqëruar nga tre plane veprimi, plani strategjik fokusohet në edukimin, punësimin, shëndetin dhe angazhimin kulturor të individëve të rinj në Kosovë ndërmjet moshës 15 dhe 29 vjeç.<sup>350</sup> Komisioni Shtetëror për Rininë u emërua në gusht 2021. I përbërë nga 8 ministri, qëllimi i tij kryesor është të nxisë bashkëpunimin ndërinstitucional, të zhvilloj politika horizontale për fuqizimin e të rinjve dhe të rishikojë legjislacionin aktual. Komisioni Shtetëror për Rininë ishte gjithashtu përgjegjës për hartimin e Strategjisë së re për Rininë.

**255.** Mekanizmat institucionalë të ngarkuar me zhvillimin e politikave dhe programeve rinore janë në kuadër të Departamentit të Rinisë në MKRS-së. Ndërsa ligji mbikëqyr edhe organizimin vullnetar të Këshillit Qendror të Veprimit Rinor (KQVR), asnjë Këshill i tillë nuk ka funksionuar prej vitit 2018. Përgjegjësitë themelore u janë caktuar edhe institucioneve qendrore dhe komunale për të forcuar sektorin e rinisë në Kosovë duke mbikëqyrur Programet Rinore dhe Qendrat Rinore. Portali zyrtar i Qeverisë së Kosovës raporton gjithsej 150 organizata rinore të ndara në 100 rrjete dhe 50 qendra.<sup>351</sup>

**256.** Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS) paraqet inpute jetike për Strategjinë e re Shtetërore për Rininë 2024-2032 dhe Planin e Veprimit shoqëruar të saj. Strategjia, e cila nënvizon domosdoshmërinë e forcimit të mekanizmave për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, duke theksuar transparencën dhe gjithëpërfshirjen për komunitetet jo-shumicë, veçanërisht në zonat rurale, duhet të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë, me një strategji gjithëpërfshirëse të kontaktimit që targeton komunitetet jo-shumicë, si dhe mekanizma të fuqishëm monitorimi. Po ashtu, strategjia synon t'i pajisë të rinjtë me shkathtësitë e jetës nëpërmjet edukimit formal. YIHR KS propozon integrimin e dialogut ndëretnik, bashkëjetesës multikulturore dhe pajtimit në materialet e mësimdhënësve, me fokus të veçantë në nxitjen e marrëdhënieve ndëretnike mes komuniteteve serbe dhe shqiptare. Ky integrim duhet të zbatohet në mënyrë aktive në kurrikulat shkollore. Për fund, YIHR KS sugjeron iniciimin e përfshirjes së vullnetarizmit si një mjet apo kurs i detyrueshëm në nivel lokal dhe shkollor, duke promovuar angazhimin aktiv dhe pjesëmarrjen e komunitetit. Këto propozime përputhen me qëllimin kryesor për të nxitur një jetë të suksesshme dhe të begatë për rininë e Kosovës në vitet e ardhshme.<sup>352</sup>

**257.** Kosova është anëtarësuar në EYCA (European Youth Card Association), një organizatë ndërkombëtare me seli në Bruksel që lëshon Kartën Evropiane të Rinisë në mbi 30 vende evropiane. Pas një aplikimi të suksesshëm nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, qeveria do ta ofrojë falas kartën për të gjithë të rinjtë nën moshën 30 vjeç, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, aftësitë apo statusi social-ekonomik. Karta digjitale, e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës, ofron qasje në mbi 60,000 zbritje dhe përfitime në mbarë Evropën në transport,

350 MKRS (2023), [Strategjia Shtetërore për Rininë \(2024-2033\)](#).

351 MKRS (2023), [Strategjia Shtetërore për Rininë \(2024-2033\)](#).

352 YIHR (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

akomodim, kulturë, sport, arsim, shërbime dhe produkte. Qeveria planifikon të bashkëpunojë me sektorin publik dhe privat në Kosovë për të ofruar zbritje dhe përfitime për mbajtësit e kartave brenda vendit, të zbatueshme si për banorët ashtu edhe për vizitorët dhe turistët e huaj të rinj që vijnë në Kosovë. Nisma lidhet me rritjen e lëvizshmërisë së të rinjve në Evropë, të mbështetur nga masa të tilla si Young Cell Scheme, bursat e Ministrisë së Arsimit dhe grantet e mobilitetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duke ofruar mundësi të shumta për përvoja arsimore, konkurruese dhe profesionale për të rinjtë në Kosovë. Të pajisur me kartë, të rinjtë e Kosovës do të gëzojnë mundësi dhe përfitime të barabarta krahas bashkëmohatarëve të tyre evropianë.<sup>353</sup>

**258.** Papunësia tek të rinjtë mbetet një problem me pasoja të konsiderueshme në shkallë të gjerë për zhvillimin social-ekonomik të rajonit me shkallë të punësimit prej vetëm 20.4 përqind.<sup>354</sup> YIHR KS thekson se papunësia e të rinjve është dukshëm e përhapur në mesin e atyre me prindër me formim më të ulët arsimor, me origjinë nga familje të pafavorizuara ekonomikisht, dhe kryesisht të vendosura në zonat rurale. Veçanërisht, ndikimi i lidhjeve shoqërore dhe njohja me figura me ndikim, luan një rol kryesor në formësimin e statusit shoqëror të një individi, me 54-59 përqind që e pranojnë rëndësinë e saj për sigurimin e mundësive të punësimit.<sup>355</sup>

**259.** Gjithnjë e më shumë, të rinjtë e Kosovës po largohen nga Kosova për në Evropën Perëndimore në kërkim të standardeve më të mira të jetesës. Kjo është e nxitur kryesisht nga kushtet jo të mira ekonomike dhe të punësimit brenda Kosovës. Mungesa e mekanizmave rregullatorë dhe kushtet socio-ekonomike të nxitura nga privatët kanë krijuar një perceptim tek brezi i ri se rritja financiare dhe ekonomike është e kufizuar. Edhe pse paga minimale është rritur me Ligjin e ri për Pagat Minimale, të rinjtë e Kosovës janë të pakënaqur me mundësitë e kufizuara ekonomike. Hendeku i një fuqie punëtore aktive plotësohet gjithnjë e më shumë nga shtetas të huaj, kryesisht nga Azia, siç theksohet në pjesën për të drejtat e punës.<sup>356</sup>

**260.** Sipas raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, Plani i Zbatimit të Garancisë për Rininë, i miratuar fillimisht në vitin 2022, është duke u forcuar në vitin 2023 me Qeverinë e Kosovës të angazhuar për krijimin e kushteve të nevojshme për pilotimin e Garancisë për Rininë në dy komuna. Në këtë aspekt, Kosova është në proces të ristrukturimit të agjencisë së punësimit, një hap vendimtar në përmbushjen e planit të zbatimit të Garancisë për Rininë.<sup>357</sup>

**261.** Në përputhje me Pakon e Ringjalljes Ekonomike në të cilin Qeveria e Kosovës u garantoj të rinjve “punën e parë, të subvencionuar nga shteti në nivelin e pagës minimale,”<sup>358</sup> Qeveria e Kosovës lansoi platformën “Superpuna”, një nismë kyçe që synon adresimin e papunësisë së të rinjve dhe nxitjen e rritjes ekonomike. Platforma e menaxhuar nga Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve (MFPT) premton një subvencion prej 264 eurosh mbi pagën minimale për gjashtë muajt e parë të punësimit. Edhe pse sipas MFPT-së, caku ishte punësimi i rreth 10,000 të rinjve nga

353 MKRS (2024), [tashmë zyrtare: Kosova anëtare në EYCA - European Youth Card Association](#).

354 ASK (2024), [Tregu i punës](#).

355 YIHR (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

356 Lajm Press (2023), [Të rinjtë po braktisin Kosovën, emigrimi në shifra të larta](#).

357 ASK (2024), [papunësia në Kosovë](#).

358 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (2021), [Paketa për Rimëkëmbjen Ekonomike](#).

19 deri në 25 vjeç brenda vitit inaugurues, ende nuk është përcaktuar nëse ky synim është arritur. Në javën e parë të lansimit së saj, në shkurt, u dorëzuan 1,000 aplikime.<sup>359</sup> Platforma është krijuar për ndërveprim të thjeshtë mes bizneseve dhe punëkërkuessve dhe u ofron bizneseve mundësinë për ta dyfishuar pagën minimale. Megjithatë, mbetet për t'u shqyrtuar deri në çfarë mase platforma do të ilustrojë suksesin afatgjatë në fushat e përfshirjes dhe diversitetit.

## 262. Rekomandime

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve duhet të sigurojë zbatimin efektiv të Strategjisë së re për Rininë (2024-2032) dhe planin e veprimit të saj duke integruar një mekanizëm monitorimi të jashtëm;
- Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve duhet të ringjallë Këshillin Qendror të Veprimit Rinor (KQVR) ose të formojë një mekanizëm alternativ që angazhohet në mënyrë aktive dhe transparente në proceset vendimmarrëse dhe përmirëson koordinimin e programeve dhe qendrave rinore;
- Duhet të zhvillohen politika transparente dhe gjithëpërfshirëse për komunitetet jo-shumicë dhe të përfshihen në Strategjinë e re Shtetërore për Rininë 2024-2032 për të nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive;
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj strategji informimi që duhet zbatohet për të siguruar që të gjithë të rinjtë e pranueshëm në Kosovë të jenë të vetëdijshëm dhe të shfrytëzojnë përfitimet e ofruara nga Karta Evropiane për Rininë;
- Qeveria e Kosovës duhet të zbatojë politika të targetuara dhe të adresojë faktorët që çojnë në largimin e të rinjve kosovarë me strategji dhe veprime që reduktojnë papunësinë e të rinjve dhe mbajnë rininë kosovare;
- Qeveria e Kosovës duhet të vlerësojë dhe forcojë nga jashtë efektivitetin e platformës Superpuna, duke u siguruar që ajo të përmbushë cakun e saj për punësimin e të rinjve dhe të kontribuoj në uljen e papunësisë së të rinjve;
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvilloj dhe zbatojë programe gjithëpërfshirëse të mbështetjes së shëndetit mendor në shkolla dhe qytete duke siguruar që informacioni rreth shërbimeve të disponueshme të shpërndahet gjerësisht tek të rinjtë.

## 7.4 Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

**263.** Korniza legjislativë mbi të cilën bazohet vlerësimi i situatës së zbatimit të të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë përbëhet nga Kushtetuta së bashku me ligje dhe rregullore të shumta në të cilat referencë specifike i bëhet këtij segmenti të popullsisë. Pjesë e kornizës legjislativë përmes së cilës mbrohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është Ligji Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Ligji Nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershëm. Dy ligje të tjera

359 Albinfo (2023), [Kosovë: 1000 aplikime në platformën 'Superpuna'](#)

që mbështesin persona specifik me aftësi të kufizuara janë Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër. Një pjesë e kornizës ligjore të Kosovës pasqyron Konventën e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK), por ajo ende nuk është inkorporuar në Kushtetutë si instrument ndërkombëtar i të drejtave të njeriut drejtpërdrejt i zbatueshëm sipas nenit 22. Kosova gjithashtu ka miratuar një vizion gjithëpërfshirës të përqendruar në promovimin e të drejtave dhe kushteve të këtij komuniteti dhe objekteve të tij në Strategjinë e saj për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2023). Edhe pse Zyra për Qeverisje të Mirë ka zhvilluar një strategji të re duke filluar me periudhën e vitit 2024, ajo ende mbetet për t'u miratuar.

**264.** Legjislacioni i Kosovës bazohet në mënyrë të nënkuptuar në instrumentet evropiane të të drejtave të njeriut, por i mungon harmonizimi i formuluar siç duhet dhe i qartë. Në nenin 22 të Kushtetutës, një sërë instrumentesh kyçe për të drejtat e njeriut shërbejnë si bazë për ligjet dhe rregulloret vendore, por KDKPAK nuk përfshihet. Sipas OJQ HANDIKOS (2023), përfshirja e KDKPAK-së është thelbësore nëse synohet arritja e parakushteve themelore që personat me aftësi të kufizuara të bëjnë një jetë normale dhe dinjitoze. Pas përpjekjeve dhe kërkesave të vazhdueshme të HANDIKOS-it për inkorporimin e KDKPAK-së, Qeveria e Kosovës mbajti një mbledhje më 13 dhjetor 2022 dhe më pas nxori Vendimin Nr. 02/112 me propozimin për ndryshimin e Kushtetutës drejtuar KK-së.<sup>360</sup>

**265.** Lidhur me paragrafin paraprak, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nxorri një vendim (Lënda KO 207/22) për pajtueshmërinë e amendamentit të propozuar kushtetues për ta shtuar KDKPAK-në në listën e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë. Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe njëzëri vendosi se amendamenti i propozuar nuk i pakëson të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës. Vendimi theksoi parimet e Konventës së OKB-së, duke theksuar të drejtat që lidhen me dinjitetin, autonominë, mosdiskriminimin, pjesëmarrjen e plotë dhe detyrimet pozitive për zbatim.<sup>361</sup> Në tetor të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës ka tentuar të ndryshojë Kushtetutën për të përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara në nenin 22, por për arsye politike, ndryshimi nuk ka mundur të bëhet sepse anëtarët e Kuvendit të Kosovës nga radhët e serbëve të Kosovës nuk ishin të pranishëm për të votuar për këto ndryshime.<sup>362</sup>

**266.** Mekanizmat institucionalë të ngarkuar me sigurimin e përshtatjes ndërmjet politikave dhe praktikës janë në kuadër të përgjegjësive të Këshillit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK). Ndonëse fillimisht ishte dizajnuar për të bashkëpunuar me Organizatat relevante të Shoqërisë Civile (OSHC), KKPAK-u përjetoi një periudhë pasiviteti nga 2018 deri në 2023. Marrë parasysh rolin e tij kryesor në formësimin e politikave institucionale që synojnë përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të komunitetit me aftësi të kufizuara, statusi i KKPAK-ut u adresua sërish në vitin 2021, duke çuar në rithemelimin e tij. Megjithatë, që nga rithemelimi i tij në vitin 2021, KKPAK-u ka zhvilluar vetëm dy mbledhje në vitin 2022, me një mbledhje të vetme të dokumentuar në vitin 2023 (edhe pse duhej të ishin mbajtur dy takime në përputhje me politikën).<sup>363</sup>

360 HANDIKOS (2022), inute për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

361 Gjykata Kushtetuese (2023), [Njoftim për vendim në rastin KO 207/22](#).

362 HANDIKOS (2023), inute për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

363 HANDIKOS (2023), inute për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**267.** Lidhja e dobët ndërmjet politikës dhe praktikës përkthehet pjesërisht në diskriminim të vazhdueshëm dhe mungesë të kujdesit institucional dhe ndërgjegjësimit shoqëror në popullatën e përgjithshme.<sup>364</sup> Sipas OJQ HANDIKOS, diskriminimi në kornizën shoqërore të Kosovës manifestohet në tri dimensione të rëndësishme. Paragjykimet nga publiku i gjerë luajnë rol kryesorë në përjashtimin e komunitetit nga sfera publike. Sfidat e vazhdueshme infrastrukturore, të cilat pengojnë qasjen e individëve me aftësi të kufizuara në ndërtesat publike, shkollat, objektet mjekësore dhe transport, duke i vështirësuar rrethanat tashmë sfiduese për këtë grup demografik në Kosovë. Përkundër direktivave administrative që sigurojnë qasje në hapësirat publike, mjedisi i ndërtuar nuk kujdeset në mënyrë adekuate për individët me aftësi të kufizuara, duke e minuar kështu aftësinë e tyre për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri në baza të barabarta.<sup>365</sup>

**268.** Qasja është një komponent përbërës i çdo mjedisi gjithëpërfshirës që merr parasysh pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Një vlerësim i situatës së infrastrukturës së Kosovës tregon se infrastruktura fizike jo vetëm është jo-adekuate për personat me aftësi të kufizuara, por në fakt edhe e rrezikshme. Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Ndërtesave për qasjen e personave me aftësi të kufizuar shpërfillet vazhdimisht dhe haptazi, duke sjellë një ndjenjë diskriminimi në komunitet.<sup>366</sup> Për më tepër, në vitin 2022, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka dërguar njoftimin zyrtar Nr. 4159/22 për të gjitha komunat që të avancojnë zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ. Në janar 2023, Gjykatat Themelore në Mitrovicë dhe Ferizaj morën fonde nga USAID-i në Kosovë për të instaluar trotuare prekëse që përmirësojnë orientimin e personave të verbër të cilët më parë duhej të vareshin nga ndihma fizike e individëve të tjerë për të hyrë në këto ndërtesa.<sup>367</sup>

**269.** Pikërisht për shkak të infrastrukturës, që prej vitit 2018 janë ngritur pesë padi ndaj institucioneve të ndryshme me 4 lëndë në pritje të shqyrtimit.<sup>368</sup> Rasti i përdoruesit të karrocës Faruk Kukaj është veçanërisht i rëndësishëm sepse ka rritur vetëdijësimin e përdoruesve të karrocave në Prishtinë. Z. Kukaj ngriti një padi kundër Komunës së Prishtinës për shkak të diskriminimit, duke deklaruar se komuna ofron në mënyrë jo-adekuate infrastrukturën bazë të nevojshme për përdoruesit e karrocave. Në vitin 2022, ai e fitoi pjesërisht rastin në Gjykatën Themelore të Prishtinës duke e detyruar komunën t'ia paguajë atij 5,500 euro dëmshpërblim jomaterial.<sup>369</sup> Daljet e tij publike jo vetëm që u kanë dhënë zë përdoruesve të karrocave dhe personave me aftësi të kufizuara, por kanë inkurajuar edhe njerëzit e tjerë që të kërkojnë zbatimin e të drejtave të tyre themelore të njeriut. Nga viti 2023, padia është në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës pasi që Komuna e Prishtinës e ka apeluar rastin dhe vendimi është në pritje.<sup>370</sup> Më tej, OJQ HANDIKOS thekson se një tjetër padi për mbrojtje nga diskriminimi është regjistruar në Gjykatën Themelore në vitin 2023, ku është paditur Kuvendi i Kosovës. Padiësi e ka lidhur rastin me trajtim çnjerëzor. Sipas OJQ BIRN, edhe pse shumë objekte publike janë ndërtuar apo rinovuar pas luftës së Kosovës, ato i kanë kaluar testet teknike pa i përmbushur të gjitha kushtet ligjore për krijimin e qasjes së barabartë për personat me aftësi të kufizuara. Në Universitetin e Prishtinës nuk

364 HANDIKOS (2023), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

365 HANDIKOS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

366 HANDIKOS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

367 USAID (2023), [Sigurimi i qasjes në gjykata për personat me aftësi të kufizuara](#).

368 HANDIKOS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

369 Prishtina Insight (2022), [Faruk Kukaj, njeriu i vitit për Prishtina Insight](#).

370 HANDIKOS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.



ka të punësuar me aftësi të kufizuara, pavarësisht se ligji kërkon që një në çdo 50 të punësuar të jetë person me aftësi të kufizuara. Nga 26 institucione, me 3,000 të punësuar, vetëm 10 të punësuar ishin persona me aftësi të kufizuara.<sup>371</sup>

**270.** Drejtësia si instrument për vendosjen e barazisë ligjore mbetet e paqasshme për personat me aftësi të kufizuara. Pjesërisht, kjo ka të bëjë me vetë ndërtesat institucionale të cilat nuk janë aspak të akomoduar për persona me aftësi të kufizuara. E njëjta gjë vlen për zyret e noterëve. Paradoksisht, Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2022 për tarifatat noteriale të kompensimit të punës dhe kompensimet e shpenzimeve të noterit, i liron personat me aftësi të kufizuara nga pagesa e disa shërbimeve noteriale. Megjithatë, duke qenë se shumica e zyrave të noterëve nuk mund të qasen nga përdoruesit e karrocave,<sup>372</sup> mjedisi material cenon mundësitë e tyre për ta ushtruar këtë të drejtë.

**271.** Ndonëse kanë rëndësi kryesore, sistemi i shëndetësisë dhe shërbimet sociale në nivel institucional nuk u përgjigjen nevojave bazë të personave me aftësi të kufizuara. Paradoksi nuk qendron vetëm në faktin se ata trajtohen në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese nga personeli shëndetësor. Veç kësaj, ka mungesë të mekanizmave që u ofrojnë personave me aftësi të kufizuara shërbime të menjëhershme të kujdesit shëndetësor. Si rrjedhojë, OJQ HANDIKOS veçon se personat me aftësi të kufizuara detyrohen t'i drejtohen qendrave mjekësore private ose jashtë vendit, gjë që ka pasoja të mëdha financiare.

**272.** Mungesa e një njësie spinale në spitalin shtetëror mund të ketë pasoja shkatërruese dhe nuk është zgjidhur në vitin 2023 dhe kështu vazhdon të paraqesë pasoja të rënda që mund të çojnë në lëndime të individëve të kufizuar në karroca. Edhe pse Qeveria e Kosovës kishte planifikuar themelimin e njësisë si pjesë e aktiviteteve për Vitin e Personave me Aftësi të Kufizuara, kjo ende nuk është konkretizuar.

**273.** Një zhvillim pozitiv sa i përket nevojave shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara është se në vitin 2022, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ për Mjetet Ndihmëse të parapara në Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Në vitin 2023, MSH-ja themeloi një Komision Vlerësues për këtë qëllim.<sup>373</sup> Udhëzimi Administrativ pritet të zbatohet në vitin 2024.<sup>374</sup>

**274.** Disavantazhi social i personave me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit shprehet në atë mënyrë që manifeston diskrepancën ndërmjet politikës dhe praktikës. Edhe pse sipas ligjit Kosova promovon një sistem arsimor gjithëpërfshirës, në realitet, vetëm 12 përqind e studentëve me aftësi të kufizuara janë të përfshirë. Sektori i arsimit paraqet një situatë alarmante me shumicën dërrmuese të fëmijëve me aftësi të kufizuara, pra 88 përqind të fëmijëve, të përjashtuar nga sistemi. Krahasuar me raportin e mëparshëm, shifrat e vlerësuara mbeten të njëjta. Në sistemin e arsimit të

371 BIRN (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

372 HANDIKOS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

373 HANDIKOS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

374 HANDIKOS (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

lartë vetëm 7 studentë vijojnë studimet në universitetin publik.<sup>375</sup> Institucionet private ende nuk e kanë bërë publike popullatën studentore me aftësi të kufizuara.

**275.** Një çështje tjetër me shqetësim të veçantë në sistemin arsimor gjithëpërfshirës ka të bëjë me numrin e pamjaftueshëm të asistentëve në dispozicion për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim, mund të vërehen dy zhvillime pozitive. E para është se MASHTI ka ndarë buxhet për 100 asistentë shtesë në vitin 2022 në arsimin fillor.<sup>376</sup> Kjo pason rekrutimin e 100 asistentëve në vitin 2021 dhe përkthehet në më shumë mbështetje për sistemin arsimor gjithëpërfshirës. Sipas MASHTI-t, në vitin 2023 Qeveria e Kosovës ka ndarë financim për 300 asistentë shtesë.<sup>377</sup> Një zhvillim i dytë pozitiv drejt një sistemi arsimor më gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara ka të bëjë me trajnimin e organizuar nga MASHTI për përfshirjen dhe trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.<sup>378</sup>

**276.** Personat me aftësi të kufizuara mbeten ndër komunitetet më të varfra socio-ekonomike në Kosovë.<sup>379</sup> Çështjet që dalin janë të shumëfishta dhe manifestohen në sfera të ndryshme socio-politike dhe ekonomike të shoqërisë kosovare. Së pari, ka një mosvazhdimësi të qartë midis legjislacionit për mundësitë e punësimit dhe zbatimit. Ligji Nr. 03/ L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin i cili garanton të drejtën e punësimit për personat me aftësi të kufizuara, nuk është zbatuar mjaftueshëm.<sup>380</sup> Në vitin 2023 hyri në fuqi edhe Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë duke i obliguar institucionet publike dhe ndërmarrjet tjera të domenit publik që të punësojnë persona me aftësi të kufizuara në përputhje me kuotën. Sipas OJQ HANDIKOS, Qeveria e Kosovës është në proces të përgatitjes së udhëzimit administrativ.<sup>381</sup>

**277.** Save the Children Kosova vëren se në bazë të kriterëve të legjislacionit aktual, të rinjve me aftësi të kufizuara u jepen vetëm certifikata të pjesëmarrjes, përveç nëse ata demonstronë aftësi në lexim, shkrim, matematikë bazë dhe përmbushin 75 përqind të kompetencave të trajnimit. Disponueshmëria e kufizuar e shërbimeve arsimore me cilësi të lartë për të rinjtë me aftësi të kufizuara, veçanërisht në arsimin universitar dhe pasuniversitar, është e lidhur ngushtë me qëndrimet diskriminuese të palëve të interesit institucional kundrejt aftësive të personave me aftësi të kufizuara për të fituar aftësi të adaptueshme dhe për të përmbushur nevojat aktuale të tregut të punës. Përveç kësaj, hulumtimi zbulon se bizneset në Kosovë raportojnë se u mungon përvoja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, kushtet e nevojshme të punës dhe akomodimi, si dhe perceptimet se shkathësitë e punës që ata kërkojnë nuk mund të zotërohen nga personat me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim, punëdhënësit shpesh shfaqin paragjykimet dhe diskriminimin e tyre të pavetëdijshëm ndaj potencialit të personave me aftësi të kufizuara për të kryer punën në mënyra efektive.<sup>382</sup>

375 HANDIKOS (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

376 HANDIKOS (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

377 MASHTI (2022), përgjigje email për RrDNj në lidhje me rekomandimet e raportit të mëparshëm të përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

378 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

379 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

380 HANDIKOS (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

381 HANDIKOS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

382 Save the Children Kosova / (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**278.** Në vend që të perceptohet si një imperativ i mandatuar nga dispozitat ligjore, përfshirja e individëve me aftësi të kufizuara në sektorin ekonomik varet nga vendimet personale të pronarëve të bizneseve. Një ilustrim shembullor në këtë kontekst është ndërmarrja “Freesia”, e cila gjendet në Lipjan dhe është e specializuar për prodhimin e letrës sanitare dhe pecetave. Kompania punëson ekskluzivisht individë me aftësi të kufizuara dhe si e tillë, ofron një shembull të rëndësishëm për kompanitë e tjera për të punësuar individë me aftësi të kufizuara. Përkundër kësaj, pronari i biznesit deklaroi se ka mungesë të konsiderueshme të mbështetjes institucionale duke theksuar se punësimi i qëndrueshëm i stafit të tij varet vetëm nga performanca e shitjes së produkteve Free-sia.<sup>383</sup>

**279.** Në kuadër të legjislacionit të Kosovës, Udhëzimi Administrativ për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara nuk zbatohet, duke rezultuar në përjashtim dhe diskriminim të vazhdueshëm.<sup>384</sup> Për më tepër, Qeveria e Kosovës ende nuk e ka aprovuar Projektligjin për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara. Po ashtu, në shkurt të vitit 2022, Qeveria e Kosovës nxorri Vendimin Nr. 221/2022, i cili obligon institucionet shtetërore që të arrijnë kuotën zyrtare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Në praktikë, OJQ HANDIKOS vëren se vetëm një numër i vogël i vendeve të lira të punës i janë drejtuar shprehimisht kësaj kategorie të të punësuarve për të aplikuar. Në realitet, individët me aftësi të kufizuara shpesh e gjejnë veten në disavantazh kur krahasohen me bashkëmoshatarët e tyre, pasi aftësia e kufizuar e tyre tenton të ndikojë negativisht në mundësitë e tyre të punësimit.

**280.** Duke qenë se në vitin 2022 Komisioni i Shëndetësisë ka rivlerësuar pranueshmërinë për kompensim financiar dhe shërbime sociale, siç janë paraparë në Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, ky proces ka çuar në përjashtimin e një numri të konsiderueshëm individësh të cilëve kjo drejtë iu ishte njohur më parë sipas këtij ligji. Përafërsisht 30,000 individë përjetuan një rivlerësim të gjendjes së tyre gjatë vitit, pas procedurave të përcaktuara nga rregulloret e Komisionit të Shëndetësisë. Për rrjedhojë, Institucioni i Avokatit të Popullit, në një raport të dhjetorit 2023, ngriti shqetësime për mungesën e bazës ligjore për rivlerësimet të tilla dhe kërkoi nga institucionet që të përmirësojnë Rregulloren Nr. 07/2017. OJQ HANDIKOS pohon se të drejtat e individëve me aftësi të kufizuara nuk duhet t'i nënshtrohen rivlerësimit, pasi që kushtet e tyre nuk përmirësohen. Në dritën e këtyre shkeljeve, HANDIKOS dërgoi një numër të lëndëve në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku aktualisht janë në vlerësim. Pasoja kritike e kësaj situatë është marginalizimi i rritur socio-ekonomik i individëve të prekur, të cilët tani janë të privuar nga kompensimi financiar që është crucial për shpenzimet e tyre bazë të jetesës dhe nevojat mjekësore. E drejta e individëve për të mos iu nënshtuar rivlerësimeve të pajustificuara duhet të mbrohet për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm dhe për të siguruar qasjen e tyre në mbështetjen thelbësore.<sup>385</sup>

**281.** Shërbimet sociale për individët me aftësi të kufizuara ofrohen nga OShC-të e personave me aftësi të kufizuara me burime të bazuara në projekte. Autoritetet duhet ende të rrisin shërbimet

383 Evropa e Lirë (2023), [Fabrika e veçantë në Lipjan](#).

384 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

385 HANDIKOS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

sociale të bazuara në komunitet për personat me aftësi të kufizuara dhe të rrisin mbështetjen financiare. Veçanërisht të privuar nga mundësitë e barabarta janë fëmijët me aftësi të kufizuara nga komunitetet jo-shumicë dhe sidomos me prejardhje rome, egjiptiane dhe ashkali. Përveç diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar, ata janë të përjashtuar nga pjesëmarrja e barabartë në shoqëri si rezultat i diskriminimit etnik. Siç është paraqitur nga Analiza e Situatës për të Drejtat e Fëmijëve nga Save the Children Kosova, fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me një risk më të lartë për keqtrajtim fizik dhe emocional ose forma të tjera të shpërfilljes, dhunës dhe shfrytëzimit, për shkak të diskriminimit dhe përjashtimit ndaj tyre. Këto pabarazi rrjedhin nga mungesa e koordinimit efektiv ndërsektorial në hartimin e politikave që adresojnë nevojat specifike të fëmijëve, mungesa e burimeve të duhura financiare dhe njerëzore për ofrimin e shërbimeve të përqëndruara tek fëmijët, si dhe nga mungesa e një sistemi të mirëfilltë monitorimi për të garantuar cilësinë e shërbimeve për fëmijët dhe grupet e cenueshme.<sup>386</sup>

## 282. Rekomandime

- Kuvendi i Kosovës duhet të inkorporojë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) në Kushtetutë me qëllim që të promovojë, mbrojë dhe sigurojë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe të promovoj respektin për dinjitetin e tyre;
- Qeveria e Kosovës duhet të konkretizojë prioritizimin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në fuqinë punëtore publike dhe të bëjë transparente të dhënat e saj për përqindjen e personave të punësuar;
- Qeveria e Kosovës duhet të përshpejtojë miratimin e Strategjisë së re për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2024 e në vazhdim) të zhvilluar nga Zyra për Qeverisje të Mirë;
- Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojë harmonizim të qartë të legjislacionit të Kosovës me instrumentet evropiane të të drejtave të njeriut, duke adresuar zbrastësitrat dhe duke formuluar në mënyrë eksplicite harmonizimin me parimet e KDPAK-së;
- Roli institucional dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK) duhet të rritet për të lehtësuar bashkëpunimin ndërinstitutional dhe zbatimin e politikave;
- KKPAK-u duhet të sigurojë takime konsistente sipas politikave të veta, duke lehtësuar kështu mbikëqyrjen dhe koordinimin e vazhdueshëm për politikën dhe iniciativat që lidhen me aftësinë e kufizuar;
- Të gjitha institucionet publike dhe private të Kosovës duhet të forcojnë përpjekjet për përmirësimin e qasjes fizike në ndërtesat institucionale, duke përfshirë gjykatat dhe zyrat noteriale, duke siguruar kështu që individët me aftësi të kufizuara të mund t'i ushtrorjnë të drejtat e tyre për përfqësim ligjor;
- Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Ministria e Drejtësisë, duhet të konsolidojnë Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 në një ligj të veçantë për qasjen publike të personave me aftësi të kufizuara;

- Ministria e Shëndetësisë duhet të adresojë mangësitë e vazhdueshme në sistemin e shëndetësisë duke krijuar mekanizma për shërbime të menjëhershme shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara;
- Ministria e Shëndetësisë duhet të përshpejtojë ngritjen e një njësie spinale në spitalin shtetëror;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) duhet të zhvilloj masa që rrisin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, duke ofruar kushte, trajnime dhe asistentë adekuatë;
- Komisioni i Shëndetësisë duhet të forcojë mekanizmat e tij monitorues për të siguruar respektimin e rregulloreve që parandalojnë rivlerësimet pa demonstruar dukshëm një përmirësim të kushteve të individëve me aftësi të kufizuara.

## 7.5 Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë

**283.** Kosova ka institucione të themeluara në nivel qendror dhe komunal, si dhe një kornizë adekuate legjislative, për të garantuar të drejtat e komuniteteve jo shumicë. Korniza legjislative parasheh parimet demokratike të multietnicitetit, diversitetit dhe barazisë së të gjitha grupeve etnike, fetare dhe gjuhësore në Kosovë.<sup>387</sup> Kushtetuta e Kosovës deklaron në nenin 3.1 (Barazia para ligjit) se Kosova “është një shoqëri multietnike e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera”.<sup>388</sup> Komunitetet jo-shumicë të Kosovës përfshijnë komunitetet Serb, Turk, Rom, Ashkali, Egjiptianë, Boshnjakë dhe Goranë dhe<sup>389</sup> komunitetet e tjera. Në tabelën 5 më poshtë, proporcioni demografik i komuniteteve përkatëse është ilustruar sipas regjistrimit të fundit të popullsisë.<sup>390</sup> Përveç Kushtetutës, të drejtat e komuniteteve jo-shumicë janë të garantuara me Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Në këtë ligj, “diversiteti kombëtar, etnik dhe fetar” i Kosovës përkufizohet si “burim i forcës dhe i pasurisë për zhvillimin e mëtutjeshëm të një shoqërie demokratike”.<sup>391</sup> Bazuar në këtë kuptim, ligji parasheh masa të veçanta që mund të sigurojnë zbatimin e statusit të barabartë dhe integrimin e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në shoqërinë kosovare. Për më tepër, në Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve (Ligji i Gjuhëve) shqipja dhe serbishtja kanë statusin e gjuhëve zyrtare. Në nivel komune, gjuha e çdo komuniteti jo-shumicë do të ketë statusin e një gjuhe në përdorim zyrtar nëse një komunë banohet nga një komunitet, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe që përbën të paktën 3 përqind të totalit të popullsisë së komunës përkatëse.<sup>392</sup> Përdorimi zyrtar i gjuhës turke dhe rome në Komunën e Prizrenit është një rast ilustrues i këtij ligji në praktikë. I njëjtë është rasti me gjuhën rome në Graçanicë.

387 Demaj, U. & M. Vandenbroucke (2016), [Peizazhet e Kosovës të pasluftës në Prishtinë: mospërputhjet ndërmjet politikave gjuhësore dhe realitetit urban](#) | Nationalities Papers | Cambridge Core.

388 Kushtetuta e Kosovës (2008).

389 Kushtetuta e Kosovës (2008), Kapitulli III.

390 Agjencia e Statistikave të Kosovës [Agjencia e Statistikave të Kosovës \(rks-gov.net\)](#) (2021).

391 Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës [Ligji Nr. 03/L-047](#).

392 Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Ligji Nr. 02/L-037](#).

**Tabela 5 Popullsia sipas përkatësisë etnike duke përfshirur 'të tjerët' dhe 'preferoj të mos përgjigjem'<sup>393</sup>**

	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Turq të Kosovës	Boshnjakë të Kosovës	Romë të Kosovës	Ashkali të Kosovës	Egjiptianë të Kosovës	Goranë të Kosovës	Gjithsej
<b>Gjithsej</b>	1,616,869	25,532	18,738	27,533	8,824	15,436	11,524	10,265	1,739,825

**284.** Mekanizmat institucionalë që i mbrojnë pjesërisht të drejtat dhe përgjegjësitë e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë bien brenda Këshillit Konsultativ për Komunitete i Zyrës së Presidentit të Kosovës, Zyrate Komunale për Komunitete dhe Kthim por edhe me IAP-në dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK). Këshilli Konsultativ për Komunitete e mbush zbrastësirën ndërmjet institucioneve publike të Kosovës dhe komuniteteve. Roli i tij qendror është të artikulojë pikëpamjet e komuniteteve mbi legjislacionin, politikat dhe programet relevante për komunitetet jo-shumicë, të garantojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve dhe t'u ofroj komuniteteve mundësinë për të marrë pjesë në iniciativat ligjore dhe politike. Përveç Këshillit, Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2022-2026. Qeveria ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për 2022-2024.<sup>394</sup> Vonesa e miratimit të strategjisë ka ndikim negativ në jetën e komuniteteve romë dhe ashkali në arsim, shëndetësi, banim, çështje sociale dhe anti-diskriminim.

**285.** Strategjia dhe Plani i Veprimit i fundit i Qeverisë së Kosovës (2022-2024) parasheh më shumë veprime në lidhje me përfshirjen shoqërore të komuniteteve Rom dhe Ashkali.<sup>395</sup> Pas Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së (Deklarata e Poznanit), Qeveria e Kosovës ka krijuar një Grup Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian.<sup>396</sup> Grupi Teknik është përgjegjës për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me diskriminimin ndaj këtyre komuniteteve në Kosovë. Grupi ka për detyrë të identifikojë rastet e diskriminimit dhe të punojë me autoritetet përkatëse për të adresuar këto çështje. Përveç kësaj, grupi është përgjegjës për rritjen e vetëdijesimit për diskriminimin ndaj këtyre komuniteteve dhe promovimin e të drejtave dhe mundësive të barabarta. Në vitin 2021 u lansua një platformë elektronike ku personat që kanë përjetuar diskriminim inkurajohen të raportojnë rastet e tyre, të cilat më pas hetohen nga Grupi dhe institucionet përgjegjëse. Në vitin 2022, platforma u qas nga pothuajse 6,000 vizitorë dhe u raportuan 8 raste diskriminimi.<sup>397</sup> Në vitin 2023, u regjistruan më shumë se 9,000 vizita në platformë.<sup>398</sup> Gjatë takimit të parë ndërinstitucional të organizuar nga Rrjeti i të Drejtave të Njeriut, përfaqësuesit e ZQM-së raportuan se kanë pranuar 45 raste në platformë. Zyra për Qeverisje të Mirë publikoi një raport për përdorimin e platformës dhe shtimin e rasteve të raportuara.<sup>399</sup>

393 Shumica e serbëve të Kosovës e bojkotuan regjistrimin e popullsisë në Kosovë në vitin 2011. Si rezultat, ende nuk ka të dhëna zyrtare se sa serbë etnikë jetojnë në Kosovë.

394 Childhub (2022), [Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës \(2022-2026\) dhe plani i saj i veprimit për vitet 2022-2024 janë miratuar.](#)

395 Programi i Qeverisë së Kosovës [Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf \(rks-gov.net\).](#)

396 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022.](#)

397 Platforma kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian [Platforma kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian \(2022\).](#)

398 Zyra për Qeverisje të Mirë (2023), [U kremtua njëvjetori i punës së Platformës Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.](#)

399 ZQM (2023), Platforma kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

**286.** Konteksti multi-etnik i Kosovës karakterizohet me mungesë të përputhshmërisë në mes të ambientit zyrtar multi-etnik në letër dhe segregacionit etno-hapësinor në realitet.<sup>400</sup> Kosova përfaqësohet si një shoqëri etnikisht gjithëpërfshirëse në ligjet dhe rregulloret e saj të ndryshme, por nocioni i 'multi-etnicitetit' nuk përputhet me realitetin e ndarjes etno-hapësinore që u krijua gjatë viteve 1990 dhe u kristalizua pas konfliktit të armatosur 1998-1999.

**287.** Përveç konfigurimit multi-etnik të Kosovës, ekzistojnë mospërputhje ndërmjet politikës gjithëpërfshirëse dhe praktikave të përjashtimit etnik dhe gjuhësor. Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve është përfaqësues i konsolidimit të barazisë në legjislacionin e Kosovës. Me miratimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, Kuvendi i Kosovës shpalli përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare, shqipes dhe serbishtes. Pasi që vetë ligji nuk identifikon mjete për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve komunale për të siguruar zbatimin e tij, Qeveria e Kosovës miratoi udhëzimet administrative në vitin 2008 dhe themeloi një Komisioner për Gjuhët për të mbikëqyrur zbatimin e tij. Megjithatë, kërkohet ende një angazhim më i fortë i qeverisë për të konsoliduar politikën gjuhësore.<sup>401</sup> Krahas cilësisë së dobët të përkthimeve në serbisht, studimet raportojnë për përjashtimin dhe zëvendësimin sistematik të serbishtes me anglisht në shenjësimin e autoriteteve zyrtare në kryeqytet.<sup>402</sup>

**288.** Një aspekt kryesor në kuadër të vlerësimit të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë për vitin 2023 lidhet me sigurinë, duke ndikuar dukshëm në rritjen e tensionit në komunitet. Perceptimi ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, qoftë si komunitete brenda të njëjtit shtet apo si grupe rivale, është formësuar thellësisht nga peisazhi më i gjerë politik i rajonit. Veçanërisht, tensionet në veri të Kosovës u rishfaqën në fund të korrikut 2022, të shkaktuara nga një vendim i Qeverisë së Kosovës lidhur me lëshimin e targave të veturave, duke vazhduar gjatë gjithë vitit 2023.

**289.** Pas ngjarjeve të vitit 2022,<sup>403</sup> me dorëheqjen pasuese masive të zyrtarëve serb në veri të Kosovës, popullata serbe e Kosovës i bojkotoi zgjedhjet e prillit 2023 me pjesëmarrje historikisht të ulët prej 3.47 përqind.<sup>404</sup> Edhe pse Raporti i Komisionit Evropian Këshilli i Sigurisë (2023) nënvizon se zgjedhjet e pjeshme u mbajtën në përputhje me kornizën legjislative të Kosovës, si rezultat i pjesëmarrjes së ulët të serbëve të Kosovës, detyrën në komunat veriore e morën kryetarë me prejardhje etnike shqiptare. Bojkotimi i serbëve shkeli detyrimet e Serbisë për dialog, sipas Raportit të Komisionit Evropian, dhe përbënte shkelje të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, e krijuar për të lehtësuar asimilimin e strukturave të vetëadministrimit lokal në sistemin e Kosovës nën qeverisje të përfaqësuesve të serbëve të Kosovës.<sup>405</sup> Raporti i Komisionit Evropian (2023) po ashtu thekson se zgjedhjet e reja duhet të mbahen me "pjesëmarrje të pakushtëzuar" të popullatës serbe.<sup>406</sup>

400 Demaj, U. & M. Vandenbroucke (2016), [Peizazhet e Kosovës të pasluftës në Prishtinë: mospërputhjet ndërmjet politikave gjuhësore dhe realitetit urban | Nationalities Papers | Cambridge Core](#).

401 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

402 Demaj, U. & M. Vandenbroucke (2016), [Peizazhet e Kosovës të pasluftës në Prishtinë: mospërputhjet ndërmjet politikave gjuhësore dhe realitetit urban | Nationalities Papers | Cambridge Core](#).

403 Shih raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

404 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 79.

405 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023, fq. 80.

406 IRS (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023, fq. 4.

**290.** Siç u theksua më herët në raport, tensionet në veri u shfaqën sërish më 26 maj 2023, pasi që hyrja e kryetarëve shqiptarë në ndërtesën e komunës, të shoqëruar nga njësitë special të sigurisë së Policisë së Kosovës, hasi në pengesa nga protestuesit serb. Përleshja që pasoi në mes të Policisë së Kosovës dhe protestuesve ka rezultuar në lëndime të shumta të shkallëve të ndryshme të personave të ndryshëm. Situata u përshkallëzua në dhunë më 29 maj 2023 me anëtarët e KFOR-it të vendosur për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm në terren duke u bërë "objekt i sulmeve të paprovokuara dhe plagëve të traumave me thyerje dhe djegie për shkak të shpërthimit të mjeteve ndezëse" (deklarata e KFOR-it). Të paktën 30 ushtarë paqeruajtës dhe 52 civilë u plagosën në përleshjet midis forcave të sigurisë dhe serbëve etnikë më 29 maj 2023.<sup>407</sup>

**291.** Përveç se si më sipër, vlen të përmendet edhe vendimi i Qeverisë së Kosovës, i zbatuar më 14 qershor të vitit aktual, për ndalimin e importit të produkteve serbe, masë e cila ka mbetur në fuqi gjatë periudhës raportuese. Fillimisht, ky vendim përfshinte të gjithë kamionët me targa serbe; megjithatë, modifikimet e mëvonshme lejuan importimin e mallrave nga subjektet e huaja që operojnë brenda Serbisë. Kjo direktivë ka pasur pasoja në disponueshmërinë e produkteve të caktuara serbe në objektet e shitjes me pakicë në mbarë Kosovën, veçanërisht në rajonet e banuara kryesisht nga serbët. Për të adresuar këtë mungesë, janë prezantuar produkte nga burime alternative, si Maqedonia e Veriut. Megjithatë, këto zëvendësues shpesh vijnë me një kosto më të lartë se gjenerikët e tyre serb, duke imponuar kështu një tendosje financiare shtesë për qytetarët, veçanërisht në mes të rrethanave sfiduese mbizotëruese si në Evropë ashtu edhe në rajon më të gjerë. Është thelbësore të theksohet se vendimi i lartpërmendur jo vetëm që përbën shkelje të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), por gjithashtu bie ndesh me parimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim dhe Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.<sup>408</sup>

**292.** Ndryshe nga e kaluara, Qeveria aktuale nuk u pajtua me lehtësimin e votimit nga OSBE-ja për t'u mundësuar serbëve të votojnë në referendumin kushtetues dhe zgjedhjet e përgjithshme të Serbisë.<sup>409</sup> Ashtu si në vitin e kaluar, Qeveria e Kosovës përsëriti qëndrimin e saj se këto zgjedhje nuk mund të mbahen në të gjithë Kosovën, por duhet të kufizohen në Zyrën Ndërlidhëse në Prishtinë, që vepron nën patronazhin e Misionit të Bashkimit Evropian. Kryeministri pohoi se mbajtja e zgjedhjeve jashtë këtyre ambienteve kërkon një marrëveshje të veçantë në kuadër të dialogut të vazhdueshëm mes dy palëve. OSBE-ja edhe më herët ka pohuar gatishmërinë e saj për të lehtësuar procesin e votimit, siç ka ndodhur nga viti 2017 deri në vitin 2020, në varësi të pëlqimit dhe mbështetjes së institucioneve të Kosovës, me theks të veçantë në Policinë e Kosovës.<sup>410</sup>

**293.** Më 8 prill 2023, Policia e Kosovës ka nxjerrë direktiva për ndalimin e të gjitha aktiviteteve brenda Kosovës nga subjektet sportive të cilave u mungon regjistrimi në federatat sportive të Kosovës.<sup>411</sup>

**294.** Më 31 maj, Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit inicioi një program të granteve, duke zotuar gjithsej 500,000 euro për komunitetet jo-shumicë. Megjithatë, shqetësimet për drejtësinë në procesin e ndarjes u ngritën nga palë të ndryshme të interesit, duke përfshirë disa media kosovare dhe OJQ që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë. Veçanërisht, nga

407 Balkan Insight (2023), [Mos i injoroni shkaqet e vërteta të rënies së popullatës serbe të Kosovës](#).

408 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

409 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

410 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

411 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.



më shumë se 40 OJQ, vetëm tre u shpallën si përfitues paraprakë të granteve më 11 korrik. Duke iu përgjigjur këtyre shqetësimeve, Zëvendës Avokati i Popullit të Kosovës shprehu shqetësimin për ndarjen e fondeve dhe konfirmoi fillimin e hetimit së kësaj çështjeje.<sup>412</sup> Njëkohësisht, OJQ-të që përfaqësojnë komunitetin serb i kërkuan qeverisë ta anulojë thirrjen për financimin e komuniteteve. Ky zhvillim nënvizon nevojën për një proces transparent dhe të barabartë të ndarjes së granteve, duke nxitur shqyrtimin prej vëzhguesve vendas dhe ndërkombëtarë.<sup>413</sup>

**295.** Në periudhën 26 shkurt 2023 deri në 27 mars 2023, OJQ IRS vëren se gjithsej 10 shtëpi në pronësi të serbëve janë plaçkitur ose grabitur në komunën e Graçanicës. Sipas OJQ IRS, dështimi për të ndjekur penalisht personat përgjegjës për krimet e lartpërmendura kontribuon në perceptimin se ato mund të kryhen pa u ndëshkuar, gjë që mund të inkurajojë shpeshhtësinë e tyre.<sup>414</sup>

**296.** Sipas OJQ Aktiv, puna e rregullt e Policisë së Kosovës është gjithnjë e më shumë në hije nga prania e njësisve speciale të policisë në veri. Ata shprehen se forcat speciale të Kosovës “ngjallin frikë të madhe për shkak të imazhit të tyre frikësues dhe mungesës së ndonjë pjesëtari nga popullata lokale”. Sipas të dhënave nga OJQ Human Center Mitrovica, frika nga këto njësi është e pranishme në 77 përqind të popullatës lokale.<sup>415</sup> Ndër shqetësimet e tjera, qytetarët e thjeshtë kanë frikë prej pikave të kontrollit dhe së paku katër bazave të ndërtuara në veri të Kosovës për nevojat e njësisve speciale. Veçanërisht problematike është pika e kontrollit pranë Bisticës në rrugën kryesore, ku policia speciale ndalon dhe bën identifikimin e qytetarëve. Të gjithë këta faktorë kanë kontribuar në perceptimin e popullatës së zakonshme se “forcat speciale të policisë nuk janë aty për të garantuar sigurimin dhe mirëqenien e qytetarëve, por më tepër si një faktor jostabiliteti dhe represioni”. Ky besim është përforcuar nga incidente të shumta që përfshijnë civilë në të cilat kanë marrë pjesë pjesëtarë të këtyre njësisve. Sipas OJQ Aktiv, rastet e dokumentuara përfshijnë “raste individuale të keqtrajtimit dhe represionit të qytetarëve nga njësitë speciale të policisë, që ndodhin kryesisht në rrugën kryesore ku nuk ka dëshmitarë apo kamera për të siguruar prova materiale”.<sup>416</sup>

**297.** Sa i përket institucioneve, hulumtimi ndaj opinionit publik tregon një ndryshim statistikisht domethënës në nivelin e besimit në institucionet e zbatimit të ligjit në mesin e shqiptarëve dhe serbëve, ku këta të fundit kanë besim dukshëm më të ulët. Në mënyrë të tërthortë, kjo mund të çojë në përfundimin se ka një ndryshim në qasjen e institucioneve dhe marrëdhëniet e tyre me grupet e ndryshme etnike, konstatim i mbështetur nga raportet e komunitetit ndërkombëtar. Përshembull, raportet vjetore nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së elaborojnë për të njëjtin trend, duke përmendur kapacitetin e pamjaftueshëm ose mungesën e vullnetit për të zbatuar ligjet që, në letër, ofrojnë qasje të barabartë në të drejta, por në praktikë nuk janë të mjaftueshme.<sup>417</sup>

**298.** Vlerësimi i situatës së komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, siç vlerësohet nga raporti vjetor i OJQ AKTIV, përshkruan fushat kryesore që kërkojnë vëmendje për përmirësimin e të drejtave të

412 Gazeta Express (2023), [Dyshimet-per-abuzim-me-fondin-per-komunitete-avokati-i-popullit-nis-hetimet](#).

413 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

414 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

415 Human Centre Mitrovica (2023), Raporti për sigurinë dhe marrëdhëniet etnike në Kosovë për vitin 2023.

416 Aktiv (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

417 IRS (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

përgjithshme. Në komunitetin boshnjak, ekziston një nevojë kritike për të përmirësuar cilësinë e arsimit në gjuhën boshnjake, duke siguruar disponueshmërinë e teksteve shkollore dhe duke zgjeruar ofertat e kurseve në shkollat e mesme dhe universitete. Për më tepër, përpjekjet duhet të fokusohen në mbrojtjen dhe ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kulturor, së bashku me lehtësimin e qasjes në shërbime dhe informacione në gjuhën amtare boshnjake. Për komunitetin goran, rekomandimet përfshijnë avokimin për punësimin e të paktën një vendasi nga komuna e Dragashit që e ka gjuhën gorane gjuhë amtare, përmirësimin e kushteve ekonomike dhe adresimin e çështjeve të grabitjes dhe vjedhjes së pronës përgjatë rajoneve kufitare. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë thirrje për qasje të barabartë në shërbime, mekanizma të zgjeruara operacionale të institucioneve për të luftuar diskriminimin, si dhe për promovimin e përfshirjes së gjuhës rome. Brenda komunitetit serb, theksohet nevoja urgjente për të adresuar shqetësimet e sigurisë, për të lehtësuar kthimin e pronave të uzurpuara, si dhe për të siguruar qasje të barabartë në shërbime, veçanërisht në zonat rurale. Sa i përket komunitetit turk, këshillohen hapa të menjëhershëm për të adresuar barrierat gjuhësore përmes përkthyesve dhe sigurimit të informacionit/dokumenteve zyrtare në gjuhën turke. Institucionet qendrore duhet të fokusohen në përmirësimin e mungesës së librave në gjuhën turke në shkolla dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për papunësinë e të rinjve. Ky vlerësim gjithëpërfshirës thekson sfidat specifike dhe propozon intervenime të targetuara për të përmirësuar të drejtat dhe mirëqenien e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.<sup>418</sup>

**299.** Gjuha e urrejtjes dhe aktet e diskriminimit ishin të përhapura në kontekstin e situatës së paqëndrueshme në veri të Kosovës në vitin 2022, e cila vazhdoi gjatë gjithë vitit 2023.<sup>419</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në mënyrë që të zbatohet parimi i trajtimit të barabartë. Përkundër kësaj, institucionet publike dështojnë të veprojnë në përputhje me ligjin dhe të ofrojnë qasje dhe kushte të barabarta sociale për komunitetet jo-shumicë.

**300.** Për dallim nga politikëbërja gjithëpërfshirëse, komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Kosovës përballen me diskriminim në bazë të përkatësisë së tyre etnike, përkundër Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi i cili parandalon diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike. Stigma që i është vënë kulturës së tyre i ka shtyrë ata më tej drejt marginalizimit duke rezultuar në qasje të pabarabartë në kujdesin shëndetësor, punësim dhe arsim.<sup>420</sup> Përveç kësaj, malazetët dhe kroatët ballafaqohen me beteja të ngjashme si jo-shumicat e tjera kur bëhet fjalë për qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor, punësim dhe përfshirje në sferat e tjera shoqërore që sigurojnë të drejtat dhe mundësitë e tyre të barabarta në Kosovë.<sup>421</sup>

### 301. Rekomandime

- ZQM-ja duhet të rris fushatat e vetëdijesimit të publikut që promovojnë respektin dhe mirëkuptimin ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike;
- ZQM-ja duhet të inkurajojë angazhimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit nga vetë komuniteti në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre, duke përfshirë edhe përmes strukturave të qeverisjes lokale;

418 Aktiv (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

419 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

420 Pjesët 7.1 dhe 7.2 të raportit aktual diskutojnë situatën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga këndvështrimi i të drejtave të grave dhe të drejtave të fëmijës.

421 IRS (2022) dhe Aktiv (2022), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022..

- ZQM-ja dhe Zyra e Komisionerit të Gjuhëve duhet të zhvillojnë një strategji për rritjen e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike duke përfshirë programet gjuhësore;
- Institucionet qendrore dhe lokale duhet të përmirësojnë koordinimin dhe komunikimin e tyre institucional për të siguruar mbrojtjen efektive të komuniteteve jo-shumicë dhe të drejtave të tyre;
- Qeveria e Kosovës duhet të adresojë tensionet në rritje ndërgrupore ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, duke garantuar sigurinë e qytetarëve dhe besimin reciprok, duke shmangur kështu ndikimin negativ të njësive speciale të policisë në popullatën lokale;
- Qeveria e Kosovës duhet të ndalojë praktikën e ndalimit të importeve nga Serbia duke hequr ndalimin e importimit të produkteve serbe dhe duke mundësuar importin e papen-guar të mediave të shkruara serbe, barnave dhe furnizimeve mjekësore;
- Të gjitha institucionet, përfshirë Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, kanë përgjegjësi bashkëpunuese për zbatimin e vazhdueshëm të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Ato duhet të punojnë së bashku për të siguruar që ligji të zbatohet dhe që të gjithë individët dhe komunitetet të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre gjuhësore.

## 7.6 Të drejtat e personave LGBTIQ+

**302.** Të drejtat e personave lezbike, gej, biseksualë, transgjinatorë, interseksualë dhe queer (LGBTIQ+) mbrohen ndërkombëtarisht nëpërmjet nenit 7 të DUDNj-së dhe nenit 14 të KEDNj-së, i cili mbron nga diskriminimi në çfarëdo baze. Nga ana tjetër, njohja e qartë e komunitetit LGBTIQ+ ose orientimit seksual dhe përfshirjes gjinore në deklaratën dhe konventën përkatëse nuk është e disponueshme. Megjithatë, jurisprudenca e GjEDNj-së është pasuruar me raste që kanë të bëjnë me diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, duke ofruar kështu një fushë të gjerë të mirëkuptimit në terrenin ndërkombëtar. Në kontekstin e KEDNj-së, parashtruesit që kanë të bëjnë me të drejta të barabarta martesë kanë kundërshtuar dispozita të ndryshme të KEDNj-së para GjEDNj-së, kryesisht duke u thirrur në nenet 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), 12 (e drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit). Dispozita më e rëndësishme është neni 12, i cili parasheh se "Burrat dhe gratë në moshë madhore martohen dhe krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte". Në nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës përmendet edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor.

**303.** Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh kufizime gjinore në lirinë e martesës; neni 37 i Kushtetutës së Kosovës njeh se secili ka të drejtë të martohet dhe të drejtën për të pasur familje siç parashihet me ligj. Pavarësisht të drejtave kushtetuese të personave LGBTIQ+, legjislacioni i nevojshëm për njohjen e komunitetit në terma të barabartë me të gjithë anëtarët e shoqërisë nuk është miratuar në Draft Kodin Civil. Kjo ndodh për shkak të dështimit të Kuvendit të Kosovës për të votuar në favor të bashkësive të të njëjtës gjini, duke reflektuar ideologjinë thelbësisht homofobike në themel të strukturave shoqërore të Kosovës. Kjo ka penguar gjithashtu përpjekjet e per-

sonave LGBTIQ+, shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar për t'i ofruar vendit demokraci më të plotë. Në vend të kësaj, diskutimet rreth bashkësive të të njëjtës gjini nxitën një fushatë homofobike në vitet 2022 dhe 2023 kundër individëve të komunitetit LGBTIQ+ me persona publikë, figura politike dhe media që shprehen hapur kundër të drejtave themelore të individëve LGBTIQ+. Kjo ishte veçanërisht e dukshme gjatë seancës së diskutimit të draft Kodit Civil në Kuvendin e Kosovës. Në veçanti, deklarata e Kryetares së Komisionit të të Drejtave të Njeriut të Kuvendit të Kosovës, Duda Balje, e cila publikisht deklaroi votën e saj kundër martesës mes personave të seksit të njëjtë, ishte një paradoks i qartë me pozicionin e saj publik në shoqëri.<sup>422</sup> Komentet e Baljes në vitin 2022 ishin diskriminuese nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, sepse ato nënkuptojnë se të drejtat e personave LGBTIQ+ duhet të jenë në varësi të vlerave kulturore dhe tradicionale të shumicës. Kjo qasje injoron faktin që të drejtat e njeriut janë universale dhe zbatohen për të gjithë individët, pavarësisht përkatësisë së tyre kulturore apo fetare. Lidhur me këtë, IAP-ja ka lëshuar një opinion ku thuhet se martesa mes personave të seksit të njëjtë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe privimi i personave LGBTIQ+ nga kjo e drejtë është shkelje e të drejtës së tyre për të mos u diskriminuar në bazë të orientimit të tyre seksual.<sup>423</sup> Përkeqësimi i pozitës tashmë të dobët të individëve LGBTIQ+ në Kosovë vazhdon pasi Balje mbetet Kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, pavarësisht nga thirrjet për shkarkim nga OShC-të, dhe në korrik 2023 ajo i akuzoi publikisht individët LGBTIQ+ se "kanë humbur rrugën" në një program televiziv. Gjuha diskriminuese e përdorur nga politikanët si Balje jehon në të gjitha sferat e shoqërisë, duke minuar kështu përpjekjet aktive për të krijuar një shoqëri më të hapur dhe të barabartë të qasshme nga të gjithë anëtarët e komunitetit.<sup>424</sup> Në vitin 2023, u rrezikua edhe siguria e individëve LGBTIQ+. Një aktivist për të drejtat e personave LGBTIQ+ ishte cak i një krimi të urrejtjes dhe incidenti u raportua në Policinë e Kosovës. Një rast tjetër përfshin një aktakuzë nga Prokuroria Speciale e Kosovës kundër një individi të dyshuar për planifikimin e një sulmi terrorist në Kosovë që si cak kishte personat LGBTIQ+ në sheshin e Prishtinës me materiale të rrezikshme dhe vdekjeprurëse.<sup>425</sup> Në anën tjetër, organizatat anëtare të Rrjetit të të Drejtave të Njeriut (RrDNj) u kanë bërë thirrje institucioneve të drejtësisë që ta hetojnë rastin e grafiteve të shkruara në oborrin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për thirrjen e vrasjes së personave LGBTIQ+.<sup>426</sup>

**304.** Sipas OJQ CEL, janë raportuar katër raste, që përfshijnë sulm, kërcënime, cenim të privatësisë dhe dhunë në familje, por zgjidhja e tyre mbetet e dobët. Autoritetet përmendin sfidën e gjurmimit për gjetjen e origjinës së kërcënimeve online si arsye për mosveprimin e tyre. Vlen të përmendet se rastet e paraqitura në mënyrë të pavarur në stacion policor hasin më shumë pengesa në krahasim me ato të shoqëruara nga përfaqësues të OJQ CEL.<sup>427</sup>

**305.** Pavarësisht nga rëndësia e incidenteve të raportuara, mungesa e progresit në adresimin e tyre ngre shqetësime për efikasitetin e procedurave aktuale hetimore. Natyra e pazgjidhur e këtyre rasteve jo vetëm që përjetëson një ndjenjë cenueshmërie për viktimat, por gjithashtu nënvizon nevojën për një qasje më të fuqishme dhe teknologjikisht të përshtatshme për trajtimin e kërcënimeve online. KPK vazhdon të mbajë një mekanizëm përcjellës për krimet e urrejtjes, meg-

422 Rrjeti i të Drejtave të Njeriut (2022), [Deklaratë në lidhje me deklaratat e bëra nga Duda Balje për martesat mes gjinisë së njëjtë](#).

423 Ekonomika online, [Avokati i Popullit mbështet martesat mes gjinisë së njëjtë, ka një vërejtje për Kodin Civil – Ekonomia Online](#)

424 Kanal 10 (2023), [Ti i bën dëm LGBT, sepse e ke humb rrugën" - "çfarë instituti moral je ti?," Duda Balje vs. Vullnet Krasniqi](#).

425 Kallxo.com (2023), [Aktakuzë ndaj një personi për përgatitjen e veprave penale terroriste ndaj komunitetit LGBT \(kallxo.com\)](#)

426 RrDNj (2023), <https://www.facebook.com/RrDNjKosovo/posts/pfbid0qGirTsbz8PITYJLy1oWPToTBfD9WBon9YtsRi7xgEnKj27v9pke-SE9A66WKC5YPWI>

427 CEL (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

jithatë mbledhja e përgjithshme e të dhënave për krimet e urrejtjes kundër individëve LGBTIQ+ mbetet në shqyrtim.<sup>428</sup> Ndërsa Kodi Penal përcakton se në çdo vepër penale të motivuar nga identiteti gjinor dhe orientimi seksual, motivet themelore kuptohen si rrethana rënduese, shkalla në të cilën homofobia qëndron në themelin e krimeve të urrejtjes nuk është e hulumtuar sa duhet. OJQ CEL sugjeron që pabarazitë në rezultatet ndërmjet rasteve të paraqitura vetëm dhe atyre me ndihmën e CEL-it dëshmojnë rëndësinë e një rrjeti mbështetës social dhe avokimi për t'u qasur në kompleksitetin e sistemit ligjor. Kjo mospërputhje thekson zbrastësitat në reagimin institucional kundrejt ankuesve individualë dhe thekson rëndësinë e ndihmës gjithëpërfshirëse për viktimat e veprave të tilla.<sup>429</sup> Në një letër përgjigjeje drejtuar RrDNj-së, PK-ja shpreh se në nivelin qendror është caktuar një koordinator i rasteve të krimeve të urrejtjes, i cili mbikëqyr të gjitha raportet, informacionet, pranon dhe përditëson të gjitha raportet e pranuar si dhe përcjell të gjitha statistikat e rasteve për çdo muaj apo edhe në periudha të ndryshme sipas kërkesës së menaxhmentit të PK-së.<sup>430</sup>

**306.** Edhe pse në periudhën e mëparshme raportuese, thuhet se ishte duke u planifikuar ndërtimi i një strehimore në komunën e Prishtinës për mbrojtjen e individëve të dëbuar nga familjet e tyre dhe të viktimizuar nga të tjerët, kjo nuk ka përparuar në vitin 2023.<sup>431</sup> OJQ CEL Kosova raporton se mungesa e akomodimit institucional të ofruara në nivel shtetëror për personat e sulmuar të komunitetit LGBTIQ+, i ka shtyrë OJQ-të të ofrojnë rrjetet e tyre të ndihmës; CEL Kosova ofron akomodim emergjent për personat LGBTIQ+ të moshës madhore.

**307.** Institucionet e Kosovës ende nuk kanë miratuar një strategji konkrete për të promovuar pranimin nga shoqëria e Kosovës të personave LGBTIQ+. Edhe pse Zyra për Qeverisje të Mirë deklaroi në periudhën e mëparshme raportuese (2022) se po zhvillohej një draft plan veprimi kundër stigmatizimit të lidhur me anëtarët e komunitetit LGBTIQ+, ende nuk ka një dokument konkret në lidhje me promovimin e statusit të këtij komuniteti. Deri më tani, Qeveria e Kosovës nuk ka arritur të iniciojë fushata për rritjen e nivelit të pranimit të individëve LGBTIQ+ në domenin publik ose privat.<sup>432</sup>

**308.** Në qershor 2023 u publikua një raport analitik i një sondazhi të opinionit publik nga OJQ ERA, i cili synonte të shqyrtonte si mund të kenë ndryshuar perceptimet që nga sondazhet e fundit të qëndrimit të vitit 2015.<sup>433</sup> I kryer midis dhjetorit 2022 dhe janarit 2023, raporti zbulon se qëndrimet ndaj personave LGBTIQ+ janë përmirësuar prej vitit 2015, por mbeten kryesisht negative. Pranimi është më i theksuar në zonat më të mëdha urbane, ku gratë në përgjithësi janë më mbështetëse se burrat. Raporti tregon se niveli i arsimimit lidhet me rritjen e pranimit, por në të gjitha nivelet e arsimit mungon gatishmëria për të mbështetur plotësisht një person LGBTIQ+ në marrëdhënie të ngushta. Publiku shpreh pranim të pjesëshëm të popullatës LGBTIQ+, duke këndështuar ekspozimi publik dhe Paradat e Krenarisë. Besimet negative të përhapura vazhdojnë, me një pjesë të konsiderueshme që kundërshtojnë që çiftet LGBTIQ+ të kenë fëmijë ose që të martohen.<sup>434</sup>

428 Komisioni Evropian (2022), [Raporti për Kosovën për vitin 2022](#).

429 CEL Kosova (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në vitin 2023.

430 PK (2022), përgjigje email për RrDNj në lidhje me rekomandimet e raportit të përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2021.

431 Komisioni Evropian (2023), Raporti për Kosovën për vitin 2023.

432 CEL Kosova (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

433 LGBTI Era (2023), [Qëndrimet ndaj personave LGBTIQ+ në Ballkanin Perëndimor: Raport analitik i një ankete të opinionit publik](#).

434 LGBTI Era (2023), [Qëndrimet ndaj personave LGBTIQ+ në Ballkanin Perëndimor: Raport analitik i një ankete të opinionit publik](#).

**309.** Një hap pozitiv drejt progresit, sa i përket perceptimit të publikut në këtë drejtim është qëndrimi më i fundit i kryeministrit të Kosovës Albin Kurti dhe zyrtarëve të tjerë, të cilët e artikuloan mbështetjen e tyre duke u paraqitur publikisht në ballë të Paradës së Krenarisë në Prishtinë në vitin 2023. E organizuar për herë të shtatë, Prishtina Pride është përballur me kundërshtimin e grupeve konservatore dhe fetare, duke rezultuar në shqetësime të sigurisë dhe nevojën për mbrojtje policore gjatë këtyre ngjarjeve. Përkundër këtyre sfidave, megjithatë, është hera e parë që kryeministri i Kosovës, kryetari i komunës së Prishtinës dhe ministri i Shëndetësisë dalin publikisht në mbështetje të këtij eventit. Komuniteti LGBTIQ+ në Kosovë vazhdon të punojë drejt arritjes së një pranimi dhe barazie më të madhe, duke përfshirë njohjen e martesës mes sekseve të njehta dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Promovimi i të drejtave të personave LGBTIQ+ në Kosovë është një proces i vazhdueshëm dhe Java e Krenarisë në Prishtinë luan një rol vendimtar në krijimin e visibilitetit dhe ndërtimin e momentumit drejt një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.<sup>435</sup>

**310.** Në fushën e shëndetësisë, MSH-ja ka themeluar një Grup Punues për hartimin e Protokollit Klinik për Profilaksin e HIV-it para ekspozimit. Teksa nisma daton në vitin 2017, vetë protokollit aktualisht është në pritje të miratimit.<sup>436</sup> Në fushën e shëndetësisë, institucionet në Kosovë nuk janë të pajisura për tranzicion gjinor, trajtim hormonal apo çfarëdo lloj mase tjetër në dobi të veçantë të komuniteteve LGBTIQ+. Sipas OJQ CEL Kosova, dhurimet vullnetare të gjakut nga anëtarët e komunitetit nuk pranohen nga instancat shëndetësore për shkak të stigmës dhe ndërlidhjes ndërmjet anëtarëve LGBTIQ+ dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV-in.<sup>437</sup>

**311.** Në lidhje me atë që u tha më lart, ka një mungesë të konsiderueshme të hulumtimeve që përditësojnë të kuptuarit shoqëror në lidhje me mirëqenien e individëve nga komunitetet LGBTIQ+. Një argument ka të bëjë me shkallën e bullizmit që i nënshtrohen individët LGBTIQ+ në bazë të orientimit seksual qoftë faktik ose të perceptuar, identitetit gjinor dhe karakteristikave të shprehjes gjinore. Megjithatë, në të njëjtën kohë, numri i vetëvrasjeve, vetë-lëndimeve që rezultojnë në ankth dhe depresion në mesin e komuniteteve LGBTIQ+, vazhdon të rritet sipas OJQ CEL Kosova.

**312.** Mungesa e ekzaminimeve të përditësuara empirike, studimeve, fushatave dhe nismave të tjera të financuara nga shteti në lidhje me mirëqenien socio-ekonomike dhe psikologjike të këtij segmenti të popullsisë është shoqëruar me mosveprimin e institucioneve publike për promovimin e të drejtave të komuniteteve LGBTIQ+. Nga ana tjetër kjo pasqyron një qëndrim përgjithësisht të paqartë të Qeverisë së Kosovës ndaj këtij grupi shoqëror, duke nxjerrur kështu shkëputjet themelore ndërmjet parimeve të saj zyrtare të demokracisë dhe gjithëpërfshirjes dhe realitetit faktik të përjashtimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

**313.** Si rezultat i stigmës që i është bashkangjitur komuniteteve LGBTIQ+, frika e deklarimit të hapur të orientimit seksual është e dukshme tek ky grup. Kjo përkeqësohet më tej përmes gjuhës së urrejtjes online dhe offline që përshkruan anëtarët e komuniteteve LGBTIQ+ si të degjeneruar moralisht dhe/ose mendërisht.<sup>438</sup> Si rezultat, rastet e personave që e deklarojnë hapur orientimin e tyre seksual si identitet gjinor jo-hetero ose jobinar, janë të pakta dhe të izoluara. Në këtë drejtim, bari i parë queer në Prishtinë, Bubble Pub, mbetet kafeneja e vetme në pronësi të një personi LGBTIQ+ në Kosovë, e cila haptazi e profilizon veten si një queer bar.<sup>439</sup>

435 CEL Kosova (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

436 CSGD (2022), [Ngritja e grupit punues për hartimin e protokollit klinik për profilaksinë para infektimit me HIV.](#)

437 CEL Kosova (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

438 D4D (2023), [Rëndësia e parandalimit dhe dënimit të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTIQ+.](#)

439 Libertas (2022), [‘Filuska’ e personave LGBTIQ+ në zemër të Prishtinës.](#)

### 314. Rekomandime

- Prokurori i Shtetit duhet të sigurojë që krimet e urrejtjes që si cak kanë komunitetet LGBTIQ+, të ndiqen penalisht dhe ndëshkohen efektivisht ex-officio;
- PK-ja dhe Prokurori i Shtetit duhet të veprojnë në mënyrë efektive në rastet e gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes ndaj personave LGBTIQ+;
- MASHTI duhet të përfshijë informata rreth personave LGBTIQ+ në sistemin kombëtar të arsimit për të promovuar vetëdijesimin dhe pranimin e diversitetit;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) duhet të sigurojë financim dhe mbështetje për organizatat LGBTIQ+ për të kryer punën e tyre dhe për t'u angazhuar në avokim;
- ZQM duhet të ofrojë programe dhe fushata vetëdijesimi për publikun e gjerë për edukim për çështjet e LGBTIQ+ duke përfshirë sfidat me të cilat përballet komuniteti dhe rëndësinë e barazisë dhe përfshirjes;
- Duhet të ofrohet më shumë mbështetje nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë për të plotësuar nevojën për mbështetje psikologjike për personat LGBTIQ+;
- Institucionet kompetente (Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës) duhet të sigurojnë plotësimin adekuat të kornizës ligjore në lidhje me njohjen gjinore në mënyrë që të garantojnë në mënyrë të përhershme realizimin e kësaj të drejte;
- Komuna e Prishtinës duhet të vazhdojë me ndërtimin e strehimores për LGBTIQ+;
- Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë korrigjimin e dispozitave antikushetuese për martesën dhe bashkëjetesën në projekt Kodin Civil, si dhe duhet të miratojë draftin e Kodit Civil për të siguruar që çiftet e të njëjtit seks të kenë të njëjtat të drejta si çiftet e tjera dhe për të zhdukur diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në ligjin për familjen.
- MSH-ja duhet të adresojë nevojat specifike shëndetësore dhe të miratojë protokollet klinike për profilaksinë para ekspozimit;
- Kuvendi i Kosovës duhet të marrë masat e nevojshme për të adresuar gjuhën diskriminuese të përdorur nga deputetët e Kuvendit ndaj personave LGBTIQ+.

## 7.7 Personat në lëvizje

**315.** Korniza legjislative e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt të “personave të zhvendosur brenda vendit” në nenin 156 të Kushtetutës, duke garantuar njëkohësisht ndihmën në rikthimin e pronës dhe posedimit.<sup>440</sup> Për më tepër, në janar 2018, Qeveria e Kosovës nxorri Rregulloren Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme. Rreg-

440 Kushtetuta e Kosovës (2008).

ullorja, ndër të tjera, përcakton përgjegjësitë e organeve kompetente, vendimmarrëse dhe zbatuese, si dhe procedurat dhe kriteret e ndihmës.

**316.** Korniza ligjore që mbulon të gjithë politikën e azilit është e kompletuar. Kjo kornizë ligjore parashih procedurat e pritjes dhe trajtimit fillestar të aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare; procedurat dhe standardet e shqyrtimit dhe vendimmarrjes për kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare; rregullat e brendshme për funksionimin e Qendrës së Azilit, rregullat për punën e Komisionit Kombëtar për Refugjatët si shkallë e dytë administrative; si dhe Rregullorja për integrimin e të huajve, përkatësisht personave me status të mbrojtjes ndërkombëtare në Kosovë.<sup>441</sup>

**317.** Marrë parasysh ndryshimet në legjislacionin e BE-së dhe nevojën për të adresuar hendekët ligjorë të hasur gjatë zbatimit të tij, Qeveria e Kosovës vazhdoi punën për hartimin e Ligjit të ri për të Huajt, i cili është ende në pritje të miratimit. Qendra e re e pritjes për migrantët e inauguruar në vitin 2022 do të pasqyrohet në Ligjin e ri për të Huajt; Ligji i ri do të parashikojë gjithashtu disa institute të reja, si Statusi i Toleruar për të huajt; krijimi i një sistemi të hyrjes plotësisht efektiv dhe të ndjeshëm ndaj mbrojtjes, i cili duhet të përfshijë identifikimin, depistimin dhe referimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe atyre me nevoja specifike; ai duhet gjithashtu të përcaktojë dispozita për integrimin e lehtësuar.<sup>442</sup>

**318.** Kosova vazhdon të jetë një rrugë tranzit për lëvizje të përziera. Në vitin 2023, ishin 181 kërkesa për statusin e mbrojtjes ndërkombëtare (kërkesa për azil) që ishin dorëzuar në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme nga Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K).<sup>443</sup> Shumica e kërkesave për azil janë pezulluar (149 nga 181 aplikime), pasi që aplikantët janë zhdukur pa përfunduar procedurën e përcaktimit të statusit të refugjatit ose e kanë tërhequr kërkesën për statusin e mbrojtjes ndërkombëtare. Megjithatë, 24 aplikime rezultuan me vendime pozitive për dhënien e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare, ndër të cilët 6 aplikantëve iu njoh statusi i refugjatit me leje qëndrimi të përkohshëm për 4 vjet dhe 18 të tjerëve statusi i mbrojtjes plotësuese me leje qëndrimi të përkohshëm për 1 vit, me mundësi vazhdimi. Refugjatët kanë ardhur nga vende me origjinë të ndryshme si Ukraina, Jordania, Siria, Afganistani dhe Turqia. Rastet e dhunës në baza gjinore dhe në familje, si dhe LGBTIQ+, si bazë për mbrojtje ndërkombëtare, janë konsideruar institucionalisht duke u dhënë mbrojtje atyre në nevojë.<sup>444</sup>

**319.** Statistikat e përgjithshme për azilin për vitin 2023 janë publikuar nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim përbrenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Janë 221 vendime të Divizionit të Azilit që përfshijnë 124 vendime për pezullim të procedurës, 30 vendime për njohjen e statusit të refugjatit, 13 vendime për tërheqje vullnetare, 12 vendime për mbrojtje të përkohshme, 7 vendime për vazhdimin e mbrojtjes së përkohshme, 19 vendime për mbrojtje plotësuese, 5 vendime për vazhdimin e mbrojtjes plotësuese, 9 vendime për refuzim të kërkesave për azil dhe 2 vendime për refuzim me procedurë të përshpejtuar.<sup>445</sup> Krahasuar me vitet e mëparshme, sigurimi fizik dhe social në Qendrën e Azilit në Magurë është përmirësuar ndjeshëm gjatë vitit 2023.<sup>446</sup>

441 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

442 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

443 CRPK (2024), [statistika: ofruet i ndihmës juridike falas për aplikantët për statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Kosovë](#)

444 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

445 Ministria e Punëve të Brendshme (2024), [Raporti Statistikor Vjetor 2023](#).

446 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.



**320.** Marrë parasysh njohuritë dhe shkathtësitë elementare për mbrojtjen e refugjatëve që autoritetet i kanë fituar përgjatë disa viteve, duke përfshirë mbështetjen dhe ndihmën e drejtpërdrejtë të ofruar nga OJQ CRP/K dhe organizata të tjera lokale dhe ndërkombëtare, personave me status të njohur të mbrojtjes ndërkombëtare u është dhënë më shumë qasje në skema të ndryshme integrimi si akomodimi, ndihma sociale, kurset e gjuhës dhe arsimit, ndihma mjekësore, ofrimi i artikujve ushqimorë dhe jo ushqimorë, ndihma e ofruar për mundësi punësimi, si dhe qasja në ndihmë juridike falas. Megjithatë, kapacitetet e kufizuara institucionale dhe mungesa e koordinimit të të gjithë akterëve të angazhuar në trajtimin e integrit të personave me status të mbrojtjes ndërkombëtare në Kosovë, u identifikua si sfida kryesore për përgjigje efektive dhe efektive ndaj atyre në nevojë. Marrë parasysh se procesi kërkon angazhimin e shumë sektorëve qeveritarë, si qendror ashtu edhe komunal, p.sh. regjistrimin ligjor, akomodimin, arsimin, kurset e gjuhës dhe integritin, punësimin, çështjet e dhunës në baza gjinore, LGBTIQ+, çështjet e shëndetit mendor etj., kërkon koordinim të rregullt institucional dhe bashkëpunim, i cili mungon. Prandaj, OJQ CRP/K dhe organizata të tjera relevante luajtën një rol vendimtar për të lidhur të gjitha autoritetet përgjegjëse për të kryer detyrat e tyre publike që t'iu përgjigjen njerëzve në nevojë në kohën e duhur.<sup>447</sup>

**321.** Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në krijimin e një kornize ligjore për të mbrojtur ata që janë në risk të pashtetësisë, duke siguruar të drejta si regjistrimi i lindjes, marrja e shtetësisë dhe qasja në procedurat e përcaktimit të pashtetësisë, duke promovuar barazinë ndërmjet gjinive, etnisë, racës dhe fesë. Megjithatë, sfidat vazhdojnë në zbatimin efektiv të këtyre ligjeve, veçanërisht në fushën e regjistrimit të vonuar të lindjes dhe marrjes së shtetësisë. Përkundër parashikimeve për një procedurë të thjeshtuar administrative në rastet e regjistrimit të vonuar të lindjes, ku ka disa ose aspak prova, pengesat burokratike dhe keqinterpretimi i normave vazhdojnë të pengojnë zgjidhjen e kërkesave komplekse, shpesh duke penguar një zgjidhje ligjore përfundimtare.<sup>448</sup>

**322.** Procesi i konfirmimit dhe marrjes së shtetësisë mbetet problematik për anëtarët në moshë madhore të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që kanë lindur në vendet e Evropës Perëndimore ose të zhvendosur në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Këta individë përballen me një risk serioz të pashtetësisë për shkak të vështirësive në sigurimin e provave të kërkuara dhe vlerësimin të autoriteteve për të drejtat e tyre të shtetësisë në momentin e aplikimit. Për disa, procedura e përcaktimit të pashtetësisë paraqet rrugën e vetme ligjore drejt statusit ligjor në Kosovë. Aktualisht në Kosovë janë 14 persona me status pa shtetësi. Shumica e tyre kanë vështirësi me qasjen në të drejtat dhe shërbimet gjatë procesit të aplikimit dhe pas dhënies së statusit për shkak të njohurive të kufizuara të autoriteteve mbi ekzistencën e personave pa shtetësi të njohja e të drejtave që lidhen me ta.<sup>449</sup>

**323.** Personat e paregjistruar hasin në sfida të mëdha në procedurat gjyqësore. Një nga çështjet primare është se kontesteve ligjore në lidhje me çështjet e identitetit shpesh nuk u jepet prioritet, duke çuar në raste të zgjata e të pazgjidhura. Kjo mungesë e prioriteteve përkeqëson

447 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

448 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

449 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

vështirësitë me të cilat përballen ata që janë në risk të pashtetësisë, pasi që rastet e tyre mbeten në shqyrtim për periudha të gjata. Për më tepër, organet administrative shpesh shpërfillin rekomandimet gjyqësore, duke rezultuar në një proces rifillimi që vonon zgjidhjen dhe i lë individët pa identitet ligjor dhe qasje në të drejtat themelore për periudha të gjata.<sup>450</sup>

**324.** Një sfidë e vazhdueshme në Kosovë, veçanërisht për komunitetet e marginalizuara si popullata Rome, Ashkali dhe Egjiptiane, është disponueshmëria e kufizuar e informacionit dhe e të dhënave për individët e peregjistruar. Aktualisht autoritetet nuk kanë numra zyrtarë të personave të peregjistruar në lindje. Edhe pse kjo çështje është trajtuar në disa raste (regjistrimi 2011 dhe anketa 2015/2016 me fokus në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian) ende nuk ka një pasqyrë zyrtare statistikore të personave të peregjistruar në lindje. Kjo mungesë e të dhënave dhe qasje reaktive e institucioneve në identifikimin e të peregjistruarve, ka rezultuar që shumë të rritur dhe të mitur brenda këtyre komuniteteve të mbeten të peregjistruar për vite me radhë dhe privohen nga të drejtat elementare për shkak të mungesës së dokumenteve që vërtetojnë lindjen apo shtetësinë e tyre.

**325.** OJQ CRP/K në bashkëpunim të ngushtë me UNHCR kanë theksuar vazhdimisht sfidat me të cilat përballen individët e peregjistruar në risk të pashtetësisë, duke u kërkuar autoriteteve që të ndërmarrin veprime që theksojnë përgjegjësinë e institucioneve të Kosovës për zgjidhjen e problemeve fillestare të dokumentacionit dhe duke inkurajuar zhvillimin e një mekanizmi sistematik për identifikimin, parandalimin, reduktimin dhe mbrojtjen e personave të peregjistruar. Është ripërsëritur rëndësia e zbatimit të kornizës legjislative, së bashku me interpretimin e unifikuar të normave ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, kjo ishte e theksuar në Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali.<sup>451</sup>

**326.** Individët në risk të pashtetësisë varen kryesisht nga ndihma juridike e ofruar nga OJQ-të, pasi që kriteret e pranueshmërisë të Agjencisë së Ndihmës Juridike Falas i përjashtojnë personat e moshës madhore të peregjistruar të cilëve u mungon një dokument identifikimi. OJQ CRP/K, me mbështetjen e UNHCR, ka qenë një instrument në ofrimin e ndihmës juridike dhe përfaqësimit gjyqësor për individët e peregjistruar, duke siguruar që të drejtat e tyre të njihen në proceset administrative. Në vitin 2023, OJQ CRP/K mbështeti 140 persona me regjistrim të vonuar të lindjes dhe shtetësisë dhe identifikoi mbi 100 individë të peregjistruar që kishin nevojë për ndihmë juridike falas, duke trajtuar në mënyrë efektive sfidat e ndryshme të pashtetësisë dhe duke ndikuar në grupmosha të ndryshme, duke përfshirë gratë, burrat, fëmijët dhe grupet e cenueshme si të moshuarit. Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në krijimin e një kornize ligjore për të mbrojtur ata që janë në risk të pashtetësisë, duke siguruar të drejta si regjistrimi i lindjes, marrja e shtetësisë dhe qasja në procedurat e përcaktimit të pashtetësisë, duke promovuar barazinë ndërmjet gjinive, etnisë, racës dhe fesë.<sup>452</sup>

**327.** Mekanizmat institucionalë përgjegjës për t'u ndihmuar të kthyerve dhe PZHBV-ve janë përcaktuar me Rregulloren Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhjet e Qëndrueshme. Ashtu si në vitet e kaluara, KKpK-të nuk u japin prioritet rasteve bazuar në kriteret e

450 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

451 Zyra e Kryeministrit (2024), [Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2026 dhe Plani i saj i Vepërimit 2022-2024.pdf \(rks-gov.net\)](#).

452 CRPK (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

cenueshmërisë për ofrimin e ndihmës, sipas nenit 10. Krahasuar me raportin e mëparshëm, ku vërehet mungesa e diversitetit etnik në Komisionin Shqyrtues Qendror, në vitin 2023, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka riemëruar anëtarët e Komisionit Shqyrtues Qendror duke siguruar përfaqësim të ndryshëm etnik në përbërjen e tij.<sup>453</sup> Në fund të vitit, Qeveria e Kosovës themeloi Komisionin Qendror të Ankesave, i cili është i mandatuar të shqyrtojë ankesat kundër Komisionit Shqyrtues Qendror. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka përfunduar Strategjinë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve 2023-2027, e cila është publikuar në dhjetor 2023.<sup>454</sup>

**328.** Projektet e ndihmës për banim që synojnë ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme të banimit për familjet e kthyer, financohen dhe zbatohen kryesisht nga komuniteti ndërkombëtar me bashkëpjesëmarrjen e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, regjistrimi i detyrueshëm në regjistrin kadastral i secilës njësi banesore të ndërtuar është i domosdoshëm, duke siguruar që të drejtat pronësore të mund të ushtrohen plotësisht dhe të përdoret mbrojtja ligjore kur është e nevojshme. Mos regjistrimi i shtëpive të ndërtuara do të thotë se këto objekte ligjërisht nuk ekzistojnë dhe si të tilla pengojnë mbrojtjen ligjore mbi objektet, si dhe të gjitha të drejtat e tjera të lidhura ngushtë me të drejtat pronësore. Sfidat e vërejtura lidhur me mos regjistrimin e banesave të ndërtuara humanitare lidhen me procedurat komplekse ligjore, implikimet financiare, kapacitetet njerëzore dhe teknike në nivel komunal dhe mungesën e informacionit/dokumentacionit. Këto sfida pengojnë në mënyrë kolektive realizimin e detyrimeve ligjore që kanë të bëjnë me regjistrimin kadastral dhe pengojnë mbrojtjen gjithëpërfshirëse të të drejtave pronësore për familjet e kthyer.<sup>455</sup>

**329.** Akomodimi me qira është një nga skemat për ofrimin e ndihmës për strehim dhe banim sipas Rregullores Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme.<sup>456</sup> Qiraja jepet si masë e përkohshme akomodimi për të kthyerit derisa të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për banim. Qiraja për të kthyerit e kategorisë me cenueshmëri të rëndë<sup>457</sup> ofrohet për një periudhë nga 3 deri në 12 muaj, në varësi të kapaciteteve financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.<sup>458</sup> Me skadimin e afatit për akomodim, komuna përkatëse ofron strehim përmes programeve sociale të banimit sipas ligjit në fuqi.<sup>459</sup>

**330.** Familjet e cenueshme të të kthyerve, kryesisht nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Kosovës vazhdojnë të jetojnë në banesa me qira me ndihmë shumë të kufizuar dhe/ose pa ndihmë nga autoritetet përkatëse edhe pse e paraparë brenda kornizës legjislative. Situata e tyre tashmë e brishtë përkeqësohet më tej nga vështirësitë shtesë të lidhura me kostot e qirasë dhe mungesën e zgjidhjeve kuptimplota të qëndrueshme të banimit. Është e rëndësishme të shtohet

453 AT (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

454 AT (2022), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2022.

455 AT (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

456 Rregullore Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, neni 15, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15942>

457 Po aty, neni 10, paragrafi 2, parashih kategoritë e cenueshmërisë së familjeve të kthyer në bazë të vlerësimit që mund të tregohet në nën-paragrafin 2.1. cenueshmëri serioze/e rëndë, 2.2 e moderuar dhe 2.3 e ulët .

458 Po aty, neni 15, paragrafi 2.2.5.

459 AT (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në vitin 2023.

se shumica e këtyre familjeve janë vlerësuar dhe miratuar për zgjidhje banimi, megjithatë, edhe pse kanë kaluar një sërë vitesh, zgjidhjet nuk janë ende në horizont.<sup>460</sup>

**331.** Vlen të përmendet se të gjithë të kthyerit që banojnë në akomodime private me qira e bëjnë këtë pa sigurinë e marrëveshjeve formale të qiramarrjes. Kjo mungesë e dokumentacionit ligjor pengon aftësinë e tyre për qasje në programet e ndihmës sociale dhe për të siguruar çdo formë tjetër të mbrojtjes. Kjo pengesë është pasojë e drejtpërdrejtë e statusit të tyre të pasigurt të banimit.

**332.** Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u hoqën kushtet për regjistrimin e të drejtave pronësore me pagesë të borxheve të tatimit në pronë. Gjithashtu, nuk ka kushte nga komunat për borxhin e faturave të pastrimit. Çështja mbetet pezull për shkak të procedurave administrative të komunave. Procesi i regjistrimit të të drejtave në shfrytëzimin pronësor të përfituesve të programit të banimit nga donatorët në tokën e ndarë komunale në librat kadastralë komunalë në Mitrovicën e Jugut vazhdon të jetë i pazgjidhur. Në lagjen “Fidanishte” janë ndërtuar gjithsej 288 shtëpi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes donatorëve të ndryshëm ndërkombëtarë. Regjistrimi i 74 lëndëve, për të cilat Drejtoria Komunale e Urbanizmit ka grumbulluar dokumentacionin përkatës, fillimisht ka ngecur për shkak të pengesave ligjore; me largimin e tyre, komuna ka vazhduar me veprimet administrative përkatëse. Familjet në fjalë ndihen të pasigurta pasi që nuk e posedojnë dokumentacionin përkatës pronësor që do t’u sigurojë shfrytëzim të sigurt dhe të papenguar të pronave.<sup>461</sup>

**333.** Shumë të kthyer pa tokë kanë pritur me durim zgjidhje të qëndrueshme brenda harkut kohor 2017-2023, pavarësisht ekzistencës së një kornize ligjore përkatëse dhe nisjes së projekteve të ndryshme të banimit social. Megjithëse korniza legjislative i mandaton komunat të vlerësojnë nevojat për banim social, veprimet e ndërmarra janë minimale. Janë shfaqur shqetësime të ndryshme, duke përfshirë mungesën e progresit në vlerësimin e nevojave për banim, zhvillimin e programeve komunale të banimit social, mungesën e një baze të dhënash funksionale për banimin social dhe mungesën e iniciativave efektive për mbledhjen e fondeve nga komunat për zbatimin e programeve të banimit social. Nenet 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit<sup>462</sup> përshkruajnë detyrimin e komunave për të kryer vlerësimin e nevojave për banim brenda fushave të tyre përkatëse të përgjegjesisë. Pas këtyre vlerësimeve, komunave u kërkohet të zhvillojnë një strategji trevjeçare banimi, duke adresuar elementë të tillë si nevojat për banim, kërkesat për financim dhe identifikimin e tokës në dispozicion për ndërtimin e banesave sociale. Gjetjet e anketës tregojnë se është i padisponueshëm informacioni për nevojat sociale për banim të të kthyerve dhe familjeve të zhvendosura, duke rezultuar në një reflektim të pamjaftueshëm në strategjitë komunale të banimit.<sup>463</sup> Komunat po përballen me posedim të kufizuar të tokës komunale dhe sfida legjislative në ndarjen e tokës komunale për kërkesa individuale.<sup>464</sup>

460 AT (2023), [Raport: Zgjidhje të qëndrueshme për banim të ndërlidhura me sfidat e të drejtave pronësore në Kosovë](#),

461 AT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

462 AT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

463 AT (2023), [Raport: Zgjidhje të qëndrueshme për banim të ndërlidhura me sfidat e të drejtave pronësore në Kosovë](#)

464 AT (2024), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në vitin 2023.

**334.** Janë gjithsej 89 familje pa tokë në mbarë Kosovën, kryesisht nga komunitetet e të kthyerve/PZHBV Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Shumica e këtyre familjeve të kthyer aktualisht banojnë në banesa private dhe kushtet e tyre sfiduese socio-ekonomike e bëjnë të vështirë për ta përballimin e kostove të qirasë dhe faturave të shërbimeve.<sup>465</sup>

**335.** Nivelet e besimit në institucionet kyçe në mesin e të kthyerve ndryshojnë sipas komuniteteve etnike, me pengesat gjuhësore dhe mungesën e mbështetjes për riintegrim/mundësi ekonomike të identifikuar si sfida të rëndësishme. Në disa nga lokacionet e vështira ka ende pengesa ndërmjet të kthyerve të mundshëm dhe komunitetit pritës, për shkak të pretendimeve për krime lufte të pazgjdhura ose për rastet e personave të zhdukur. Raportohen incidente të sigurisë, të ndikuar nga klima politike dhe dialogu, duke ndikuar në perceptimin e sigurisë së komuniteteve të të kthyerve. Ekziston një ndërveprim dhe aktivitet i kufizuar ndërmjet grave/të rinjve të kthyer me komunitetet pritëse, gjë që tregon hendekë të mundshëm në shkëmbimin dhe mirëkuptimin kulturor. Një numër i konsiderueshëm i familjeve të kthyer u zhvendosën në vendin e tyre të zhvendosjes për shkak të shqetësimeve të lidhura me shëndetin, sfidave në sigurimin e punësimit, faktorëve arsimorë, vështirësive në procesin e riintegritimit dhe posedimit të pronës në zhvendosje.<sup>466</sup>

**336.** Të kthyerit serbë të Kosovës vazhdojnë të jenë objekt i vjedhjeve, gjuajtjes me gurë, dëmtimeve pronësore dhe frikësimeve, duke krijuar kështu perceptim negativ mbi situatën e sigurisë dhe të gjitha këto kanë ndikim në procesin e pajtimit. Të kthyerit serbë pohojnë se shumica e rasteve mbeten të pazgjdhura dhe nuk ka reagime të rregullta nga policia për statusin e rastit. Sipas OJQ Advancing Together (AT) ka pasur 17 incidente sigurie që kishin cak komunitetin e të kthyerve.<sup>467</sup>

**337.** Për shkak të sfidave të riintegritimit, familjet që përballen me varfërinë dhe papunësinë, thjesht nuk kanë interes të njihen me të drejtat e fëmijëve. Fëmijët shfrytëzohen për të kërkuar lëmoshë në rrugë, grumbullim të materialeve, për të gjeneruar të hyra për familjet, kështu që detyrohen të ndërpresin arsimin ose të mos e ndjekin arsimin e rregullt. Janë 11 fëmijë të kthyer që janë përfshirë në punë në forma të ndryshme, kryesisht nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Kosova ka bërë progres në adresimin e mbrojtjes së fëmijës dhe të drejtave të tyre përmes miratimit të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, por mbetet ende për të bërë për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur efektivisht keqtrajtimit, dhunës, shfrytëzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijëve.<sup>468</sup>

**338.** Për shkak të mungesës së arsimimit dhe trajnimit specifik profesional, pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian po përballen me sfida për të siguruar mjete të qëndrueshme jetese ose punësim të përshtatshëm. Aftësimi profesional ofrohet falas, megjithatë, shtatë qendrave në Kosovë u mungojnë trajnerët për trajnimet më të nevojshme, listat e pritjes janë të gjata dhe zakonisht duhen më shumë se 6 muaj për ta filluar trajnimin. Përveç kësaj, të jetuarit në fshatra të largëta kërkon shpenzime shtesë për transport për aq kohë sa zgjat trajnimi.<sup>469</sup>

465 AT (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në vitin 2023.

466 AT (2023), [Raport: Kohezioni social i të kthyerve në Kosovë](#).

467 AT (2023), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

468 AT (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

469 AT (2024), inpute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

**339.** Shumica e pjesëtarëve që marrin ndihmë sociale nuk hyjnë në punësim formal nga frika e largimit nga skema sociale dhe, duke ditur se shumica e tyre nuk kanë punë të sigurt dhe aftëgjatë, ata kryesisht angazhohen në punë marrëdhënie pune informale dhe sezonale dhe të përkohshme. Ky grup deklaroi se ka edhe barriera për punësimin e tyre në sektorin publik, të cilat lidhen me kriteret e kërkuara të arsimit adekuat dhe përvojës së mëparshme të punës të cilën nuk e kanë. Kjo kufizon perspektivat e tyre për punë të qëndrueshme dhe të sigurta në sektorin publik.<sup>470</sup>

### **340. Rekomandime**

- Përkundër faktit se institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë hapat e parë drejt integritit të refugjatëve të njohur në Kosovë, nevojitet mbështetje e mëtejshme institucionale për përfshirjen e tyre në mundësitë socio-ekonomike;
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të sigurojë qasje në të drejtat dhe shërbimet bazë për të gjithë azilkërkuesit dhe refugjatët në kohën e duhur dhe në mënyrë të koordinuar;
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përmirësojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstucional për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave dhe kërkesave të refugjatëve të njohur dhe personave me status mbrojtës e plotësues në Kosovë për integrimin dhe mbrojtjen e tyre ligjore dhe socio-ekonomike;
- Regjistri Civil duhet të zhvillojë një qasje sistematike për identifikimin, parandalimin, zvogëlimin dhe mbrojtjen e personave të paregjistruar në Kosovë në mënyrë që të identifikohen personat e paregjistruar;
- Institucionet publike të Kosovës duhet t'i minimizojnë pengesat ligjore për ata persona të paregjistruar të cilëve u mungon dokumentacioni i plotë dëshmues, duke mundësuar kështu regjistrimin e vonuar të lindjes sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015 për regjistrimin e vonuar në regjistrat e gjendjes civile, veçanërisht nenit 10;
- Sistemi Gjyqësor në Kosovë duhet të adoptojë një qasje më proaktive në menaxhimin e rasteve dhe zgjidhjen e konflikteve administrative. Me zbatimin e masave të tilla, procesi gjyqësor mund të bëhet më efektiv dhe më i përshpejtuar, dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor në trajtimin e çështjeve administrative mund të rritet ndjeshëm;
- Zyrtarët qeveritarë dhe ofruesit e shërbimeve duhet të ndërgjegjësohen për personat pa shtetësi dhe të drejtat e tyre nëpërmjet programeve të trajnimit që mund të rrisin kapacitetet e nëpunësve civilë për të ndihmuar në mënyrë efektive individët pa shtetësi;
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të identifikojë numrin e familjeve që kanë përfituar njësi banimi (me ose pa leje ndërtimi) dhe t'i regjistrojë në regjistrat kadastralë;
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të zbatojë kornizën aktuale legjislative për të siguruar që të gjitha palët e përfshira të jenë në dijeni të detyrimeve ligjore para, gjatë dhe pas ndërtimit të njësisë së banimit;
- Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet të zhvillojë një fletë përcjellëse gjithëpërfshirëse të të gjithë të kthyerve pa prona dhe

anëtarëve të komuniteteve të cënueshme për avokim për projekt propozime të mundshme për banim social;

- Ministria e Planifikimit Hapësinor, Mjedisit dhe Infrastrukturës duhet t’i përfshijë të kthyerit/ të zhvendosurit si kategori të veçantë në aktet nënligjore të Ligjit të ri për banim social;
- Qeveria e Kosovës duhet të forcojë mbështetjen për komunitetet e të kthyerve, duke siguruar që programet e ndihmës të jenë efektive dhe t’u përgjigjen nevojave të komunitetit.
- Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë programe për njohuri gjuhësore për të kapërcyer pengesat gjuhësore që pengojnë komunikimin efektiv dhe riintegrimin.

## 8. PJESA D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ÇËSHTJE SPECIFIKE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

### 8.1 Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut

**341.** Përkufizimi i drejtësisë tranzicionale në këtë dokument rrjedh nga OHCHR, i cili e përcakton atë në lidhje me të drejtat e njeriut si: “një qëllim për të siguruar njohjen e viktimave, për të rritur besimin e individëve në institucionet shtetërore, për të përforcuar respektin për të drejtat e njeriut dhe për të promovuar sundimin e ligji si një hap drejt pajtimit dhe parandalimit të shkeljeve të reja”.<sup>471</sup> Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj drejtësisë tranzicionale mund të lehtësoj proceset e pajtimit dhe të kontribuoj në transformimin e shoqërisë së Kosovës në një shtet më gjithëpërfshirës e të përbashkët për të gjitha komunitetet etnike.

**342.** Korniza legjislative që adreson drejtësinë tranzicionale në kontekstin e konfliktit të Kosovës përfshin Ligjin Nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, në fuqi që nga prilli 2016, i cili themelon Institutin e Mjekësisë Ligjore duke e ngarkuar atë me gjetjen, zhvarrosjen dhe përcaktimin e fatit të personave të zhdukur. Neni 15 thekson bashkëpunimin me familjet dhe organizatat përkatëse. Së dyti, Ligji Nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimat Civile të Luftës dhe Familjet e tyre, trajton dhunën seksuale të lidhur me konfliktin. Megjithatë, ky ligj paraqet sfida, pasi limiton njohjen e incidenteve të ndodhura menjëherë pas konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999.

**343.** Në vitin 2021, Qeveria e Kosovës caktoi një Grup Punues të ekspertëve për të zhvilluar strategjinë gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale që duhej të “bashkonte të gjitha iniciativat e

471 OCHR (2022), [Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut](#).

mëparshme”,<sup>472</sup> dhe në vitin 2023 është hartuar një draft i ri i cili është në pritje të miratimit.<sup>473</sup> Megjithatë, siç është theksuar në raportet e mëparshëm (2021 dhe 2022), shumica e iniciativave të deritanishme kanë pasur të meta me mungesën e vullnetit politik dhe një angazhimi serioz të akterëve përkatës për të nxjerrë një plan konkret veprimi. Veçanërisht, si me qeveritë e tjera, Qeveria aktuale ka shfuqizuar iniciativat e mëparshme formale dhe ka filluar procesin prej fillimit. Mohimi i vazhdueshëm i projekteve të mëparshme në favor të iniciativave të krijuara rishtazi, ndikon negativisht në fushën e ballafaqimit me të kaluarën dhe pengon progresin pozitiv.<sup>474</sup>

**344.** Në vitin 2023, OJQ Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDHK) publikoi një raport gjithëpërfshirës që sqaron iniciativat e fundit të ndjekura nga Qeveria e Kosovës në lidhje me trajtimin e së kaluarës, së bashku me një vlerësim të statusit aktual të zbatimit të tyre.<sup>475</sup> Raporti shqyrton gjendjen aktuale për iniciativat e mëposhtme: Instituti për Krimet e kryera gjatë Luftës në Kosovë, Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtitimit, Strategjia Kombëtare për Drejtësi Tranzicionale, Komisioni Shtetëror për hulumtimin, regjistrimin, inventarizimin, vlerësimin dhe dokumentimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike të shkatërruara gjatë luftës së vitit 1998 dhe 1999, Ligji për Personat e Zhdukur, Memoriali për Fëmijët e Vrarë gjatë Luftës 1998-1999 në Kosovë dhe Muzeu për dokumentimin dhe prezantimin e krimeve të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë kundër shqiptarëve në Kosovë. Analiza e OJQ FDHK për iniciativat aktuale të shtetit për t’u marrë me të kaluarën, zbulon një rritje të dukshme të përpjekjeve nga akterët politikë dhe qeveritarë në vitet e fundit. Megjithatë, këtyre iniciativave u mungon konsultimi me grupet përkatëse, duke paraqitur një risk potencial për vullnetin e qëndrueshëm politik. Për më tepër, mungesa e transparencës publike pengon dhënien e informacionit të saktë për qytetarët. Raporti rekomandon rritjen e transparencës në iniciativat e nisura dhe inkurajimin e përfshirjes më të madhe të organizatave të përkushtuara për të adresuar të kaluarën në proceset përkatëse.<sup>476</sup>

**345.** Instituti për Krimet e kryera gjatë Luftës në Kosovë, i funksionalizuar për dokumentimin dhe ruajtjen e kujtesës kolektive, doli si një iniciativë e MD-së. Kuvendi i Kosovës e miratoi Projektligjin në lexim të dytë më 13 korrik 2023 dhe u emërua drejtori i ri.<sup>477</sup>

**346.** Për më tepër, OJQ FDHK nënvizon vështirësitë e Qeveria e Kosovës në formulimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse për Drejtësi Tranzicionale që çon në mungesë të ndërveprimit koheziv midis mekanizmave ekzistues për t’u marrë me të kaluarën. Një përpjekje e dështuar në vitin 2012 për të krijuar një strategji të tillë nën një grup ndërministror nxiti një iniciativë të re nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2021. Kjo iniciativë krijoi një grup punues të përbërë nga përfaqësues nga institucionet publike, institucionet akademike dhe shoqëria civile. Gjatë procesit të hartimit janë mbajtur mbi 30 takime, me fokus në angazhimin e komuniteteve shumicë dhe jo-shumicë. Strategjia e realizuar Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale synon të sigurojë një kornizë për trajtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të ligjit ndërkombëtar humanitar, duke theksuar të drejtat e viktimave dhe ndërtimin e një të ardhmeje paqësore. Drafti përfshin objektiva strategjike në fusha si gjetja e së vërtetës, drejtësia penale, dëmshpërblimet dhe reformat institucionale, në

472 Kryeministri Albin Kurti (2021) i cituar në Osorio (2022) për Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDH), [Drejt një strategjie kombëtare të drejtësisë tranzicionale për Kosovën](#).

473 YIHR (2023), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

474 Nora Ahmetaj (2023), inute për raportin e përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2023.

475 FDHK (2023), [Iniciativat aktuale shtetërore për ballafaqim me të kaluarën](#).

476 FDHK (2023), [Iniciativat aktuale shtetërore për ballafaqim me të kaluarën](#).

477 FDHK (2023), [Iniciativat aktuale shtetërore për ballafaqim me të kaluarën](#).



përputhje me detyrimet e shtetit. Drafti i dokumentit iu nënshtrua konsultimit publik nga 15 maji deri më 2 qershor 2023 dhe një punëtori e mbajtur më 26 qershor shqyrtoi komentet e pranuar. Prej vitit 2023, është në pritje finalizimi i Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale.<sup>478</sup> Sipas OJQ BIRN (2024), MD-ja do ta miratojë Strategjinë për Drejtësinë Tranzicionale në janar 2024.<sup>479</sup> Në mungesë të konsultimeve me palët përkatëse të interesit në fushën e të drejtave të njeriut, strategjia përfshin edhe çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë penale. Idealisht, ky integrim nuk duhet të ndodhë, duke pasur parasysh se mbikëqyrja e këtij domeni tradicionalisht ka rënë nën juridiksionin e gjykatave hibride, UNMIK-ut, EULEX-it dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës për 25 vitet e fundit.<sup>480</sup>

**347.** Për më tepër, në raportin e OJQ FDHK theksohet se Komisioni Shtetëror për hulumtimin, regjistrimin, inventarizimin, vlerësimin dhe dokumentimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike të shkatërruara gjatë luftës së vitit 1998 dhe 1999, është themeluar me vendim të qeverisë më 14 korrik 2021. Qëllimi i tij është të kryejë hulumtime gjithëpërfshirëse, të mbledhë prova dhe të dokumentojë shkatërrimin e objekteve kulturore dhe historike gjatë konfliktit. Komisioni ka për detyrë të krijojë një raport përfundimtar, të vlerësojë dëmet dhe të përcaktojë rëndësinë historike, kulturore, sociale dhe shpirtërore të vendeve të shkatërruara. Ndryshimet në themelimin e Komisionit u bënë më 26 janar 2022, duke përfshirë ndryshime sa i përket anëtarëve të tij. Deri në fund të vitit 2022, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve bëri të ditur se Komisioni kishte përpiluar një raport paraprak, duke identifikuar mbi 1,300 vende të shkatërruara në databazë, së bashku me dokumente dhe artefakte të shumta të mbajtura nga Serbia. Megjithatë, raporti nuk është bërë ende publik për shkak të kërkesave të mbajtjes së konfidencialitetit. Kryetarja e Komisionit Gjejlane Hoxha tha se nga shtatori 2021 deri në mars 2023 është punuar intensivisht për identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e dëmeve. Në mars 2023, Komisioni përfundoi një raport gjithëpërfshirës me shënime mbi dëmet, duke përfshirë vlerësimet në vlerat paraprake monetare, dhe ia dorëzoi qeverisë, së bashku me rekomandimet për veprime të mëtejshme.<sup>481</sup>

